OCCASIONAL
PAPER
SERIES

TË DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË: NJË TRASHËGIMI E VËSHTIRË E SHOQËRISË NË TRANZICION

Hartuar nga Edward Tawil për
Qendrën Ndërkombëtare
për Drejtësi Tranzicionale

Shkurt 2009

©2009 Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale

Ky dokument mund të citohet si Edward Tawil, *Të drejtat pronësore në Kosovë: Një trashëgimi e vështirë e shoqërisë në tranzicion (2009),* Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale.

PËR QENDRËN NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSI TRANZICIONALE (QNDT)

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT) i ndihmon vendet që janë në kërkim të llogaridhënies për mizoritë masive në të kaluarën ose për shkeljen e të drejtave të njeriut. Qendra punon në shoqëritë e dala nga regjimet represive ose nga konfliktet e armatosura, si edhe në demokracitë e konsoliduara në të cilat ende nuk janë zgjidhur padrejtësitë historike ose shkeljet sistematike.

Për të promovuar drejtësinë, paqen dhe pajtimin, zyrtarët qeveritarë dhe avokuesit joqeveritarë i marrin parasysh një varg qasjesh ndaj drejtësisë tranzicionale, duke përfshirë përgjigjet gjyqësore dhe jogjyqësore ndaj krimeve kundër të drejtave të njeriut. QNDT-ja ndihmon në zhvillimin e qasjeve të integruara, gjithëpërfshirëse dhe të lokalizuara ndaj drejtësisë tranzicionale të cilat përfshijnë pesë elemente kyçe: ndjekjen penale të kryesve të veprave, dokumentimin dhe vërtetimin e abuzimeve përmes mjeteve jogjyqësore, siç janë komisionet për të vërtetën, reformimin e institucioneve abuzive, sigurimin e shpërblimeve për viktimat dhe mundësimin e procesit të pajtimit.

Qendra është e përkushtuar të ndërtojë kapacitetet vendore dhe përgjithësisht të forcojë fushën e krijuar të drejtësisë tranzicionale dhe për të bërë ketë ajo bashkëpunon ngushtë me organizatat dhe ekspertët nga mbarë bota. Duke punuar në terren përmes gjuhëve lokale, QNDT-ja siguron informacione krahasuese, zhvillon analiza ligjore dhe të politikave për institucionet e drejtësisë dhe për ato që kërkojnë të vërtetën, për organizatat joqeveritare, qeveritë dhe të tjerët.

PËR AUTORIN

Edward Tawil ka punuar në ligjin për refugjatët dhe në të drejtën humanitare në Kanada. Ai është i punësuar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) që nga muaji gusht 2000, si specialist në fushën e të drejtave të pakicave. Ai ka punuar në fushat e çështjeve civile, pajtimit dhe dialogut ndëretnik, kthimit dhe sundimit të ligjit. Ai e ka mbajtur pozitën e Shefit të Misionit të OJQ-së *Terre des Hommes* në Kosovë (2002-2004) duke qenë i angazhuar në reformën e sistemit gjyqësor për të miturit në Kosovë. Gjatë katër viteve të fundit ai ka punuar në trajtimin e çështjes së garancive plotësuese për sigurinë e komuniteteve pakicë (me fokus të veçantë në çështjet pronësore), veçanërisht si Këshilltar i Posaçëm i Komisarit të Policisë së OKB-së.

PUNA E QNDT-SË NË ISH-JUGOSLLAVI

QNDT-ja është duke punuar në mënyrë aktive në ish Jugosllavi që nga viti 2002. Qendra e ka të qartë se natyra rajonale e konflikteve në vitet e 90-ta nënkupton se edhe përpjekjet për trajtimin e trashëgimisë nga e kaluara kërkojnë iniciativa dhe perspektiva rajonale.

Puna e kësaj Qendre në rajon është e fokusuar në ndërtimin e ekspertizës për drejtësinë tranzicionale, zhvillimin e vlerësimeve të gjendjes në vend, mbështetjen e gjykimeve vendore dhe punës së Tribunalit të Hagës, ndihmën në gjetjen e të vërtetës dhe shpërblimit të viktimave dhe analizimin e përpjekjeve të verifikimit dhe përkujtimit. Puna deri më sot ka qenë e përqendruar në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë, Mal të Zi dhe Kroaci. Programi i QNDT për ish-Jugosllavinë ka bashkëpunëtoren e lartë Dorothée Marotine në Bruksel, drejtoreshë për Evropë, shefin e QNDT-së në Bruksel Dick Oosting, dhe konsulentin Bogdan Ivanisheviq në Beograd.

Publikimet që janë bërë në lidhje me këtë çështje:

*Në drejtim të kundërt: Ndjekjet penale të krimeve të luftës në Serbi (*Shkurt 2008)

E drejta bashkëkohore për kthimin e pronës në kontekstin e drejtësisë tranzicionale (Maj 2007)

Mësimet nga vendosja e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në Kosovë (Prill 2006)

Serbia dhe Mali i Zi: Zhvillime të zgjedhura në drejtësinë tranzicionale (Tetor 2004)

FALËNDERIMET

Ky raport bazohet në hulumtimet në vendin e ngjarjes të kryera nga autori për çështjen e konfliktit pronësor në Kosovë ndërmjet vitit 2008 dhe 2009. Dorothée Marotine, Dick Oosting dhe Caroline Barbot e bëm shqyrtimin e këtij hulumtimi. Falënderojmë edhe Ivana Aksiq për ndihmën e çmueshme që ka dhënë për këtë hulumtim. Po ashtu falënderojmë Styrkar Gagnat dhe Nicolas Guinard për mbështetjen dhe këshillat e tyre, të cilat e mundësuan hartimin e këtij raporti. QNDT-ja falënderon Fondacionin Charles Stewart Mott dhe Zennström Philanthropies për mbështetjen dhe përgatitjen e këtij raporti.

PËRMBAJTJA

	Harta		1
	Lista e shkurtesave		2
	Përmbledhje ekzekutive		3
I.	HYRJE		5
II.	HISTORIA E VALËS SË KONFLIKTEVE PRONËSORE NË KOSOVË		7
	A.	Historia e kohës së Perandorisë Osmane	7
	B.	Kriza në vitet e nëntëdhjeta	9
	C.	Pas vitit 1999	12
	D.	Monumentet	15
	E.	Ndërtimet e paligjshme	15
	F.	Shpronësimet e paligjshme	16
	G.	Grupet e rrezikuara	18
		i. Serbët e zhvendosur nga Kosova	18
		ii. Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët (RAE)	19
		iii. Femrat	22
		iv. Shqiptarët e Kosovës në veri të lumit Ibër	24
III.	QASJA E INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE NDAJ ÇËSHTJES SË KTHIMIT TË PRONAVE NË KOSOVË		25
	A.	Informata të përgjithshme	25
	B.	Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore (DÇBP)	26
	C.	Agjencia Kosovare e Pronës (AKP)	30
	D.	Policia	34
	E.	Gjykatat vendore	37
	F.	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe Privatizimit	42
IV.	DREJTËSIA TRANZICIONALE DHE PASOJAT E KONFLIKTIT PRONËSOR NË KOSOVË		47
	A.	Informata të përgjithshme	47
	B.	Drejtësia tranzicionale në Kosovë në aspektin krahasues	49
		i. Informata të përgjithshme	49
		ii. Bosnja dhe Hercegovina	51
		iii. Turqia	54
	C.	Pengesat dhe sfidat	58
V.	PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET		63
	A.	Përfundim	63
	B.	Rekomandime	64

IBRD 30432R
KOSOVO
This map was produced by the Map Design Unit of The World Bank. The boundaries, colors, denominations and any other information shown on this map do not imply, on the part of The World Bank Group, any judgment on the legal status of any territory, or any endorsement or acceptance of such boundaries.
MONTENEGRO
SERBIA
ALBANIA
FYR MACEDONIA
To Kraljeva
To Niš
To Leskovac
To Ivangrad
To Durrës
To Bitola
To Sofia
Leposavić (Leposaviq)
Zubin Potok
Zvečan
Mitrovica
Podujevo
Vučitrn (Vushtrrn)
Istok (Istog)
Srbica
Djurakovac
Obilić (Obiliq)
PRIŠTINA (PRISHTINË)
Peć (Peje)
Klina (Kline)
Glogovac (Gilogoc)
Kosovo Polje
Novo Brdo (Novo Berde)
Kosovska Kamenica
Dečani (Decan)
Lipljan (Lipjan)
Mališevo
Orahovac (Rahovec)
Štimlje (Shtime)
Gnjilane (Gjilani)
Djakovica (Gjakove)
Suva Reka (Suhareke)
Uroševac (Ferizaj)
Vitina (Viti)
Gabrica
Kačanik (Kaçanik)
Štrpce (Shterpce)
Prizren
Gora (Dragashi)
SKOPJE
Ibar
Gazivodsko Jezero
Batlavsko Jezero
Gračanička Jezero
Radonjičko Jezero
Lab
Klina
Sitnica
Beli Drim
Erenik
Binačka Morava
Lepenac
Topčica
Jablanica
Former Malisevo Mun.
MAIN ROADS
RAILROADS
SELECTED CITIES
MUNICIPAL HEADQUARTERS*
NATIONAL CAPITAL
MUNICIPAL BOUNDARIES
BOUNDARY OF FORMER MALISEVO MUNICIPALITY
PROVINCE BOUNDARIES
REPUBLIC BOUNDARIES
INTERNATIONAL BOUNDARIES
*When two municipality names are shown, Serbian spellings are shown first, followed by Albanian spellings in parentheses. When only one name is shown, the spelling is the same in both languages.
0 10 20 30 Kilometers
0 10 20 Miles
20°00'
20°30'
21°00'
21°30'
43°00'
42°30'
42°00'
AUSTRIA
HUNGARY
SLOVENIA
CROATIA
ROMANIA
BOSNIA AND HERZEGOVINA
SERBIA AND MONTENEGRO
KOSOVO
BULGARIA
ITALY
ALBANIA
FYR MACEDONIA
GREECE
TURKEY
MOLDOVA
Black Sea
Aegean Sea
Tyrrhenian Sea
Adriatic Sea
MARCH 2003

LISTA E SHKURTESAVE

BeH	Bosnja dhe Hercegovina
ZNGJ	Zyrat Ndërlidhëse të Gjykatave
DÇC	Departamenti për Çështje Civile
DD	Departamenti i Drejtësisë
MPD	Marrëveshja Paqësore e Dejtonit
DRC	Këshilli Danez për Refugjatë
Z/PSSP	Zëvendës Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KENNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUPT	Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian për Kosovë
ESI	Iniciativa Evropiane për Stabilitet
KKBP	Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore
DÇBP	Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore
ICR	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
PZHBV	Person i zhvendosur brenda vendit
KFOR	Forca e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MKK	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
GPK	Grupi Punues Komunal për Kthim
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizata Joqeveritare
ZPL	Zyra e Përfaqësuesit të Lartë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KKP	Komisioni për Kërkesa Pronësore
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
PKK	Partia Kurde e Punës
RAE	Romë, Ashkali dhe Egjiptianë
RSG	Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Personat e Zhvendosur
PKRF	Projekti i Kthimit dhe Rehabilitimit në Fshatra
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
NSH	Ndërmarrje shoqërore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KSKB	Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Çështjet e të drejtave pronësore dhe sa mbrohen ato janë shumë komplekse dhe ndikojnë në të gjitha komunitetet në Kosovë. Ato ndikojnë në të gjitha aspektet e jetës në shoqërinë, e cila vazhdon të mbetet thellësisht e ndarë sipas përkatësisë etnike, identitetit dhe klasës. Në periudhën prej përfundimit të konfliktit të armatosur në qershor të vitit 1999 e deri në shpalljen e njëanshme të pavarësisë më 17 shkurt 2008, këto vija ndarëse vazhduan të mbesin të thella.

Ky dokument fillon me një prezantim të çështjeve në fjalë. Pjesa e dytë e përshkruan shkurtimisht historinë e Kosovës që ka të bëj me të drejtën mbi pronat. Mënyrat e sjelljes të trashëguara nga e kaluara veprojnë si vija të vazhdimësisë të cilat mund t'i përdorim ne për të kuptuar realitetet e tanishme. Kosova ka qenë territor i Perandorisë Osmane për shekuj të tërë. Ky pushtim i gjatë ka lënë gjurmë jo vetëm në format e vendbanimeve, në identitetin e komunitetit (përmes kthimit në fenë islame) dhe në kulturë, por edhe në qasjen ndaj të drejtave pronësore pronësisë.

Kriza e viteve 90-ta kryesisht nënkuptonte shkatërrimin e autoritetit shtetëror në krahinën e Serbisë. Kur qeveria e Serbisë e revokojë autonominë e krahinës, shqiptarët e Kosovës reaguan me protesta dhe trazira civile në një lëvizje masive dhe të organizuar. Këto trazira shpesh ballafaqoheshin me represion policor, gjë që e përkeqësojë edhe më shumë krizën. Ky dokument shqyrton se si shkatërrimi i autoritetit dhe ligjet e ndryshme diskriminuese që ndikonin në shitjet ndëretnike të pronave i kontribuuan ngritjes së nivelit të shitjeve të pavërtetuara të pronave.

Konflikti i armatosur gueril, i zhvilluar nga pjesëtarët e të ashtuquajturës Ushtri Çlirimtare e Kosovës (UCK), në vitin 1998 dhe periudha pas intervenimit të NATO-s ndërmjet 24 marsit 1999 dhe 10 qershorit 1999 ishte shkretues dhe shkatërrimtar për të gjitha komunitetet në Kosovë. Zhvendosja masive e shqiptarëve të Kosovës u pasua me kthimin e tyre dhe me zhvendosjen masive të komuniteteve pakicë dhe me uzurpimin e pronave të tyre pas 10 qershorit 1999. Ky dokument trajton edhe situatën e përgjithshme dhe shkaqet e largimit të pakicave dhe uzurpimit të pronave të tyre, me fokus të veçantë në grupet e rrezikuara.

Autoritetet ndërkombëtare u ballafaquan me sfidën shumë të madhe të rindërtimit dhe administrimit të Kosovës pas konfliktit. Planifikuesit e misionit e kuptuan se në kontekstin specifik të Kosovës pas konfliktit, nuk ishte e mundur të bazoheshin në sistemin gjyqësor vendor për të trajtuar ketë problemin gjithnjë e më të madh të uzurpimit të pronave dhe dëbimit të pakicave. Për më tepër, policia dhe sistemi gjyqësor në masë të madhe ishin shkatërruar. Pjesa III e këtij dokumenti trajton institucionet e bashkësisë ndërkombëtare për mbikëqyrjen e administrimit të drejtësisë dhe për kthimin e pronave. Disa prej këtyre, siç janë Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ishin unike, organe të reja pothuaj ndërkombëtare nën një regjim të veçantë ligjor. Këto trajtohen hollësisht si edhe disa kundërthënie që kanë të bëjnë me punën e tyre.

Pjesa IV trajton sfidat që paraqesin konflikti pronësor dhe çështja e kthimit të pronave për drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Momentalisht në Kosovë janë të pazgjidhura ndërmjet 50,000 dhe 60,000 kërkesa për pronat e dëmtuara ose të uzurpuara dhe më shumë se 200,000 njerëz nga ky vend janë të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi. Në të vërtetë, procesi i kthimit të njerëzve dhe kthimit të pronave ka kontribuar pak në afrimin e Kosovës që të jetë një shoqëri e integruar dhe demokratike. Rastet e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Turqisë krahasohen me Kosovën për të vënë në pah ngjashmëritë dhe dallimet e rëndësishme në praktikat e kthimit të pronave dhe kthimit të njerëzve të zhvendosur. Dokumenti trajton sfidat e procesit të rikthimit të besimit civil në mes të qytetarëve dhe shtetit si dhe ndërmjet vet qytetarëve, që janë pjesë e pandarë në disa realitete të shoqërisë kosovare.

Janë dhënë një numër rekomandimesh për përmirësimin e efektivitetit të procesit të kthimit të pronave si pjesë e përpjekjes për zgjidhjen e qëndrueshme të problemeve të personave të zhvendosur. Këto rekomandime për UNMIK-un, EULEX-in dhe autoritetet kosovare përfshijnë edhe trajtimin e ciklit të mosndëshkimit që e rrethon krimin ndaj pronat, trajtimin e korrupsionit në gjyqësi, përmirësimin e komunikimit me PZHBV-të, ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë dhe parandalimin e shpronësimit të paligjshëm të pronave të PZHBV-ve. Në përgjithësi, udhëheqësit politik dhe të komunitetit në Kosovë dhe Serbi duhet të fillojnë detyrën e vështirë të marrjes së përgjegjësive për padrejtësitë e së kaluarës.

Çdo njeri është mbret në shtëpinë e tij *– proverb shqiptar*

I. HYRJE

"*Po ju shkruaj që të shpreh shqetësimin tim të thellë për tentimin e fundit të Komunës së Klinës për të shkatërruar shtëpinë time në qytetin e Klinës, ku jemi kthyer në shtator të vitit 2007. Kjo do të lë familjen time pa kulm mbi kokë...*"[1]

Kështu fillon letra dërguar Zyrës së Komisarit të Policisë nga një ish-person i zhvendosur në Klinë,[2] i cili shpreh ankthin dhe, në disa raste edhe dëshpërimin që shpesh e rrethon çështjen e të drejtave pronësore në Kosovë. Çështjet e të drejtave pronësore në Kosovë dhe sa ato mbrohen janë shumë komplekse dhe ndikojnë në të gjitha komunitetet në Kosovë. Ato ndikojnë në të gjitha aspektet e jetës në ketë shoqëri që vazhdon të jetë thellësisht e ndarë sipas përkatësisë etnike, identitetit dhe klasës. Në periudhën prej përfundimit të konfliktit të armatosur në qershor të vitit 1999 e deri në shpalljen e njëanshme të pavarësisë më 17 shkurt 2008, këto vija ndarëse vazhduan të mbesin të thella.

Të drejtat pronësore dhe praktikat në lidhje me blerjen, shitjen, regjistrimin dhe shfrytëzimin e pronës që nga viti 1999, shpesh përkojnë me këto vija ndarëse. Megjithatë, këto çështje tejkalojnë ndarjet në mes të komuniteteve dhe pasqyrojnë atë se sa mbretëron dhe me sa efikasitet zbatohet sundimi i ligjit në Kosovë. Derisa institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare kanë arritur njëfarë progresi në reformimin e procesit, zbatimi rrënjësor i të drejtave pronësore në gjithë Kosovën vazhdon të mbetet problem. Kjo gjendje mund të shërbejë si prizëm përmes të cilës mund kuptohen disa nga problemet strukturore që ka shoqëria në Kosovë dhe që pengojnë progresin e saj ekonomik dhe demokratik.

Gjendja jo e kënaqshme e të drejtave pronësore në Kosovë vazhdon të paraqes potencial për të shkaktuar konflikte jo vetëm ndërmjet shumicës dominuese shqiptare dhe komuniteteve të tjera por edhe në mes të vetë pjesëtarëve të komunitetit shumicë, pasi që janë të theksuara dallimet klasore dhe klanore dhe pasi që elita e pasluftës është duke e zgjeruar pushtetin e saj. Çfarëdo përpjekje për futjen ose zbatimin e masave të drejtësisë tranzicionale në Kosovë duhet të marrë parasysh çështjet pronësore. Ato prekin disa prej qasjeve të njohura tradicionale të drejtësisë tranzicionale për shpërblimin e viktimave, kthimin e pronës, të drejtën për kthimin e njerëzve, përkujtimet,[3] si dhe aspektet e tjera të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve. Këto përfshijnë demografinë, format e vendbanimit dhe pronësisë, zhvillimin ekonomik, stabilitetin social, respektimin e trashëgimisë kulturore, drejtësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor; të gjitha

[1] Letra dërguar Zyrës së Komisarit të Policisë, e datës 1 korrik 2008, nga një serb i Kosovës i kthyer në Klinë.

[2] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/43, e datës 27 korrik 2000 e rregullon përdorimin e emrave të qyteteve dhe fshatrave në Kosovë. Kjo Rregullore përcakton përdorimin zyrtar të emrave të komunave në gjuhën shqipe dhe serbe. Që nga atëherë në raportet zyrtare të OKB-së dhe OSBE-së përdoren të dy emrat zyrtarë, në shqip dhe serbisht, për qytetet dhe fshatrat për të shmangur çfarëdo diskriminimi.

[3] Paul van Zyl, "Promovimi i drejtësisë tranzicionale në shoqëritë pas konflikteve," në *Qeverisja e sigurisë në ndërtimin e paqes së paskonflikteve*, bot. A. Bryden dhe H. Hanggi, (Gjenevë: Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), 2005), 209.

këto, pjesërisht ose plotësisht, ndikojnë në drejtimin që do e merr shoqëria kosovare në të ardhmen.

Tashmë ekziston një numër i konsiderueshëm i dokumenteve dhe studimesh për çështjen e të drejtave pronësore në Kosovë. Ky dokument propozon qasjen ndaj kësaj çështjeje nga perspektiva e "vlerës së shtuar", duke pasur parasysh mësimet e mësuara nga historia dhe mënyrën me të cilën bashkësia ndërkombëtare i ka trajtuar çështjet e të drejtave pronësore pas intervenimit të saj në vitin 1999. Ky dokument së pari do të shqyrtojë historinë e valës së konflikteve pronësore ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë (në radhë të parë ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës) dhe se si i kanë kontribuar kësaj gjendjeje disa faktorë të caktuar kulturor, politik dhe shoqëror. Dokumenti pastaj bën vlerësimin se si janë përpjekur bashkësia ndërkombëtare dhe institucionet vendore që të trajtojnë konfliktet pronësore. Në fund dokumenti përfundon me një analizë të pasojave të mundshme në rast se vazhdon problemi i konfliktit pronësor. Kjo pjesë fokusohet në pasojat e masave të drejtësisë tranzicionale dhe shpresën për lëvizjen graduale drejt pajtimit[4] në shoqërinë kosovare.

Në fund të fundit, konfliktet pronësore ngritin çështje shqetësuese rreth të drejtës për dinjitet, liri, siguri dhe pranim. Kosova është vend i vogël dhe vazhdon të jetë jashtëzakonisht tradicionale dhe konzervative. Në këtë kontekst, vuajtjet e familjeve individuale të privuara nga shtëpitë ose prona e tyre me vite të tëra si rezultat i uzurpimit të paligjshëm ose për shkak të pamundësisë për të marrë sërish pronën e cila është shitur përmes mashtrimit ose është shpronësuar në mënyrë të paligjshme, shkatërrojnë vlerat e vjetra të fqinjësisë së mirë dhe solidaritetit, të cilat kanë qenë themele të shoqërisë kosovare.[5] Dhe kjo paraqet pengesa të patejkalueshme për pajtim.

Paqja dhe zhvillimi shoqëror kërkojnë një sistem në të cilin të drejtat pronësore respektohen në mënyrë të plotë, pavarësisht se a është fjala për ndonjë shqiptar, serb të zhvendosur të Kosovës që përpiqet të kthej pronën e tij, apo rom që jeton i pasigurt në ndonjë vendbanim joformal. Praktikat e tanishme janë larg nga të qenit ideale dhe në fakt e rrisin hendekun ndërmjet komuniteti shumicë dhe komuniteteve pakicë, si dhe ndërmjet klasave të ndryshme brenda vet komunitetit shumicë. Shpresojmë se ky dokument do të kontribuojë në pasqyrimin e të drejtave pronësore dhe do të ndihmojë në trajtimin e trashëgimisë nga e kaluara. Zëra të shprehjes së ankthit, si ai në letrën më lartë, vazhdojnë të dëgjohen në Kosovë, duke paraqitur kështu lutjet e individëve dhe familjeve. U takon autoriteteve ndërkombëtare dhe vendore jo vetëm të dëgjojnë, por edhe të punojnë në mënyrë efikase për një qeveri ku mbretëron sundimi i ligjit dhe në të cilën "qytetarët të cilët e llogarisin si gjë të mirë të qenit të arsyeshëm dhe racional dhe që shihen nga të tjerët si të tillë, të veprojnë të shtyrë nga mirësia e tyre për të bërë atë që e kërkon drejtësia."[6]

[4] Ndonëse nuk ka ndonjë përkufizim unanim për pajtimin dhe përdorimi i tij mund të jetë çorientues, në këtë raport pajtimi i referohet procesit të tejkalimit të ndarjeve në shoqëri. Shih faqen 43 për një përkufizim më të saktë.
[5] Shih Dushan Batakoviq, *Kosovo i Metohija u srpsko-arbanaskim odnosima* (Prishtinë: Jedinstvo, 1991) dhe Noel Malcolm, *Kosova: Një histori e shkurtër* (Nju Jork: New York University Press, 2002), 12. Këto i kam përmirësuar duke u bazuar në kontrollimin e faqeve të internetit të Dushanit dhe NYU
[6] John Rawls, *Justice as Fairness* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 2001), 202.

Bir musibet, yuz tembihten iyidir.

Një vuajtje vlen sa njëqind paralajmërime. – Proverb turk

II. HISTORIA E VALËS SË KONFLIKTIT PRONËSOR NË KOSOVË

A. HISTORIA E KOHËS SË PERANDORISË OSMANE

Konflikti pronësor në Kosovë përfshinë një numër shqyrtimesh që përkojnë me njëra-tjetrën. Zhvillimet dhe përmbysjet politike në këtë territor u zhvilluan në një kontekst të veçantë kulturor dhe shoqëror që i kishte disa nga rrënjët e veta në të kaluarën. E tërë kjo së bashku ka ndikuar gjatë kësaj kohe në demografinë dhe format e vendbanimeve. Format e sjelljes të trashëguara nga e kaluara shërbejnë si vija të vazhdimësisë që do të mund të përdornim ne për të kuptuar realitetet e tanishme, përkundër shpejtësisë së ndryshimeve spektakulare socio-ekonomike që kanë ngjarë në Kosovë në këto 20 vitet e fundit.

Kosova ka qenë territor nën Perandorinë Osmane për shekuj të tërë. Ky pushtim i gjatë ka lënë gjurmë në format e vendbanimeve, në identitetin dhe kulturën e komunitetit (përmes kthimit në fenë islame), si dhe në qasjet ndaj të drejtave pronësore dhe pronësisë. Atëherë nuk bëhej rilevimi i tokës, si i tillë, dhe kadastrat ishin një përzierje e popullatës dhe shënimeve tradicionalet të mbledhjes së tagrave.[7] Pronësia mbi pronat bazohej në sistemin e certifikatave të ndarjes së tokave të quajtura *tabi (tapi)*.[8] Tapitë identifikonin pronarin dhe banesën (shtëpinë) e tij, dhe paraqisnin një përshkrim të parcelës, kufijtë e saj dhe emrat e pronarëve të parcelave fqinje. Shumë elemente të sistemit të tapive më vonë u inkorporuan në ligjet dhe rregulloret e Mbretërisë së Serbisë (pasuese e Perandorisë Osmane) dhe më vonë në ato të Mbretërisë së Jugosllavisë.

Si rezultat i këtij sistemi, disa segmente të popullatës shqiptare të Kosovës, e veçanërisht të popullatës rome, nuk i kanë regjistruar pronat në mënyrë formale kur Jugosllavia i bëri rilevimet e plota kadastrale. Rilevimi i parë i tillë është bërë në vitin 1923 dhe ka përfunduar në vitin 1937; rilevimi i fundit që mbulojë tërë territorin e Kosovës u zhvillua ndërmjet vitit 1978 dhe 1982, por u zbatua kryesisht në zonat urbane.[9] Rezistenca kundër regjistrimit të pronave pësojë rënie me kalimin e kohës dhe me rritjen e nivelit të arsimimit dhe integrimit shoqëror, por rezistenca ende vazhdonte. Kjo ndodhi pjesërisht për shkak të arsyeve shoqërore dhe kulturore. Pasi që disa familje shqiptare dhe rome ndiheshin të margjinalizuara nga ajo që ata e konsideronin si shoqëri "të huaj" (d.m.th., shtetin jugosllav), ata nuk e konsideronin të rëndësishme që të kishin dokumente pronësore për pronat e patundshme. Për më tepër, shumë familje zgjodhën që të mos e regjistrojnë zyrtarisht pronën e tyre për të shmangur pagesën e tarifave dhe taksave të larta të regjistrimit dhe taksave për transaksione pronësore.

[7] David Stanfield et al., "Një vlerësim i të drejtave pronësore në Kosovë: Raporti përfundimtar," USAID, 2004.
[8] Ibid.
[9] Ibid.

Shqiptarët e Kosovës si bartës të traditave shtetërore dhe fetare Osmane, papritur u gjenden si pakicë në shtetin serb pas Luftës së Parë Ballkanike më 1912 dhe përfshirjes së Kosovës në kuadër të Mbretërisë së Serbisë.[10] Para kësaj ngjarje, pesë shekujt e sundimit Osman kishin përcaktuar kornizën shoqërore dhe ekonomike (sistemi *millet*) i cili përcaktonte të drejtat dhe obligimet në bazë të përkatësisë shoqërore dhe fetare. Identiteti kolektiv dhe traditat shoqërore konzervative janë zhvilluar paralelisht me shtresëzimin e shoqërisë sipas përkatësisë fetare. Si myslimanë,[11] shqiptarët e Kosovës në parim kanë gëzuar status të privilegjuar kundrejt serbëve që i përkisnin Kishës Ortodokse, e të cilët kishin statusin *dhimmi* (qytetarë jomyslimanë të mbrojtur zyrtarisht, të cilët ishin të obliguar tu paguanin autoriteteve myslimane taksat e vëna). Bashkë me ketë status të privilegjuar, shqiptarët e Kosovës po ashtu gëzonin një shkallë relativisht të lartë të autonomisë për të jetuar në rajone malore nën udhëheqësit tradicional të klaneve dhe fiseve.

Sistemi millet nuk përjashtonte dallimet mes klasave brenda komunitetit. Kështu që gradualisht u zhvillua një klasë e shqiptarëve të pasur urban të cilët lidhën aleanca (dhe shpesh u martuan) me familjet turke në qendrat urbane të Kosovës. Kjo ishte si kontrast ndaj varfërisë në zonat rurale dhe analfabetizmit të familjeve të tjera tradicionale shqiptare, përkundër privilegjeve që ua jepnin atyre Osmanët për posedim të tokave dhe për mbajtje të armëve.

Serbët e Kosovës ishin pothuaj ekskluzivisht fshatarë të pashkolluar që punonin në tokat e pronarëve turq dhe shqiptarë ose që tërhiqeshin në *mahallat* e thella malore (vendbanime tradicionale) për t'i ikur shkatërrimit nga taksat e vëna nga elita myslimane. Ata grupoheshin në *zadruga*, një grumbullim i familjeve të lidhura patriarkale që ndanin detyrat bujqësore dhe frytet e punës së përbashkët. Shumë nga këto vendbanime tradicionale (ndonëse shumica të braktisura) ende mund të gjenden në rajonin e Anamoravës në pjesën lindore të Kosovës së sotme. Serbët e Kosovës ishin trashëgimtarë të popullatës serbe që ka ekzistuar në Kosovë që nga Mesjeta kur ajo ishte pjesë e Serbisë. Me kalimin e kohës, pushtimi Osman, revoltat e më pastajme dhe dyndjet periodike jashtë këtij territori ndikuan në demografinë e popullsisë.

Pesë shekujt e sundimit Osman bën që serbët dhe shqiptarët të ndahen sipas fesë; ata gradualisht u bënë dy grupe shoqërore dhe politike kundërshtare.[12] Armiqësia ndëretnike u rrit në Kosovë në shekullin 19 kur serbët në *pashallëkun*[13] e Beogradit u emancipuan me sukses nga sundimi Osman dhe kërkuan që të rimarrin territorin e humbur duke krijuar një komb-shtet modern. Shqiptarët mbetën segment konzervativ i popullsisë, i ndarë ndërmjet lojalitetit ndaj shtetit

[10] Dushan Batakoviq, "Kosova dhe Metohia: Konflikti Serbo-Shqiptar," Instituti për Studime Ballkanike, Beograd, 1997.

[11] Në Kosovë ekziston një komunitet i vogël i shqiptarëve katolikë, kryesisht të përqendruar në Prizren, Klinë dhe Gjakovë. Është vështirë për të gjetur shifra të sakta për ketë, por ekziston një konsensus i përgjithshëm se komuniteti i shqiptarëve të fesë katolike përbën më pak se 5 për qind të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Kosovë. Shih, Refki Alija, 'Katedralja e re simbolizon rilindjen katolike në Kosovë', Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), 6 shtator 2007.

[12] Ibid.

[13] Entitet territorial osman.

Osman si garantues i privilegjeve të tyre dhe mënyrës tradicionale të jetës dhe nevojës për tu mobilizuar për të mbrojtur interesat e tyre autonome. Shqiptarët myslimanë i rezistuan me dhunë reformave të *Tanzimatit* të mesit të shekullit XIX të imponuara nga Konstantinopoli, të cilat kërcënonin privilegjet dhe statusin në Perandorinë Osmane.[14] Kah fundi i shekullit XIX, shpërtheu dhuna ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë edhe për shkak të mungesës së ligjshmërisë në një kohë kur autoriteti sundues Osman fillojë të shkatërrohet në gjithë Ballkanin. Disa udhëheqës shqiptarë të Kosovës shfryen frustrimin e tyre kundër fshatarëve serbë, të cilët filluan t'i shohin si popullsi "e huaj" dhe si vegël e mundshme për përpjekjet ekspansioniste të Serbisë.

B. KRIZA NE VITET E NËNTËDHJETA

Kosova hyri në vitet e 90-ta në një kontekst të polarizuar në të cilin, pas suprimimit të autonomisë së krahinës më 1989,[15] kur u përjashtuan një numër i madh i zyrtarëve dhe drejtuesve shqiptarë të Partisë Komuniste. Zyrtarët në Beograd bën zëvendësimin e tyre me të emëruar politikë. Serbët zunë funksionet kyçe drejtuese dhe politike në krahinë, që nga kryetarët e komunave e deri te drejtorët e ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Shqiptarët e tjerë u tërhoqën vullnetarisht nga institucionet shtetërore, qoftë në shenjë proteste ose duke u solidarizuar me lëvizjen politike të shqiptarëve të Kosovës. Kjo lëvizje politike, edhe pse theksohej se është protestë paqësore, nuk artikulojë konceptin e qytetarëve për të ardhmen; në vend të kësaj ajo kontestojë gjendjen ekzistuese politike dhe sociale në Kosovë përmes gjuhës së kundërshtimit kombëtar dhe emancipimit kombëtar. Si pasojë e kësaj ideologjie, shoqëria shqiptare nga fillimi deri në mesin e viteve 1990-ta papritur u gjet në një zonë të hirtë, duke vepruar jashtë institucioneve shtetërore dhe duke pasur sa më pak kontakte zyrtare me ta që të jetë e mundur.

Kjo tërheqje nga institucionet shtetërore dhe korniza ligjore e shoqërisë kanë pasur një efekt negativ te banorët e Kosovës që përjetuan konfliktin e vitit 1998 dhe 1999. U zhvilluan mënyra joformale për arritjen e marrëveshjeve biznesore, siç u zhvillua edhe tregu i zi. U rrit edhe kontrabanda e të gjitha mallrave, veçanërisht e naftës, ilaçeve, alkooleve, cigareve dhe armëve. Përdorimi i forcës për zgjidhjen e problemeve u bë praktikë e pranueshme ose e tolerueshme, dhe klanet dolën sërish në sipërfaqe dhe u forcuan edhe më shumë në mungesë të autoritetit shtetëror. Praktika e bërjes së aranzhimeve joformale jashtë ligjit do të ketë ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet pronësore, veçanërisht pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999. Jehona e të gjitha këtyre zhvillimeve ende vazhdon të ndihet në Kosovë.

Kriza e viteve 90-ta kryesisht nënkuptonte shkatërrimin e autoritetit shtetëror në krahinë. Kur qeveria e Serbisë e suprimoi autonominë e Kosovës, shqiptarët e Kosovës reaguan me protesta

[14] *Tanzimati ishte* një seri e reformave në Perandorinë Osmane që filluan në vitin 1839. Këto reforma u përpoqën të integrojnë më shumë popullsinë jomyslimane dhe joturke në shoqërinë osmane, duke përmirësuar të drejtat e tyre civile dhe duke u garantuar atyre të drejta të barabarta. Këto reforma u konsideruan si kërcënim për privilegjet tradicionale feudale dhe fetare të myslimanëve në Ballkan.

[15] Kushtetuta e vitit 1974 e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë krijoi krahinat serbe të Vojvodinës dhe Kosovës si autonome.

dhe mosbindje qytetare në formë të lëvizjes masive dhe të organizuar të quajtur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e udhëhequr nga Ibrahim Rugova. Grevat, protestat dhe veprimet e tjera të organizuara shpesh u ballafaquan me represion brutal policor, gjë që qoj në një jostabilitet edhe më të madh. Megjithatë, autoritetet shtetërore qëllimisht u bën se gjoja nuk po e vërejnë ekonominë joformale dhe "institucionet paralele" shqiptare në Kosovë (shkollat, klinikat, etj), duke shpresuar se kjo do të sigurojë paqe me elitën shqiptare të Kosovës. Kështu që si rezultat, korrupsioni dhe praktikat joligjore që u zhvilluan në lidhje me tregtinë – përfshirë edhe tregtinë me pronat – u forcuan edhe më shumë.

Qeveria e Serbisë miratoi një varg ligjesh të reja në vitin 1991 për të rregulluar transaksionet pronësore,[16] si plotësim i ligjit kryesor që rregullon pronën dhe marrëdhëniet pronësore në Kosovë në sistemin e pronësisë shoqërore, Ligji për Marrëdhëniet Themelore Pronësore të vitit 1980[17] (shih sqarimin në dy paragrafët më poshtë). Në kontekstin e polarizuar politik të shënuar me një rritje të nacionalizmit, zbatimi i këtyre ligjeve të reja u dëshmua të jetë diskriminues. Çdo kontratë pronësore ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme duhej të aprovohej nga drejtoria për çështje pronësore.[18] Ky obligim kishte për qëllim që të sigurojë që asnjë transaksion pronësor të mos mund të bëhet nëse drejtoria do të konsideronte se ai do të ndryshojë përbërjen etnike të popullsisë ose nëse kjo i nxiste pjesëtarët e një komuniteti të caktuar që të largoheshin nga vendi.[19]

Shumë shqiptarë dhe serbë në Kosovë i injoruan këto ligje të reja dhe bën kontrata që nuk u përmbaheshin kushteve ligjore.[20] Popullsia gjithnjë e më e madhe shqiptare kishte nevojë për më shumë tokë dhe shtëpi në zonat urbane. Shumë serbë të Kosovës, pavarësisht privilegjeve dhe lehtësirave që u ofronte qeverisja e drejtpërdrejtë nga Beogradi, ua shitën pronat e tyre shqiptarëve të Kosovës në bazë të kontratave të pavërtetuara. Këto transaksione joformale do të tregohen të jenë problematike pas vitit 1999 kur gjykatat lokale dhe bashkësia ndërkombëtare bënë përpjekje të paraqesin një pasqyrë të vërtetë të pronësisë. Numri i madh i transaksioneve pronësore joformale krijuan mundësinë për korrupsion dhe manipulime me pronat e braktisura gjatë periudhës pas konfliktit.

Statusi, blerja dhe shitja e banesave ose apartamenteve ishte problematike në vitet e 90-ta. Sipas Ligjit themelor për pronën, "askush dhe çdokush" teorikisht mund të posedonte një pronë.[21] Ligji mbështeste parimin e pronësisë sociale, e cila u mundësonte njerëzve të kenë në pronësi struktura

[16] Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e kufizimeve të transaksioneve të pasurisë së patundshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, 22/91 e 18 prillit 1991); Ligji për kushtet, mënyrat dhe procedurat e dhënies së tokës bujqësore qytetarëve që duan të punojnë dhe jetojnë në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 43/91 e 20 korrikut 1991).
[17] Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nr. 6/80, 1980.
[18] Departamenti i Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë.
[19] OSBE, Misioni në Kosovë, "Kosova – Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006, 30.
[20] Ibid.
[21] David Stanfield et al., "Një vlerësim i të drejtave pronësore në Kosovë: Raporti përfundimtar," USAID, 2004, 27.

por jo edhe tokë, ku një person mund të kishte vetëm të drejtën e shfrytëzimit të tokës. Kjo përcaktojë ndryshimin ndërmjet posedimit dhe pronësisë, por në praktikë, të dyja ishin pothuaj e njëjta gjë. Më 1992, parlamenti i Serbisë miratojë një ligj që mundësonte privatizimin e banesave. Megjithatë, gjatë procesit një numër i shqiptarëve të Kosovës i humbën të drejtat pronësore mbi banesat e privatizuara sepse ata tashmë ishin përjashtuar nga NSH-të përkatëse të cilat ishin pronare të banesave.

Pas konfliktit bashkësia ndërkombëtare përmes Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore (DÇBP), u përpoq të marrë vendime për kërkesat e bëra nga shqiptarët për banesat që nuk ishin privatizuar si rezultat i zbatimit të legjislacionit të qeverisë serbe të viteve 90-ta për pronën. Megjithatë, vetëm pak sish patën sukses sepse ishte e vështirë të kalohet pragu i të qenit pronar i një prone para se ajo të merret.[22] Ekzistonte një problem serioz në mekanizmin me të cilin u privatizuan banesat e NSH-ve, pasi ndërmarrja e cila ishte pronare e banesave ose u privatizua vet ose u bë jofunksionale. Në disa raste, NSH-të u privatizuan pa banesat, duke rezultuar në një harresë ligjore për poseduesit që donin të blinin banesat që ishin në pronësi shoqërore e të cilat ata i shfrytëzonin.[23] Mekanizmi joadekuat i privatizimit të banesave shoqërore u dha shumë liri të veprimit drejtorëve të NSH-ve, situatë kjo e cila e la të hapur mundësinë për korrupsion dhe marrëveshje jo të besueshme. Për shembull, disa shqiptarë që shfrytëzonin banesat shoqërore u vonuan në blerjen e tyre sepse ata besonin në mënyrë naive në premtimet që kishin marrë nga drejtorët e kompanive ose nga drejtoria për të drejta pronësore se nuk kanë pse brengosen sepse ata gjendeshin në listën e blerjes sipas dispozitave ligjore, për të marrë vesh vetëm më vonë se NSH-ja është privatizuar dhe banesat e saj u ishin 'shitur' punëtorëve të tjerë. Kur fillojë konflikti i armatosur, shitjet u ndërprenë dhe punëtorët e përfshirë qoftë në kontestimin e vendimeve të privatizimit qoftë në fillimin e transaksioneve të privatizimit sipas ligjit e konsideronin procesin të ndërprerë.[24]

Konflikti i armatosur gueril, i bërë nga pjesëtarët e ashtuquajturës Ushtri Çlirimtare të Kosovës (UÇK) më 1998, dhe intervenimi i më pastajmë i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) ndërmjet marsit dhe qershorit 1999, ishte shkretues dhe shkatërrues për të gjitha komunitetet në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, dhjetëra mijëra shtëpi të shqiptarëve të Kosovës u shkatërruan qoftë gjatë luftimeve ose operacioneve kundër kryengritësve ose si hakmarrje e një varg bandash të paramilitarëve serbë, të cilët shfrytëzonin gjendjen e mungesës së ligjshmërisë për përfitime personale. Shumë objekte publike dhe monumente kulturore dhe fetare të shqiptarëve po ashtu u dëmtuan dhe shkatërruan.[25] Qindra mijëra shqiptarë të Kosovës u larguan nga krahina gjatë kësaj periudhe. Forcat serbe ose ato të UÇK-së i detyruan disa prej tyre të largohen, ndërsa të tjerët ikën nga luftimet. Shkatërrimi ishte veçanërisht i rëndë në rajonin e

[22] Ibid.
[23] Ibid.
[24] Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë Kosovare të Pronës, 27 korrik 2008.
[25] Këshilli i Bashkësisë Islame të Kosovës vlerëson se 217 xhami janë dëmtuar, prishur ose shkatërruar si dhe katër *Medrese* (shkolla tradicionale islame) dhe tri *Teqe* (objekte tradicionale sufiste për lutje). Ndonëse disa prej këtyre objekteve janë shkatërruar gjatë luftimeve, është e qartë se të tjerat janë vënë qëllimisht në shënjestër.

Drenicës dhe të Pejës të cilat lidheshin me kufirin me Shqipërinë, sepse në këto rajone – që konsideroheshin vatra të kryengritjes – u zhvilluan luftimet më të mëdha.

C. PAS VITIT 1999

Periudha pas tërheqjes së Armatës Jugosllave dhe forcave serbe të sigurisë në qershor të vitit 1999 ishte me rëndësi për evolucionin e çështjes së të drejtave pronësore dhe të konfliktit pronësor. Me largimin e forcave serbe, UÇK-ja u shtri në gjithë Kosovën, shpesh para se të arrijnë trupat e forcës së Kosovës (KFOR) të NATO-s. UÇK-ja ngriti pika kontrolli dhe filloj të ushtrojë aktivitetin policor në një numër qytetesh dhe fshatrash. Në bazë të Marrëveshjes së Kumanovës dhe Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (KSKB)[26] aktivitetet e tyre ishin të paligjshme, por trupat e KFOR-it nuk ndërhynë aq shumë në atë kohë. Qytete dhe fshatra të tëra humbën popullsinë e vet pakicë në një fushatë të më pastajme të frikësimit dhe terrorit. Për më pak se një vit pas arritjes së forcave ndërkombëtare dhe pas themelimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK),[27] pothuaj 230,000 serbë të Kosovës, romë, goranë dhe të tjerë ikën në Serbi dhe Mal të Zi, numër që nuk ka ndryshuar as sot.[28] Në të njëjtën kohë, qindra mijëra shqiptarë që kishin ikur në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Republikën e Shqipërisë u kthyen brenda pak muajsh, shpesh në mënyrë spontane dhe të paorganizuar.

Edhe pse taktika e frikësimit dhe terrorit ishin drejtuar në mënyrë të qartë në ndjekjen e jo-shqiptarëve nga qytetet dhe fshatrat, ato po ashtu ishin të drejtuara edhe kundër disa shqiptarëve

[26] NATO dhe Armata Jugosllave e nënshkruan Marrëveshjen e Kumanovës më 9 qershor 1999, e cila i dha fund fushatës së bombardimit të NATO-s. Marrëveshja tekniko-ushtarake i diktoi kushtet për tërheqjen e Armatës Jugosllave dhe policisë së Serbisë dhe për hyrjen dhe përgjegjësitë e forcës paqeruajtëse të dominuar nga NATO-ja të njohur si "Forca e Kosovës" (KFOR).

[27]. UNMIK-u u krijua me Rezolutën 1244 të KSKB-së të datës 10 qershor 1999 si mision i administratës civile me qëllim të qeverisjes së përkohshme të krahinës dhe mbikëqyrjes së rindërtimit të shtëpive, infrastrukturës dhe krijimit të një administrate funksionale të qeverisë dhe drejtësisë.

[28] UNHCR, "Analiza e gjendjes se personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova në Serbi: Ligji dhe praktika, UNHCR, mars 2007. Në Kosovë jetojnë edhe një numër i komuniteteve të tjera joshqiptare: boshnjakë, turq, kroatë, ashkali dhe egjiptianë. Është e vështirë të vërtetohen shifrat e popullsisë për secilin nga këto komunitete të vogla pasi që regjistrimi i fundit i popullsisë është bërë në vitin 1991 (të cilin e bojkotuan shqiptarët). Vlerësimet e OSBE-së konfirmojnë se këto shifra kanë pësuar rënie prej vitit 1999. Shumë turq dhe boshnjakë pas vitit 1999 u larguan për në Turqi dhe për në Evropën Perëndimore, ndonëse disa shkuan në Serbi ose në BeH. Ashkalitë dhe egjiptianët futen në një grup me romët si "ciganë"; që të tri këto komunitetet kanë kaluar nëpër kohëra të vështira që nga konflikti. Sipas Atit Matej Palic, një udhëheqës i komunitetit kroat, në Kosovë në vitin 1998 jetonin rreth 1,300 kroatë në fshatin Letnicë të komunës së Vitisë dhe në Janjevë të komunës së Lipjanit. Që nga përfundimi i konfliktit, kanë mbetur rreth 320, pothuaj të gjithë në fshatin Janjevë. Shumë kroatë u larguan për në Kroaci pas qershorit të vitit 1999 si rezultat i pasigurisë dhe presionit që bëhej mbi ta për të shitur shtëpitë. Boshnjakët në fillim vuanin nga atmosfera e përgjithshme e pasigurisë e cila mbizotëroi pas përfundimit të konfliktit. Në mënyrë të veçantë vuanin ata boshnjakë që nuk dinin të flisnin shqip, si rezultat i diskriminimit gjuhësor. Turqit janë një komunitet i vogël dhe i integruar mirë, i cili në përgjithësi nuk ka vuajtur nga ndonjë përndjekje sistematike pas përfundimit të konfliktit. Megjithatë, ata ankohen për mosrespektimin e të drejtës së tyre gjuhësore, veçanërisht në zonat ku kjo popullsi është më e përqendruar, siç është rajoni i Prizrenit dhe për diskriminim në punësim. Për gjendjen e komuniteteve boshnjake dhe turke, shih Projekti për Marrëdhënie Etnike , "Tryezat e Rrumbullakëta për Kosovën: Prishtinë 2001-2005," 2006, dhe "Raporti hije i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare," 17 gusht 2005.

etnik të cilit kishin qenë besnik ndaj shtetit jugosllav ose të cilët i përkisnin fraksionit kundërshtar politik. Pastrimi etnik po ashtu përkonte pjesërisht me fenomenin shoqëror të pas konfliktit në të cilin një numër i madh i shqiptarëve migruan nga vendet rurale në qytete, në kërkim të shtëpive për banim dhe mundësive më të mira për jetë. Disa prej këtyre shqiptarëve nga zonat rurale i kishin humbur shtëpitë gjatë konfliktit. Ky migrim në qytete i dhjetëra mijëra njerëzve ndodhi shumë shpejt; brenda dy viteve pas vitit 1999, popullsia e disa prej qyteteve kryesore të Kosovës (Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Mitrovicës) u dyfishua, e në disa raste edhe u trefishua.

Gjatë gjithës kësaj periudhe pas konfliktit, serbët dhe romët e Kosovës, veçanërisht në qytete të vogla, iknin nga shtëpitë e tyre pas vrasjeve dhe zhdukjeve që ndodhnin nga një bllok i banesave në bllokun tjetër.[29] Në zonat rurale familjet braktisën shtëpitë e tyre dhe ikën në karvanët e refugjatëve drejt Serbisë. Pas braktisjes, shumë prej shtëpive të tyre u shkatërruan. Në qytete, shfrytëzuesit e paligjshëm dhe të tjerët u vendosën nëpër shtëpitë e braktisura nga pakicat që kishin ikur. Bandat e lidhura me UÇK-në vepruan si "shpërndarës" të banesave për pjesëtarët e tjerë të klanit ose njerëzve që vinin nga rajonet e tyre. Nganjëherë shpërndarësit nuk kërkonin para, por zakonisht ata kërkonin që t'i paguhet një qira jozyrtare ndonjë pjesëtari të UÇK-së.[30]

Praktikat që kanë të bëjnë me uzurpimin e pronës ishin të ndryshme në Kosovë, varësisht prej specifikave demografike të rajonit. Në përgjithësi, marrjet e organizuara të pronave nga pjesëtarët që kishin të bënin me UÇK-në shpesh konsideroheshin si një shpërblim legjitim për kontributin që ata kishin dhënë në luftën kundër Serbisë.[31] Motivimi nacionalist në shërbim të Kosovës së pavarur shqiptare u përzje me motivimin për përfitim dhe me nevojën për shtëpi banimi për migruesit nga zonat rurale. Shumë pjesëtarë të UÇK-së morën nën kontroll shumë banesa dhe shtëpi, të cilat më vonë ata do t'i shisnin në bazë të titujve të rrejshëm mbi pronën ose përmes autorizimeve të rrejshme. Blerësit legjitim shqiptarë, që kërkonin pronarët legjitim serb, nganjëherë bëheshin viktima të zhvatjes nga shfrytëzuesi i paligjshëm dhe u duhej të paguanin para për tu lejuar të blejnë pronën. Para vitit 1999, një numër shtëpish kishin ndërruar pronarë disa herë pa ndonjë dokumentacion të vlefshëm; ky proces vazhdojë në periudhën e pasluftës nën tutelën e UÇK-së.[32] Një numër i ish udhëheqësve të UÇK-së hyn në politikë, biznes ose në administratën qeveritare, dhe vazhduan të kishin të zëna prona në mënyrë të paligjshme.

Bashkë me pronat banesore në qyteza dhe qytete, në të njëjtën mënyrë u morën edhe dhjetëra mijëra biznese, dyqane dhe prona bujqësore. Marrjet e paligjshme përfshinin pronat që u

[29] Për më shumë shpjegime për ketë fushatë të terrorit në Prishtinë në qershor të vitit 1999, shih intervistën "Të ndjekur nga Kosova", të bërë nga Jared Israel me Cedomir Prlincevic, udhëheqës i komunitetit hebre në Prishtinë dhe ish shef i arkivit të Kosovës, më 30 gusht 1999.

[30] Më vonë e transformuar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). TMK-ja është dashur të jetë trupë për mbrojtje civile, por në realitet thelbi i kësaj organizate përbëhej nga pjesëtarët, struktura dhe ideologjia e UÇK-së. Shih po ashtu Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/8, "për themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës", të 20 shtatorit 1999.

[31] Intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 22 korrik 2008.

[32] Eleanor Beardsley, "Kush çka ka në pronësi? OKB-ja merret me rrëmujën rreth banesave dhe shtëpive në Kosovë" Christian Science Monitor, 10 janar 2002.

përkisnin pakicave ose shtetit, edhe pse kishte disa raste edhe të pronave që u përkisnin shqiptarëve. Marrja e pronave banesore, komerciale dhe bujqësore ishte pjesë e sistemit të "pushtetit në hije" që kishin krijuar disa klane të ndryshme dhe udhëheqës klanesh të lidhur me rrjetet e UÇK-së. Kur bashkësia ndërkombëtare vazhdojë të krijojë struktura të reja administrative dhe qeveritare në nivelin komunal dhe qendror në Kosovë, ky pushtet shpesh minonte reformat dhe i bënte institucionet joefikase. Frikësimi dhe besnikëria ndaj klanit shërbenin si forca të fuqishme që të detyronin njerëzit të mos sfidonin këto qendra të reja të pushtetit. Shqiptarët që kërkonin të blinin ose merrnin me qira dyqane që kishin qenë në pronësi të pakicave, detyroheshin të paguajnë një "taksë patriotike" (praktikë e ngjashme me reketimin) për të mundur të mbesin në biznes.

Vala e fundit e dhunës kundër pakicave pas përfundimit të konfliktit ndodhi gjatë trazirave që filluan më 17 mars 2004. Shtrirja dhe përmasa që morën trazirat e zunë në befasi bashkësinë ndërkombëtare, duke ekspozuar kështu parregullsi të qarta në strukturat dhe politikat e Policisë së UNMIK-ut, KFOR-it dhe Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).[33] Në bazë të raporteve të rrejshme se serbët ishin përgjegjës për mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër, pjesëmarrësit shqiptarë në trazira vunë në shënjestër vendbanimet serbe, rome dhe ashkali gjithandej Kosovës.[34] Këto sulmet ishin edhe të organizuara mirë por edhe spontane; autobusët transportonin pjesëmarrësit në trazira deri te vendbanimet e pakicave, ndërsa banorët lokalë i drejtonin ata në shtëpitë e pakicave.[35] Pas dy ditësh shkatërrimi, u vranë 19 njerëz, afër 800 shtëpi të serbëve, romëve dhe ashkalive u dogjën dhe shkatërruan, 33 kisha dhe manastire ortodokse serbe u dogjën dhe 4,100 njerëz u zhvendosën.[36]

Trazirat ishin një goditje për normalizimin dhe pajtimin. Shumica e shtëpive të shkatërruara më në fund u rindërtuan gjatë dy viteve të ardhshme, por disa persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) vendosën të mos kthehen dhe i shitën pronat e tyre.[37] Këshilli i Evropës, Qeveria e Serbisë, Kisha Ortodokse Serbe dhe Autoritetet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) në Kosovë

[33] Human Rights Watch, "Dështimi i mbrojtjes: Dhuna kundër pakicave në Kosovë, mars 2004", Vëllimi 16, nr. 6(d), korrik 2004.

[34] Rreth 51,000 shqiptarë morën pjesë në trazirat kundër pakicave që zgjatën tri ditë. Shih Human Rights Watch, "Dështimi i mbrojtjes: Dhuna kundër pakicave në Kosovë, mars 2004," 25 korrik 2004.

[35] Ibid. Raporti i Human Rights Watch ofron një analizë të hollësishme të zhvillimit të trazirave në qytetet dhe fshatrat e ndryshme në Kosovë, duke sqaruar se si grupet ekstremiste lokale të organizuara mirë i drejtuan turmat e shqiptarëve që ishin mbledhur në mënyrë spontane të sulmojnë pakicat dhe shtëpitë e tyre: "Edhe elementet spontane edhe ato të organizuara që qëndronin pas kësaj dhune vepruan duke pasur një qëllim të përbashkët: të heqin qafe serbët etnik të mbetur dhe komunitetet e tjera pakicë në Kosovë. Kur filloi dhuna, ajo u përhap në të gjithë Kosovën pothuaj me saktësi milimetrike: pas dy ditë trazirash, u dogj çdo shtëpi serbe, rome ose ashkali në shumicën e komuniteteve të prekura nga dhuna, por shtëpitë fqinje të shqiptarëve nuk u prekën."

[36] Ibid.

[37] Në fund, vetëm një numër i vogël i PZHBV-ve u kthyen në Kosovë. Rasti i fshatit Frashër afër Mitrovicës është shembull i mirë i kësaj. Të gjitha shtëpitë e serbëve u shkatërruan gjatë trazirave, edhe pse në afërsi ishte një bazë ushtarake e KFOR-it francez. Në fund, jo më shumë se 72 veta u kthyen pas rindërtimit të disa prej shtëpive. Megjithatë, pas një serie vjedhjesh dhe thyerjesh të shtëpive, të gjithë me përjashtim të katër vetave u larguan sërish, për të mos u kthyer më kurrë. Traumat nga trazirat e kanë luhatur shumë besimin e tyre në forcat ndërkombëtare të sigurisë dhe në fqinjët e tyre shqiptarë. Rrjedhimisht, banorët serbë të fshatit Frashër filluan gradualisht t'i qesin në shitje shtëpitë e tyre.

nënshkruan më 2005 një protokoll për mbikëqyrjen e rindërtimit të kishave dhe manastireve të shkatërruara.

D. MONUMENTET

Marrjet e pronave banesore, komerciale dhe bujqësore nuk ishin të vetmit shkaktarë të konflikteve pronësore në periudhën e pas konfliktit. Në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Kosovës monumentet dhe trashëgimia e komuniteteve pakicë, kryesisht asaj serbe, u vandalizuan ose shkatërruan. Që nga viti 1999, kjo valë shkatërrimi ka rrënuar 155 kisha dhe manastire të Kishës Ortodokse Serbe,[38] statujat e figurave të letërsisë dhe ato publike, varrezat serbe dhe monumentet e Luftës së Dytë Botërore. Në të njëjtën kohë, banorët lokalë të lidhur me UÇK-në e zunë tokën publike për të ndërtuar monumente për luftën e UÇK-së dhe për luftëtarët e UÇK-së të rënë gjatë konfliktit. Këto monumente dhe përmendore tani e kanë mbushur mjedisin e Kosovës; në disa raste ato gjenden në vende kundërthënëse afër komuniteteve pakicë.[39] Ndërtimi i këtyre përmendoreve për UÇK-në në tokën publike ose në tokën e shpronësuar vazhdon edhe sot. Ekzistimi i këtyre përmendoreve të UÇK-së dhe mungesa pothuaj e plotë e monumenteve të kulturave të tjera nëpër qytete dhe fshatra (me përjashtim të Mitrovicës Veriore) kanë bërë që shumë pjesëtarë të komuniteteve pakicë të ndjehen të përjashtuar nga jeta publike.

E. NDËRTIMET PA LEJE

Për shkak të mungesës së agjencive efikase komunale dhe zbatimit të ligjit, fenomeni i ndërtimeve pa leje ka përfshirë tërë Kosovën. Migrimi rural urban, krimi i organizuar dhe rritja e korrupsionit po ashtu i kanë kontribuar këtij problemi. Në disa raste, pronat e PZHBV-ve janë zëvendësuar me ndërtesa të reja, zakonisht për qëllime komerciale. Shtëpitë – shumë prej tyre të papërfunduara – janë ndërtuar në tokën publike ose bujqësore ose në formë të parregullt në periferinë e zonave urbane. Dhjetëra mijëra objekte të tilla pa leje janë ndërtuar që nga viti 1999.[40] Bizneset, prej qebaptoreve të vogla deri te pompat e panumërta të benzinës dhe vetëshërbimet e mëdha, u shtuan pa i marrë parasysh rregulloret hapësinore ose lejet.

Luftimi i këtij problemi mori edhe jetë njerëzish në Prishtinë, ku shkuan për të jetuar shumica e njerëzve menjëherë pas përfundimit të konfliktit. Drejtori i urbanizmit të qytetit, Rexhep Luci, u vra në shtator 2000 pas fillimit të iniciativës për të zgjidhur problemin e ndërtimeve pa leje.[41]

---

[38] Faqja e internetit e Dioqezës së Rashkës-Prizrenit e Kishës Ortodokse Serbe, 2008.

[39] Dy raste e ilustrojnë ketë lloj të problemit pronësor. Në Gjakovë, komuna mori një pjesë të tokës që i takonte Kishës Ortodokse Serbe në të cilën dikur kishte një kishë; ndërtesa ishte dëmtuar më 1999 dhe përfundimisht u rrafshua me tokë më 17 mars 2004. Me 31 dhjetor 2005 komuna ndërtojë një monument për "Heronjtë e Luftës së UÇK-së" në atë tokë. Në komunën e Kamenicës, në qendër të qytetit pranë vendbanimit të fundit të mbetur serb, më 18 qershor 2000 u ngrit një monument i UÇK-së, edhe pse UNMIK-u e kishte ndaluar ndërtimin e tij. Ekzistojnë shumë raste të ngjashme, kryesisht në Prishtinë, Novobërdë dhe Shtërpcë.

[40] David Stanfield et al., "Një vlerësim i të drejtave pronësore në Kosovë: Raporti përfundimtar," USAID, 2004, 29.

[41] Shih Iniciativa për Stabilitet Evropian (ESI), "Vizionet utopike: Dështimet e qeverisjes në kryeqytetin e Kosovës," Dokument për diskutim, 8 qershor 2006.

Rasti i vrasjes së tij kurrë nuk është zgjidhur dhe kjo krijojë një atmosferë të mosndëshkimit ku mund të zhvilloheshin të gjitha llojet e ndërtimeve pa leje.

Fenomeni i ndërtimeve pa leje vazhdon të shqetësojë shoqërinë kosovare dhe pasqyron dobësinë e institucioneve qeveritare. Ndërtimet pa leje kanë quar në marrjen e pronave të PZHBV-ve, gjë që shpesh ua pamundëson atyre të rimarrin pronën e tyre ose të marrin kompensim për të. Një ndërtim i tillë e rrezikon seriozisht shoqërinë me problemet e ndotjes dhe shëndetit publik për shkak të mungesës së ujit të pijshëm dhe kanalizimit të duhur. Infrastruktura është dëmtuar shumë gjatë konfliktit; shtimi i vendbanimeve të shumta joformale dhe qendrave të biznesit vë edhe një barrë më shumë në shoqërinë edhe ashtu të varfër, e cila po përpiqet të zgjerojë infrastrukturën rrugore, furnizimin me ujë, kanalizimin, qendrat shëndetësore dhe shkollat.[42]

Një problem tjetër që lidhet me ndërtimet pa leje është humbja e shpejtë e tokës bujqësore në dobi të ndërmarrjeve komerciale.[43] Këto objekte pothuaj në mënyrë ekskluzive ndërtohen pranë rrugëve në tokën e pasur bujqësore, e cila më herët ka qenë pronë e serbëve dhe e banuar nga ta. Një ligj i kohës së Jugosllavisë që ndalonte ndërtimin e strukturave komerciale në tokën bujqësore pranë rrugëve ende është i vlefshëm, por nuk zbatohet. Kjo rrezikon zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Është e tepërt të thuhet, plaga e ndërtimeve pa leje në Kosovë pasqyron korrupsionin që mbizotëron në praktikat komunale dhe ndikimin e interesave të fuqishme që fshihen pas projekteve zhvillimore, pasi që institucionet janë të dobëta dhe pasi që nuk zbatohen rregulloret e hapësirës urbane.[44]

F. SHPRONËSIMI I PALIGJSHËM

Komunat në Kosovë që shfrytëzojnë praktikat jo të rregullta të shpronësimit i kontribuojnë konflikteve pronësore duke viktimizuar disa familje të caktuara. Në disa raste, motivi i përfitimit përkon me konsideratat ideologjike për marrjen e pronave të pakicave përmes shpronësimit të paligjshëm. Në shumë raste, viktima janë familjet shqiptare që kanë pak mundësi të kërkojnë drejtësi pasi të jetë shpronësuar prona dhe pasi të jenë rrënuar shtëpitë e tyre për të lejuar zhvillimet e reja. Që nga qershori 1999, shumë shpronësime në Kosovë kanë shkelur të drejtat pronësore dhe të drejtat e njeriut të viktimave.[45]

Ligji për shpronësim në Kosovë rregullon shpronësimin e pronave nga autoritetet publike.[46] Ligji përcakton katër hapa që duhet të ndërmarrë komuna para se të mund të shpronësojë ndonjë pronë. Së pari duhet të bëhen punët përgatitore për të përcaktuar se a është një parcelë e tokës e përshtatshme për zhvillim, para se të merret parasysh çështja e interesit të përbashkët.[47] Së dyti,

[42] Ibid.
[43] Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë Kosovare të Pronës, 27 korrik 2008.
[44] Ibid.
[45] OSBE – Misioni në Kosovë, "Shpronësimet në Kosovë," Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, dhjetor 2006.
[46] Ligji për shpronësimet, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 46/86, 1986.
[47] Neni 7 i Ligjit për shpronësim.

autoritetet duhet të vendosin se a i plotëson ndonjë projekt i caktuar kushtet e interesit të përbashkët si arsyetim për shpronësimin; prona mund të shpronësohet "kur është e nevojshme për ndërtimin e banesave ekonomike, objekte për shëndetin publik dhe objekte të tjera që janë me interes të përbashkët".[48] Nëse projekti konsiderohet se është me interes të përbashkët, atëherë propozimi për shpronësim i paraqitet autoriteteve kompetente komunale për fazën e tretë. Propozimi duhet të parashtrohet brenda dy vjetësh nga marrja e "vendimit për interesin e përbashkët" për miratim dhe për lëshimin e vendimit për shpronësim.[49] Së katërti, komisioni vlerësues komunal vendos se çfarë kompensimi duhet paguar dhe nga kush. Në të vërtetë, propozimi për shpronësim duhet të demonstrojë se ekzistojnë mjetet për kompensim.[50] Kompensimi po ashtu mund të përcaktohet edhe duke dhënë të drejta pronësore mbi ndonjë pronë tjetër të patundshme.[51]

Megjithatë realiteti tregon se kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin shumë shpronësime pa e respektuar fare ligjin. Shpesh komunat fillojnë shkatërrimin e shtëpive private dhe ndërtimet e më pastajme pa filluar fare procedurat e shpronësimit.[52] Shumë pronarë shtëpish mbeten pa kurrfarë mjeti juridik kur ballafaqohen me një akt të kryer dhe edhe nëse u ofrohet kompensim u ofrohet fare pak.[53] Në rast të pronës së PZHBV-ve, komunat bëjnë shumë pak përpjekje që të gjurmojnë dhe gjejnë pronarët – të cilët shpesh janë të zhvendosur në Serbi ose Mal të Zi – para shpronësimit të pronës së tyre. Në shumë raste, siç është ai në qytetin e Klinës, njerëzit që kthehen në shtëpitë e tyre kërcënohen me shpronësim në mënyrë që të hapet rruga për ndërtime fitimprurëse të blloqeve të banimit në lokacionet më të mira.[54] Përcaktimi i asaj se çka është "interes i përbashkët" në këto raste dhe në raste të tjera nuk e respekton ligjin dhe vendoset në mënyrë arbitrare me qëllim të realizimit të projekteve zhvillimore private. Shkatërrimi i pronave të PZHBV-ve në ketë mënyrë nënkupton se ata nuk kanë ku të kthehen.

Disa autoritete komunale përpiqen të anashkalojnë procedurat e shpronësimit duke "i bindur" poseduesit e pronave t'ia japin pronat e tyre komunës pa ndonjë kompensim ose për ndonjë shumë të kompensimit të caktuar në mënyrë arbitrare, e cila shpesh është shumë më e ulët se

[48] Neni 2 i Ligjit për shpronësim.
[49] OSBE – Misioni në Kosovë, "Shpronësimet në Kosovë," Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, dhjetor 2006.
[50] Ibid.
[51] Ibid. Kjo në fakt nënkupton se kompensimi do të jetë në formën e njohjes së të drejtës pronësore e jo të ndonjë kompensimi financiar.
[52] Ekzistojnë shembuj të shumtë që ilustrojnë praktikën e komunave, veçanërisht në komunat e Lipjanit, Obiliqit, Podujevës, Dragashit, Istogut, Shtimes dhe Suharekës. Këta shembuj janë theksuar edhe në raportin e OSBE-së për shpronësimet në Kosovë (shih më lartë).
[53] Një rast interesant që ilustron mjaft mirë ketë problem por dhe çështjen e përmendoreve të luftëtarëve të UÇK-së në komunën e Dragashit ku jeton komuniteti goran. Autoritetet e vetë emëruara lokale shpronësuan shtatë prona në mënyrë të paligjshme në vitin 2000 për të ndërtuar një përmendore dhe për zgjerimin e rrugës për në fshatin Zapluzhë. Shih OSBE – Misioni në Kosovë, "Shpronësimet në Kosovë," Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, dhjetor 2006, 10.
[54] Intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 22 korrik 2008.

vlera e tregut dhe nuk është në pajtim me ligjin.[55] Disa komuna të caktuara janë të njohura për kompensimin e pronave të shpronësuara duke shkëmbyer ato me prona shoqërore ose prona të NSH-ve të cilat janë nën mbikëqyrje të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).[56] Shitja e pasurisë së ndërmarrjeve publike ose shtetërore, përfshirë edhe të NSH-ve është rreptësishtë nën kompetencën e UNMIK-ut. Pasi që këto pasuri teknikisht i takonin ose ishin pjesë e shtetit të Serbisë, Rezoluta 1244 e KSKB-së i jep UNMIK-ut të drejtën e administrimit të përkohshëm të krahinës, përfshirë edhe mbikëqyrjen ekskluzive të NSH-ve, ndërmarrjeve publike dhe pronës së patundshme të tyre. Pasi që Kosova nuk ka qenë shtet dhe nuk i ka pasur atributet e shtetit, ajo nuk kishte mundësi që me ligj të shpronësojë pronat e patundshme.[57] Megjithatë, çështjet janë komplikuar edhe më shumë pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë më 17 shkurt 2008, pas mbylljes së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe pas miratimit të Kushtetutës së re të Kosovës në qershor të këtij viti. Rezoluta 1244 e KSKB-së vazhdon të jetë në fuqi, por qeveria e Kosovës tash deklaron se është plotësisht sovrane në territorin e vet dhe se mund të vendos për pasuritë e ndonjë NSH-je ose ndërmarrjeje publike në bazë të ligjeve të Kosovës.

G. GRUPET E RREZIKUARA

i. Serbët e zhvendosur

Serbët e zhvendosur nga Kosova janë grup i rrezikuar, që tani po i afrohet vitit të dhjetë që është larg shtëpive dhe pronave të tyre. Ata kanë probleme të ngjashme me serbët që ende janë në Kosovë: diskriminimin, lirinë e lëvizjes, mungesën e mundësive për punësim, sigurinë dhe qasjen në shërbimet themelore. Megjithatë, problemet e serbëve të zhvendosur janë edhe më të rënda për shkak të statusit. Më shumë se 200,000 serbë të Kosovës jetojnë sot në Serbi.[58] Shumë prej tyre ballafaqohen me luftën e përditshme për jetë, pa pasur mundësi për punësim ose perspektivë dhe pa mundësi adekuate të banimit. Më shumë se 30,000 prej tyre jetojnë në kushte të tmerrshme në qendrat kolektive të drejtuara nga Sekretariati Shtetëror i Serbisë për refugjatë; kjo agjenci synon të mbyll qendrat kolektive ketë vit.

Kthimi i këtyre PZHBV-ve në shtëpitë e tyre vazhdon të jetë i pasigurt, duke pasur parasysh gjendjen e brishtë politike rreth statusit përfundimtar të Kosovës dhe masat jo të mjaftueshme që ekzistojnë rreth kthimit të njerëzve ose kthimit të pronave. PZHBV-të ballafaqohen me probleme në Kosovë në regjistrimin e banesave në zyrat përkatëse kadastrale për shkak të mungesës së dokumentacionit.[59] Për shkak të mungesës së resurseve dhe frikës së perceptuar për gjendjen e sigurisë, disa PZHBV kanë vështirësi të udhëtojnë në Kosovë dhe të kenë qasje në shërbime ose të kërkojnë personalisht dokumentet e rëndësishme personale nga institucionet kosovare. Në

[55] OSBE – Misioni në Kosovë, "Shpronësimet në Kosovë," Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit, dhjetor 2006, 19.
[56] Ibid., 9.
[57] Ibid., 9.
[58] UNHCR, "Analiza e gjendjes së personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova në Serbi: Ligji dhe praktika," mars 2007.
[59] Ibid., 11.

shumë raste, për shkak të kombinimit të problemeve të sigurisë dhe mungesës së mjeteve ekonomike, PZHBV-të hasin në vështirësi të mëdha që të marrin pronat e tyre në Kosovë, të cilat shpesh janë shkatërruar ose uzurpuar. Shumica e PZHBV-ve duhet të mbështeten në vizitat e organizuara që i zhvillojnë OJQ-të.

Shumë prej shënimeve komunale dhe qendrore kadastrale në Kosovë janë dërguar në Serbi në kulmin e konfliktit më 1999. Shënimet pronësore të lëna prapa, veçanërisht ato të regjistruara pas vitit 1994 janë jo të plota. Pasi që organet kadastrale në Serbi dhe Kosovë nuk bashkëpunojnë me njëra tjetrën, nuk ka shkëmbime të shënimeve ose njohje reciproke të dokumenteve të lëshuara.[60] Në këto rrethana vërtetimet pronësore të marra nga regjistrat e pronave nuk janë gjithmonë autentike dhe mund të mos përmbajnë informacione të azhurnuara.[61]

Këto vërtetime janë të nevojshme për fillimin e procedurës gjyqësore ose administrative në Kosovë. Duke pasur parasysh se autoritetet kosovare nuk i njohin dokumentet zyrtare (shënimet kadastrale, vendimet, kontratat, etj) të lëshuara ose verifikuara nga organet administrative serbe ose gjykatat nga Kosova që janë zhvendosur në Serbi, kjo paraqet një sfidë të rëndë për PZHBV-të.[62] Shumë prej këtyre PZHBV-ve bazohen në institucionet përkatëse lokale dhe ndërkombëtare për tu ndihmuar atyre që të mbrojnë të drejtat e tyre pronësore, ose fillojnë gradualisht të mos shpresojnë për kthimin e pronës së tyre. Statusi i tyre i rrezikuar shpesh bën që në Kosovë të mos dëgjohet zëri i tyre dhe u ofron atyre pak mundësi për të marrë ndonjë ndihmë. "PZHBV-të nuk janë të përfaqësuar mirë në institucionet e Kosovës", theksonte një zyrtar i lartë i Agjencisë Kosovare të Pronës. "Askush nuk luan rol aktiv në mbrojtjen e interesave të tyre pasi të merren vendimet [në rastet pronësore]. Është shumë vështirë të ndryshohet një vendim pasi të merret."[63]

ii. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët (RAE)

Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane (RAE) llogariten si komunitetet më të rrezikuara dhe më të margjinalizuara shoqërore. Që të tri këto janë në thelb i njëjti komunitet (që identifikohen si nga serbët ashtu edhe nga shqiptarët me emër të përbashkët "ciganë"), por ato e dallojnë veten në bazë të prejardhjes, kastës dhe gjuhës. Komunitetet RAE kanë vuajtur si rezultat i konfliktit. Rreth 300 veta janë vrarë ose zhdukur pas vitit 1999 sepse shqiptarët lokalë ose UÇK-ja i akuzonte ata për bashkëpunim me forcat serbe.[64] Sipas Komisariatit të Lartë të OKB-së për

[60] Ibid., 28.
[61] Ibid., 28.
[62] Ibid., 28. Pas përfundimit të konfliktit të armatosur në qershor 1999, autoritetet serbe i zhvendosën agjencitë administrative të Kosovës nëpër vende të ndryshme të Serbisë. Për shembull, Sekretariati i Punëve të Brendshme (SPB) për rajonin e Gjilanit është i vendosur në qytetin jugor të Serbisë Vranje, SPB për rajonin e Mitrovicës është i vendosur në qytetin e Serbisë qendrore Kralevë, e kështu me radhë. Qytetarët serbë të lindur në Kosovë ose të cilët e kanë vendbanimin e përhershëm në Kosovë duhet të shkojnë në këto zyra për të marrë dokumentacionin civil zyrtar, siç janë certifikatat e lindjes, letërnjoftimet, pasaportat, patentë shoferët, certifikatat e vdekjes, dokumentet mbi titullin, etj. Serbët, romët, goranët, turqit e po ashtu edhe shumë shqiptarë të Kosovës i shfrytëzojnë këto zyra.
[63] Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë Kosovare të Pronës, 27 korrik 2008.
[64] Intervistë me një udhëheqës të komunitetit rom, 3 shkurt 2009. Është me rëndësi të theksohet se numri 300 është vetëm një vlerësim, pasi që romët, ashkalitë dhe egjiptianët i kanë emrat që tingëllojnë si emra shqiptar dhe nuk janë

Refugjatë (UNHCR), vetëm 22,000 RAE janë të regjistruar si PZHBV në Serbi; por shumë prej tyre janë zhvendosur në Mal të Zi dhe në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.[65] Vlerësohet se deri në 50,000 RAE janë të zhvendosur dhe nuk janë të regjistruar.[66] Këta PZHBV jetojnë në kushte të mjerueshme, shpesh nën çdo nivel të dinjitetit njerëzor. Në qytetet gjithandej Serbisë qendrore dhe jugore, RAE-të e zhvendosur jetojnë në vendbanime joformale pa qasje në shërbimet themelore publike dhe pa ujë të pastër të pijshëm. Shtëpitë e tyre janë kasolle të ndërtuara nga metali i ndryshkur ose kartonët ose magazina të shndërruara në vendbanim ose kazerma të braktisura. Fëmijët ballafaqohen me vështirësi në shkolla si rezultat i diskriminimit dhe pengesave gjuhësore dhe shpesh ata shpejtë e braktisin shkollën, duke mos qenë të inkurajuar nga prindërit të cilët po ashtu kanë përjetuar një cikël të ngjashëm të varfërisë dhe diskriminimit.

Shumë PZHBV RAE mbesin pa u regjistruar dhe jetojnë në varfëri të skajshme jo vetëm për shkak të nivelit të ulët të arsimimit por edhe për shkak se nuk kanë dokumente personale.[67] Në një numër të familjeve RAE nga Kosova është duke ndodhur për gjenerata të tëra një fenomen i quajtur "mos-regjistrimi kronik". Pamundësia për të nxjerrë dokumente personale kalon nga një gjeneratë në tjetrën, ku një person nuk mund të dëshmojë se prindërit e tij kanë qenë qytetarë të Republikës së Serbisë (përfshirë Kosovën). Në rastet e tjera familjet RAE i kanë humbur dokumentet e tyre gjatë ikjes nga Kosova. Rezultati përfundimtar është se shumë familje nuk janë në gjendje të sigurojnë akomodim, ndihmë sociale ose kartela të sigurimit.

PZHBV-të RAE ballafaqohen me të njëjtat probleme në Kosovë, siç u përshkruan për PZHBV-të serbë, por këto probleme rëndohen nga racizmi më i theksuar dhe varfëria e rëndë që i lë këta njerëz me një përfaqësim dhe ndihmë fare të vogël.

Në Kosovë kanë mbetur ndërmjet 35,000 dhe 40,000 RAE. Shumë komunitete dhe vendbanime tradicionale janë shkatërruar në mënyrë të pariparueshme, e sidomos komunitetet e vendosura urbane të romëve në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan.[68] Komunitetet më të mëdha të mbetura RAE janë në rajonin e Gjakovës dhe Prizrenit; ata janë kryesisht egjiptianë dhe ashkali që jetojnë bashkë me komunitetin shqiptar. Disa romë në Kosovë jetojnë bashkë me serbët në enklavat e mëdha, siç është ajo e Graçanicës (afër Prishtinës), në Prilluzhë (komuna e Obiliqit) dhe në veri të lumit Ibër. Shumë RAE jetojnë në vendbanime joformale që nuk janë regjistruar kurrë në shënimet kadastrale; disa prej këtyre vendbanimeve datojnë që në kohërat e Perandorisë Osmane.

---

identifikuar sipas përkatësisë etnike në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) për personat e zhdukur.

[65] UNHCR, ""Analiza e gjendjes së personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova në Serbi: Ligji dhe praktika," mars 2007.

[66] Ibid. Shumica e PZHBV-ve në Serbi janë në fakt romë. Romët dallohen nga ashkalitë dhe egjiptianët sepse e kanë gjuhën rome si gjuhë amtare dhe serbishten si gjuhë të shkollimit të tyre. Ata ose janë myslimanë ose ortodoks. Ashkalitë dhe egjiptianët janë të gjithë myslimanë, kanë kryesisht emra dhe mbiemra shqiptarë dhe e flasin gjuhën shqipe si gjuhë të tyre amtare.

[67] UNHCR, ""Analiza e gjendjes së personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova në Serbi: Ligji dhe praktika," mars 2007.

[68] Forumi i Romëve dhe Ashkalive të Kosovës, "Dokumenti i qëndrimit tonë 2006," Janar 2006.

RAE-të ballafaqohen me diskriminim dhe mosrespektim në të gjitha nivelet e shoqërisë kosovare dhe e kanë shkallën më të lartë të papunësisë nga të gjitha komunitetet. Udhëheqësit e komunitetit brengosen se kjo shkallë edhe ashtu e lartë e papunësisë dhe varfërisë do të përkeqësohet edhe më shumë kur të përshpejtohet riatdhesimi i detyrueshëm i azilkërkuesve të refuzuar nga Evropa Perëndimore. Deri në 40,000 RAE që për momentin gjenden në Evropën Perëndimore me siguri se do të riatdhesohen me forcë në Kosovë.[69] Qeveria nuk ka politikë të ri-integrimit dhe as kapacitete sa i përket vendeve të punës, banimit dhe shërbimeve shëndetësore ose arsimore për të absorbuar këtë popullsi. Shumë prej shtëpive të tyre janë shkatërruar ose shpronësuar dhe atyre u mungon dokumentacioni personal dhe shënimet për titullin e tyre mbi pronat që kanë.

Gjendja e vështirë e romëve në Lagjen e Romëve është një rast i mirë që ilustron dështimin sistematik të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare për të trajtuar gjendjen e vështirë të romëve. Lagjja e Romëve ka qenë vendbanim rom në Mitrovicë me rreth 7,000 banorë para konfliktit. Familjet kanë jetuar në shtëpi në pronësi private dhe kanë marrë pjesë në ekonominë lokale, e sidomos në tregti dhe në shitjen e tekstileve të importuara. Në fund të konfliktit më 1999, romët u akuzuan se kishin bashkëpunuar me autoritetet serbe dhe ishin dëbuar. Pas dëbimit të tyre Lagja e Romëve u shkatërrua.

Romët ikën në vende të ndryshme. Më shumë se 7000 prej tyre shkuan në kampe të përkohshme në Leposaviq, Zveçan dhe në afërsi të minierës Trepça në Mitrovicën Veriore në një vend të kontaminuar nga plumbi. Familjet që qëndruan në ketë vend në fund kanë vuajtur nga helmimi nga plumbi. Bashkësia ndërkombëtare dhe institucionet vendore të Kosovës në fund bën përpjekje të gjejnë një zgjidhje për këta romë pas shpërthimit të skandalit për helmim nga plumbi. UNMIK-u dhe UNHCR-ja propozuan që disa prej familjeve të vendosen në ish kampin e KFOR-it francez të quajtur "Osterode" dhe tu ndërtohen shtëpitë në Lagjen e Romëve.

Udhëheqësit romë e kritikuan ashpër projektin e kthimit në Lagjen e Romëve.[70] Ata argumentuan se ndërtimi i një blloku banesor për strehimin e PZHBV-ve në vend të ndërtimit të shtëpive individuale ishte bërë pa konsultime të gjëra me vet njerëzit dhe nuk ka treguar ndjeshmëri për traditën kulturore rome. Ata po ashtu e kritikuan mungesën e komunikimit dhe njoftimit të romëve që jetonin jashtë vendit, në Diasporë.[71] Çështjet u komplikuan edhe më shumë kur autoritetet shqiptare në Komunën e Mitrovicës hartuan plane alternative për ndërtimin e një

[69] Ibid., 20. Në "Dokumentin e qëndrimit për nevojat e individëve nga Kosova për mbrojtje të vazhdueshme ndërkombëtare", të qershorit 2006, UNHCR-ja zyrtarisht i këshillon qeveritë që të mos i kthejnë njerëzit që u përkasin grupeve të rrezikuara në Kosovë. Në këto grupe hyjnë serbët, romët dhe shqiptarët që janë pakicë në pjesën veriore të lumit Ibër. Ky dokument është më i theksuar kur është fjala për komunitetin Ashkali. Sidoqoftë, deklarimi i njëanshëm i pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 – dhe njohja e saj nga shumica e shteteve të Evropës Perëndimore – bashkë me trendët brengosës ekonomik të kohëve të fundit, i ka bërë shumë njerëz që të frikësohen se qeveritë perëndimore do të shfrytëzojnë ketë realitet të ri diplomatik për të shpejtuar kthimin e azilkërkuesve nga Kosova.

[70] Forumi i Romëve dhe Ashkalive të Kosovës, "Qëndrimi ynë 2006," Janar 2006.

[71] Ibid., 23. Po ashtu, intervistë më Bashkim Ibishin, këshilltar i Kryeministrit të Kosovës për çështje të komuniteteve dhe udhëheqës i komunitetit rom, 4 shtator 2008.

qendre rekreative dhe një kompleksi tregtar në lokacionin e Lagjes duke shpronësuar pronat e banorëve të mëhershëm romë (disa prej të cilëve nuk ishin titullar të regjistruar të shtëpive të tyre).[72] Saga e projektit të kthimit në Lagjen e Romëve nënvizon një varg vështirësisë me të cilat ballafaqohen anëtarët e komunitetit RAE në sigurimin e të drejtave të tyre pronësore, veçanërisht sa i përket diskriminimit, mungesës së përfaqësimit të tyre dhe shpronësimit të paligjshëm të bazuar në mungesën e dokumenteve.

iii. Femrat

Femrat në Kosovë përfaqësojnë një grup tjetër të rrezikuar shoqëror. Modernizimi dhe ndryshimi dinamik shoqëror përkojnë me traditat konservative kur është fjala për statusin e grave. Statusi i nënshtruar i femrave në të gjitha aspektet e jetës së përgjithshme i tejkalon kufijtë etnik, edhe pse ai më shumë ndikon te femrat shqiptare dhe RAE në Kosovë. Qasja në të drejtat pronësore dhe në zotërimin e pronës janë dy në radhën e shumë treguesve shoqëror të progresit dhe barazisë së femrave. Ligji i Kosovës garanton të drejtat e barabarta për meshkujt dhe femrat, por pesha e kulturës dhe traditës dhe ndikimi negativ i varfërisë dhe arsimimit të dobët flasin kundër ndonjë barazie reale. Femrat janë veçanërisht në pozitë të keqe kur është fjala të drejtave pronësore dhe zotërimit aktual të pronës.

Të dhënat statistikore e konfirmojnë ketë pabarazi përmes qasjes joadekuate në resurse. Vajzat vazhdimisht e braktisin shkollimin më herët se djemtë dhe më rrallë e vijojnë shkollimin e mesëm dhe atë të lartë. Shkalla e analfabetizmit është më e lartë te femrat, veçanërisht në zonat rurale (deri në 26 për qind e femrave nga mosha 16 deri në 19 vjeçare).[73] Shëndeti riprodhues ka mbetur prapa vendeve fqinje. Kosova ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë në rajon dhe femrat kanë shkallën më të lartë të vdekjeve gjatë lindjes – më shumë se 21 në 100,000 lindje.[74] Kontracepsioni, edhe pse është në shitje, nuk përdoret aq shumë; në vitin 2000 më pak se 20 për qind e femrave thanë se përdorin ndonjë formë të kontrollit të lindjeve.[75]

Rreth 70 për qind e të gjitha femrave në Kosovë janë të papunësuara.[76] Sipas treguesve të tregut të punës, shkalla e papunësisë për femrat rurale që e kanë përfunduar shkollën e mesme shkon deri në 99.3 për qind. Kjo statistikë i referohet vetëm punës që paguhet dhe nuk mbulon punën që nuk paguhet të cilën e bëjnë në ekonomitë familjare. Përkundër, pranisë së femrave në disa pozita të larta dhe në pozita menaxheriale, duke përfshirë edhe ato në qeveri, femrat janë në përgjithësi të pafuqishme në shoqëritë patriarkale.

Trashëgimi i pronës dhe elementet e tjera të ligjit të familjes janë të ndikuara shumë nga nocionet tradicionale shqiptare të ligjit të inkorporuar në *Kanun* (ose "*Kanuni i Lekë Dukagjinit*"). Në disa

[72] Ibid., 23.
[73] Maddalena Pezzotti, "Të barabartë në çdo sferë të jetës," Fokus Kosova, UNMIK, Zyra për Çështje Gjinore.
[74] Ibid.
[75] Ibid.
[76] Ibid. Më shumë se 60 për qind e femrave që janë punësuar janë punonjëse të pakualifikuara.

zona të largëta malore të rajonit të Pejës, Kanuni zbatohet edhe në ligjin penal.[77] Ai bazohet në traditat zakonore gojore të paraqitura në masë të madhe në nocionet patriarkale të klanit dhe nderit. Kanuni e përcakton obligimin e gjakmarrjes si reagim ndaj ndonjë vrasjeje. Kjo shërben si metodë për rregullimin e marrëdhënieve brenda dhe ndërmjet fiseve për kontrollin e dhunës në shoqëri.

Në këtë kod tradicional, të drejtat e femrave janë shumë të kufizuara. Kanuni është i qartë në një numër vendesh rreth rolit vartës të femrave dhe paraqet hollësisht faktin se femrat nuk mund të trashëgojnë pronën.[78] Në shumë familje shqiptare anembanë Kosovës (veçanërisht ato që janë të varfra ose nga zonat rurale), femrat nuk trashëgojnë pronë kur u vdesin baballarët ose burrat. Në shumicën e rasteve, në mungesë të vëllait ose djalit, prona i jepet mashkullit më të afërt të personit të ndjerë. Femrat varen nga të afërmit meshkuj, pavarësisht se a është raporti mes tyre abuziv ose jo.

Si rezultat i kësaj praktike shumë femra shqiptare të Kosovës nuk mund të kenë kolateralin e nevojshëm për të marrë kredi nga bankat.[79] Kjo nënkupton se ato janë të privuara nga mundësia për të vepruar në mënyrë të pavarur nga meshkujt në ekonomi.[80] Në të vërtetë, disa femra përpiqen të ushtrojnë të drejtën e tyre për trashëgimin e pronës sipas ligjit, pesha e traditës dhe familja ndërhyn për të bllokuar në mënyrë efikase çdo përfitim që mund të fitojnë ato duke e bërë ketë. Një shembull nga Komuna e Deçanit në jugperëndim të Kosovës në mënyrë të qartë e ilustron ketë pikë. Një femër nga fshati Isniq u kthye nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të marrë vesh se një kushëriri të saj i ishte dhënë toka të cilën ajo e kishte trashëguar ligjërisht, për të paguar një gjak. Edhe pse emri i saj si trashëgimtare ishte i regjistruar si duhet në listat poseduese, ajo nuk ishte në gjendje që të marrë në posedim tokën e as të shes atë sepse kushëriri do të bllokonte këto veprime.[81]

Problemi i kufizimit të të drejtave pronësore është e ndërlidhur me realitetet e tjera siç janë abuzimi në familje. Kosova e ka një ndër nivelet më të larta të abuzimit familjar të femrave në rajon. Migrimi masiv urban i shqiptarëve nga zonat rurale ka shkaktuar një zhvendosje të madhe të strukturave të familjeve patriarkale në të cilat rolet përcaktohen me rregulla të rrepta të zakoneve dhe traditës. Jeta e qytetit, shpesh në banesa të vogla dhe të dendura ka kontribuar në prishjen e strukturës tradicionale të familjes shqiptare në Kosovë duke krijuar një anonimitet

[77] Shih "Le Kanun de Leke Dukagjini," i përkthyer nga Christian Gut. (Dukagjini Press, 2000). Veçanërisht ilustrues të kësaj pikëpamje botërore janë paragrafët 597, 598 dhe 600 të nenit 95 të kanunit: "Pour l'honneur pris, il n'y a pas d'amende. L'honneur pris ne se pardonne jamais"; "L'honneur pris ne se compense pas par de l'argent mais par du sang versé ou par un pardon généreux (par l'intermédiaire de gens de bon vouloir)"; dhe "Celui à qui l'on a pris l'honneur est considéré comme mort par le *Kanun.*"

[78] Ibid. Shih nenin 29 të Kanunit, "La femme est une outre qui doit tout supporter" ose nenin 33, paragrafi 58, "Le mari a droit: a) de conseiller et de corriger sa femme; b) de la battre et de l'enchaîner quand elle en vient à mépriser ses ordres"; ose nenin 36, paragrafi 88, "Le Kanun reconnaît comme héritier le fait et non la fille."

[79] Maddalena Pezzotti, "Të barabartë në çdo sferë të jetës," Fokus Kosova, UNMIK, Zyra për Çështje Gjinore.

[80] Ibid.

[81] Intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 22 korrik 2008.

gjithnjë në rritje në shoqërinë e Kosovës që nuk ka ekzistuar para konfliktit.[82] Dhe për ironi, kjo i rrezikon edhe më shumë femrat ndaj abuzimit pasi që tani zhduken mekanizmat e mbrojtjes së vazhdueshme në familjen e gjerë.

Duke qenë e qartë se është problem social i një sfere të gjerë, të drejtat e femrave, veçanërisht në lidhje me trashëgimin e pronës dhe të drejtën që të marrin pjesë si të barabarta në ekonomi, paraqesin një sfidë të vazhdueshme për zhvillimin e shoqërisë kosovare. Ekzistojnë ligjet dhe institucionet për mbikëqyrjen dhe sigurimin e barazisë gjinore, por shfrytëzimi i këtyre mekanizmave në kohën e zakoneve, traditës dhe varfërisë së rrënjosur vazhdon të jetë e vështirë.

iv. Shqiptarët e Kosovës në veri të lumit Ibër

Kategoria e fundit e rrezikuar e njerëzve të viktimizuar nga konflikti në Kosovë janë shqiptarët e Kosovës të cilët i kanë humbur pronat në veri të lumit Ibër dhe të cilët vazhdojnë të presin kthimin e të drejtave të tyre pronësore. Territori në veri të këtij lumi është e ngjitur me Serbinë dhe përfshinë komunat e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës Veriore. Serbët e Kosovës ishin shumicë para konfliktit.

Pas tërheqjes së Armatës Jugosllave dhe policisë së Serbisë nga rajoni, banorët organizuan grupe të vetëmbrojtjes të njohura si Rojat e Urës; këta ruanin pranë urës mbi Ibër e cila e ndante pjesën veriore dhe atë jugore të Mitrovicës për të mos lejuar hyrjen e UÇK-së. Në të njëjtën kohë ardhja e PZHBV-ve serbë nga pjesët e tjera të Kosovës krijoj një atmosferë të tensionuar në të cilën disa PZHBV, grupe vigjilente dhe të tjerë frikësuan dhe/ose dëbuan shumë banorë shqiptarë. Pronat e tyre pastaj u zunë ose uzurpuan nga PZHBV-të, të cilët kishin humbur shtëpitë e tyre në pjesët tjera të Kosovës, ose nga të tjerët të lidhur me grupet për vetëmbrojtje.

Shumë shqiptarë u detyruan të gjejnë dhe paguajnë për akomodimin e tyre në pjesën jugore të qytetit ose u vendosën te të afërmit e tyre në pjesët e tjera të Kosovës. Vetëm një numër i vogël i tyre ka pasur qasje në pronat e tyre pas vitit 1999, edhe pse ende ekzistojnë disa kontakte joformale në mes të fqinjëve duke mundësuar aranzhimet joformale të qiradhënies ose shfrytëzimit. Shumë pak prej pronave të shkatërruara janë rindërtuar. Janë rreth 1,200 kërkesa për pronat në veri, por shumë pak njerëz i kanë marrë pronat e tyre në riposedim, sepse policia heziton të ndihmojë në dëbimet e njerëzve nga pronat në këtë zonë për shkak të kushteve të sigurisë.[83] Pritja e gjatë dhe mosveprimi relativ i institucioneve përkatëse për tu marrë me kthimin e pronave, ka shtyrë një numër shqiptarësh që të shesin pronat e tyre, nganjëherë familjeve që i kishin zënë ato. Pjesa tjetër vazhdon të shpresojë se do ta kthejnë pronën e tyre, por kjo mbetet një sfidë duke pasur parasysh ndarjen e madhe politike që përfaqëson ura mbi Lumin Ibër.

[82] Tracy Wilkinson, "Femrat e Kosovës presin lirinë," *Los Angeles Times,* 10 mars 2008.
[83] Shih Iniciativa për Stabilitet Evropian (ESI), "Njerëzit apo territori? Propozim për Mitrovicën" 16 shkurt 2004.

***Nashti zhas vorta po drom o bango*.**

Nuk mund të ecësh drejt kur rruga është e lakuar –Proverb rom

III. QASJA E INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE DHE LOKALE NË ÇËSHTJEN E KTHIMIT TË PRONËS NË KOSOVË

A. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Pas përfundimit të konfliktit të armatosur qindra mijëra shqiptarë u kthyen në Kosovë, shumë prej tyre në prona që ishin dëmtuar ose shkatërruar. Gjendja e sigurisë qoj në largimin ose dëbimin e qindra mijëra serbëve, romëve dhe të tjerëve. Shtëpitë në zonat jashtë qyteteve që u përkisnin pakicave ishin shkatërruar, derisa ato në qyteza dhe qytete, siç janë shtëpitë e mëdha të banimit, ishin zënë në mënyrë të paligjshme. Një numër i NSH-ve dhe objekteve publike u vodhën dhe plaçkitën. Aktiviteti ekonomik, me përjashtim të trafikimit, tregtisë joformale dhe ekonomisë, në masë të madhe u ndërprenë. Njëjtë e shkretuar ishte edhe pasqyra e institucioneve të shkatërruara administrative dhe gjyqësore.

Me detyrimin e komuniteteve pakicë që të ikin, pasoi një valë e projekteve të ndërtimeve pa leje, plagë që është duke vazhduar edhe sot. Institucionet e dobëta, resurset e pakta, korrupsioni, frikësimi dhe qarkullimi jo i rregullt i parasë nga burime të panjohura i kontribuojnë këtij fenomeni. Përhapja e pompave të paligjshme të benzinës, bareve të hoteleve të frekuentuara shpesh nga prostitutat dhe strukturat e tjera komerciale e ka bërë policinë e OKB-së të vjen në përfundim se një numër i këtyre vendeve shërbejnë si instrument për shpëlarjen e parave.[84]

Ndërtimet pa leje dhe zëniet e pronave i kanë shtyrë një varg njerëzish prapa këtyre aktiviteteve që të përpiqen të legalizojnë gjendjen e tyre duke marrë dokumente që konfirmojnë të drejtat e tyre pronësore përmes institucioneve të reja që i gradualisht themeloi UNMIK-u pas vitit 1999. Për të bërë këtë ata shpesh shfrytëzonin metoda të dyshimta: falsifikimin e dokumenteve për titullin dhe letërnjoftimeve (nganjëherë të njerëzve të vdekur) për të kryer shitje të rrejshme të pronës së ndonjë PZHBV-je; autorizimet e falsifikuara të regjistruara në ndonjë gjykatë komunale të vendit ose në ndonjë në Mal të Zi; frikësimet ose korruptimin i zyrtarëve gjyqësor ose komunalë për vleftësimin (miratimin) e titullit pronësor; shpronësimet e paligjshme të pronës në të mirë të zhvilluesve me lidhje të mira dhe të zyrtarëve të korruptuar komunalë; dhe manipulimin e shënimeve kadastrale për ndryshimin e pronësisë mbi disa prona të caktuara.[85]

Duke marrë parasysh këtë kontekst, bashkësia ndërkombëtare u ballafaqua me sfida tepër të mëdha për trajtimin e çështjes së të drejtave pronësore dhe kthimit të pronës në Kosovën e pas

[84] Ilir Deda, "Kosova e administruar nga UNMIK-u," në raportin për vendet në tranzicion, Freedom House, 2008, 319, dhe shih Rob Gowland, "Gangsterët e Kosovës, plejbojt dhe sendviçat e nivelit të lartë," *The Guardian*, 17 maj 2006.

[85] Për një numër të shembujve magjepsës për të gjitha praktikat më lartë shih OSBE – Misioni në Kosovë, "Kosova. Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile," Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006.

konfliktit. Rezoluta 1244 e KSKB-së ishte e zbehtë rreth çështjes së të drejtave për kthimin e pronës,[86] duke mos e përmendur në mënyrë eksplicite ketë të fundit në dispozitat e saj.[87] Në dy raste, në nenin 9 (c) dhe nenin 11 (k), rezoluta vetëm e theksonte rëndësinë e misionit të ri të administratës civile për themelimin e "një mjedisi të sigurt në të cilin të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpitë e tyre të sigurt..."[88] Ndonëse e drejta ndërkombëtare nuk përcakton ndonjë model standard për mekanizmin e bërjes së kërkesave, ekziston një konsensus gjithnjë e më i madh se kthimi dhe kompensimi i pronave është komponentë vitale për çdo proces të ndërtimit të paqes.[89] Planifikuesit e misionit e kishin kuptuar se në kontekstin specifik të Kosovës pas konfliktit, me problemin gjithnjë e më të madh të uzurpimit të pronave dhe dëbimit të pakicave, nuk ishte e mundur të mbështeteshin në sistemin gjyqësor vendor për tu marrë me problemin. Për më tepër sistemi gjyqësor dhe i policisë është shkatërruar në masë të madhe pas konfliktit dhe duhej kohë për tu rindërtuar.

Bashkësia ndërkombëtare e krijoi një numër institucionesh për të luajtur rol kyç në zgjidhjen e krizës së pronave në Kosovë dhe në trajtimin e kësaj çështjeje urgjente të kthimit të pronave. Disa prej institucioneve, siç janë gjykatat lokale të reformuara dhe policia ishin krijuar që të jenë organe administrative të përkohshme, *ad hoc*, të dominuara nga bashkësia ndërkombëtare. Të gjitha institucionet përkatëse të përshkruara më poshtë kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë rol kyç në çështjet e kthimit të pronave. Megjithatë, një pikë me rëndësi që duhet pasur parasysh gjatë gjithë këtij përshkrimi është mungesa relative e një qasjeje të bashkërenduar dhe bashkëpunuese në çështjen e kthimit të pronave.

B. DREJTORIA PËR ÇËSHTJE BANESORE DHE PRONËSORE (DÇBP)

Bashkësia ndërkombëtare e ka krijuar DÇBP-në si organ ndërkombëtar i cili do të zgjidhte kërkesat për prona banesore në mënyrë të drejtë dhe efikase. DÇBP-ja ishte një organ i pavarur i themeluar nga UN-Habitati më seli në Najrobi të Kenisë. Ajo i mori fondet nga shtetet donatore, në radhë të parë nga qeveritë Zvicerane dhe Norvegjeze dhe nuk varej nga buxheti i përgjithshëm

[86] Duket se hartuesit e Rezolutës 1244 të KSKB-së i kishin marrë parasysh vetëm shqiptarët e Kosovës të zhvendosur si brenda ashtu edhe jashtë vendit deri në qershor 1999 kur e zhvilluan konceptin e kthimit dhe rindërtimit në këtë dokument. Megjithatë duket se shumë pak vëmendje, nëse ka pasur fare, i është kushtuar vlerësimit të zhvendosjes së komuniteteve joshqiptare pas qershorit 1999 dhe problemeve që dilnin nga kjo, siç është problemi i kthimit të pronës.

[87] Për dallim, Marrëveshja paqësore e Dejtonit për Bosnjën dhe Hercegovinën në mënyrë eksplicite përfshinte në tekstin e saj të drejtën për kthimin e pronës. Aneksi 7, Kapitulli 1, Neni I (I) thekson, "Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë që të kthehen lirisht në vendet e tyre të origjinës. Ata duhet të kenë të drejtë në kthimin e pronës nga e cila ishin privuar gjatë armiqësive prej vitit 1991 dhe në kompensim për çdo pronë e cila nuk mund tu kthehet atyre."

[88] Rezoluta 1244 e KSKB-së. 10 qershor 1999.

[89] Shih Parimet e Kombeve të Bashkuara për kthimin e banesave dhe pronave refugjatëve dhe personave të zhvendosur, "Parimet Pinheiro". Parimi 29(2) thekson se "Autoritetet kompetente e kanë për detyrë dhe përgjegjësi që të ndihmojnë Personat e zhvendosur brenda vendit që janë kthyer dhe rivendosur të marrin pronat dhe posedimet e tyre për aq sa është e mundur, prona këto që ata i kanë lënë pas ose të cilat u janë marrë me rastin e zhvendosjes së tyre. Kur nuk është e mundur të bëhet kthimi ose rimarrja e këtyre pronave, autoritetet kompetente duhet tu mundësojnë ose ndihmojnë këta persona që të marrin kompensimin e duhur ose ndonjë formë tjetër të shpërblimit."

i UNMIK-ut. Në kuadër të DÇBP-së, u themelua Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore (KKBP) si institucion pothuaj gjyqësor që do të merrte vendime për kërkesat e parashtruara. KKBP-ja e përbërë nga panelet prej një anëtari vendor dhe dy ndërkombëtarë, i shqyrtonte dëshmitë dhe dëgjonte kërkesat në seanca të mbyllura.

DÇBP-ja e menaxhonte tërë procesin. Korniza ligjore për DÇBP/KKBP-në është përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60. Kjo e fundit e përcaktonte juridiksionin ekskluziv të KKBP-së për tri lloje të kërkesave: kërkesat e kategorisë **A** që kishin të bënin me të drejtat pronësore të humbura gjatë zbatimit diskriminues të disa ligjeve të caktuara në periudhën prej vitit 1989 deri më 1999 (kategoria që përfshinte ekskluzivisht ish punëtorët shtetërorë shqiptarë); kërkesat e kategorisë **B** që kishin të bënin me transaksionet joformale pronësore të pronave banesore gjatë të njëjtës periudhë; dhe kërkesat e kategorisë **C** që kishin të bënin me humbjen e pronës banesore gjatë ose pas vitit 1999 (që kryesisht ishin të pakicave, më së shumti të serbëve).[90]

DÇBP-ja ekskluzivisht fokusohej në pronat banesore dhe deri në vitin 2005 nuk i kushtoi vëmendje të veçantë pronave komerciale dhe bujqësore, të cilat ishin lënë jashtë mandatit të saj. DÇBP-ja kishte një numër instrumentesh të ndryshme në dispozicion për të zgjidhur kërkesat. Pronat banesore mund të viheshin nën administrimin e DÇBP-së, nëse pronari i ligjshëm nuk ishte i gatshëm ose nuk kishte mundësi të kthehej dhe të marrë pronën në posedim. DÇBP-ja pastaj mund ta lëshonte pronën me qira dhe t'ia dërgonte qiranë pronarit, në mënyrë që PZHBV-të të mund të fitonin nga prona e tyre. DÇBP-ja, në marrëveshje me pronarin e ligjshëm, mund të ofronte të lëshonte banesën nën administrimin e saj për qëllime humanitare familjeve ose shfrytëzuesve të përligjshëm që nuk kishin shtëpi. DÇBP-ja kishte juridiksionin ekskluziv të dëbonte njerëzit që në mënyrë të paligjshme shfrytëzonin pronën dhe të siguronte largimin e tyre. Për këtë qëllim, DÇBP-ja nënshkroi një memorandum të mirëkuptimit (MiM) me Policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës për të siguruar ndihmën e tyre gjatë dëbimeve nga prona. Në fund, rregulloret përkatëse përcaktonin se vendimet e KKBP-së ishin përfundimtare, të zbatueshme dhe kundër tyre nuk mund të bëhej ankesë e as të rishqyrtim nga ndonjë gjykatë tjetër.[91]

Në vitet e para të DÇBP-së ajo ishte e hendikepuar për shkak të mungesës së fondeve, vështirësive në menaxhment dhe personelit dhe bashkërendimit të dobët me agjencitë e tjera përkatëse, sidomos me autoritetet komunale dhe me Agjencinë qendrore Kadastrale të Kosovës. DÇBP-së po ashtu i mori kohë edhe shtrirja në terren, veçanërisht kur është fjala për

[90] Shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, "për themelimin e Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionit për Kërkesa Banesore dhe Pronësore", 15 nëntor 1999, dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 për Kërkesat për pronat banesore dhe Rregulloren e Punës së Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionit për Çështje Banesore dhe Pronësore," 31 tetor 2000.

[91] Shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, e cila thekson se vendimet përfundimtare të KKBP-së janë të detyrueshme dhe duhet të zbatohen dhe nuk mund të rishqyrtohen nga asnjë organ gjyqësor ose administrativ në Kosovë..

komunikimin me komunitetet e PZHBV-ve; dëbimet nuk filluan deri tri vjet pas fillimit të punës së DÇBP-së.

Sidoqoftë, kur DÇBP-ja e punësojë personelin e duhur dhe kur e përgatiti një MiM funksional me policinë, ajo gradualisht fillojë të pranoi kërkesa nga të gjitha kategoritë dhe të vendos për to. Deri më 2007 DÇBP/ KKBP kishte marrë 28,828 vendime në lidhje me pronat banesore (98.9 për qind e të gjithë numrit prej 29,160 kërkesave).[92] Nëntëdhjetë për qind e të gjitha kërkesave për prona banesore ishin bërë nga pakicat, kryesisht nga serbët.[93]

Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton se njerëzit i morën sërish në posedim pronat e tyre dhe/ose se u kthyen në Kosovë. "Zbatimi" është një shprehje administrative që mbulon një numër të skenarëve të mëposhtme:

a) Parashtruesi i kërkesës (ai më së shpeshti është serb) e zgjidh ketë privatisht dhe e shet pronën.

b) Prona shkatërrohet dhe nuk mund të administrohet nga DÇBP-ja (shifrat zyrtare tregojnë së 10,108 prona të pakicave për të cilat ishin bërë kërkesat në KKBP u konstatuan se ishin shkatërruar dhe së këndejmi DÇBP/ KKBP-ja nuk mund të bënte asgjë. Në këto raste, KKBP-ja e lëshonte një deklaratë në të cilën e përcaktonte posedimin e ligjshëm të parashtruesit të kërkesës.[94]

c) DÇBP-ja bëhet administratore e pronës në mungesë të pronarit të ligjshëm.

d) DÇBP-ja refuzon rastin për mungesë të dëshmive.

e) Pronari i ligjshëm në fakt e merr në riposedim pronën.[95] Pronarët që ishin nga radhët e pakicave pastaj i kanë shitur shumë prona banesore në zonat urbane të cilat ata i morën sërish në posedim, sepse problemet e sigurisë dhe kushtet ekonomike i pengonin ata që të ktheheshin.

Përveç vonesave të gjata në marrjen e vendimeve përfundimtare, DÇBP-ja u ballafaqua edhe me një sfidë tjetër kur shfrytëzuesi(t) e paligjshëm hynin përsëri në pronë pas dëbimit. Në të tilla raste, pronarët nuk kishin ndonjë mjet tjetër për të marrë pronën sërish në posedim. Rregullorja 2000/60 e theksonte në mënyrë të qartë se pas dëbimit të një shfrytëzuesi të paligjshëm, DÇBP-ja do të plumbonte (vuloste me plumb) pronën dhe do t'ia dorëzonte çelësat pronarit të ligjshëm. Kur të bëhej kjo, juridiksioni i DÇBP-së përfundonte dhe rasti mbyllej.

PZHBV-të që u ballafaquan me një problem të tillë duhej të kontaktonin policinë ose të bënin ankesë në gjykatën lokale. Përkundër faktit se neni 13.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60

[92] OSBE – Misioni në Kosovë, "Tetë vjet pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i shtëpive dhe pronave në Kosovë", Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, qershor 2007.
[93] Dan Bilefsky, "Derisa Kosova rindërtohet, OKB-ja ngutet të kthejë pronat", *New York Times,* 16 shkurt 2008. Shih edhe faqen e internetit të Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP) (http://kpaonline.org).
[94] OSBE – Misioni në Kosovë, "Tetë vjet pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i shtëpive dhe pronave në Kosovë", Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, qershor 2007, 27.
[95] Ibid., 25.

përcaktonte se policia kishte autorizimet që të veprojë *ex officio* dhe të largojë shfrytëzuesit e paligjshëm,[96] ata shpesh refuzonin të vepronin pa urdhrin e prokurorit lokal. Edhe pse shfrytëzimi i paligjshëm i një prone ishte krim sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës,[97] policia hezitonte të akuzonte ose arrestonte fajtorët. Kjo në përgjithësi u mohonte PZHBV-ve të kthyer dhe të tjerëve të drejtat e tyre për të marrë pronën sërish në posedim, sepse prokurorët edhe nëse ndiqnin penalisht rastet kundër shfrytëzuesve të paligjshëm të pronave të PZHBV-e ose nëse urdhëronin policinë që t'i largojë ata, e bënin ketë shumë rrallë.

Janë veçanërisht shqetësuese rastet ku ishin të përfshirë politikanët, zyrtarët dhe institucionet në marrjen e paligjshme të pronave të pakicave. DÇBP-ja zhvillojë disa fushata për informimin e qytetarëve për çështjet që kishin të bënin me të drejtat pronësore në përpjekje që t'i bëjnë banorët e Kosovës të mos e konsiderojnë uzurpimin e pronës si praktikë e pranueshme. Megjithatë, kjo porosi për respektimin e sundimit të ligjit ishte minuar nga rastet kur ministrat, anëtarët e Kuvendit të Kosovës dhe kuvendeve komunale, gjyqtarët, policët dhe të tjerët posedonin prona në mënyrë të paligjshme.

Një numër i rasteve të profilit të lartë ku ishin të përfshirë ish pjesëtarë shumë të fuqishëm të UÇK-së ishin në ngjarje kryesore dhe i shkaktonin probleme serioze DÇBP-së,[98] por numri më i madh i rasteve që përfshinin zyrtarë më pak të njohur ishin tregues për ketë problem. Këto janë më të theksuara në rajonet ku PZHBV-të nuk i kanë shitur pronat e as nuk kanë treguar gatishmëri t'i shesin ato deri më tani. Disa shembuj të shkurtër e ilustrojnë ketë aspekt.[99]

Në komunën e Klinës në rajonin e Pejës, Komuna ua mori shtëpinë Vinka dhe Sasa Radosavljeviqit, një qifti serb që kishin ikur nga Kosova në vitin 1999, dhe e bënë atë qendër rinore. Qifti e fitoj ketë rast në KKBP, por komuna refuzojë tua kthente pronën dhe të zbrazte lokalet. Pas një presioni të vazhdueshëm nga UNMIK-u, DÇBP-ja dhe aktorët e tjerë politikë ndërkombëtar, komuna me hezitim ua ktheu shtëpinë Radosavljeviqëve. Ata u kthyen në shtator 2007. Pastaj Komuna vendosi të shpronësonte në mënyrë të paligjshme ketë pronë dhe e

[96] Shih nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, "për kërkesat për pronat banesore dhe Rregulloren e punës së Komisionit për Kërkesa Banesore dhe Pronësore", 31 tetor 2000. Neni thotë, "Drejtoria e njofton parashtruesin e kërkesës për datën e caktuar për dëbim nga prona. Pas ekzekutimit të dëbimit nga prona, nëse parashtruesi i kërkesës ose shfrytëzuesi i përkohshëm nuk është i pranishëm për ta marrë menjëherë pronën në posedim, zyrtari përgjegjës do të plumboj pronën dhe për ketë e njofton parashtruesin e kërkesës. Çdo person i cili pa ndonjë arsyetim të ligjshëm hyn në atë pronë duke e hequr plumbin mund të largohet nga prona prej autoriteteve për zbatimin e ligjit."

[97] Shih nenet 259 dhe 166 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

[98] Në tri raste të tilla që kanë të bëjnë me prona fitimprurëse në Prishtinë kanë qenë të përfshirë komandantët e lartë të UÇK-së: Sami Lushtaku, Remi Mustafa dhe vëllai i Kryeministrit Hashim Thaci. Në të tri rastet DÇBP-ja vendosi në favor të pronarëve të ligjshëm, por dëbimet nga prona ishin një proces i dhimbshëm duke përfshirë edhe Policinë e UNMIK-ut dhe ndërmjetësimin e zyrtarëve të lartë të administratës civile të UNMIK-ut. Në njërin nga rastet, pronarit serb të Kosovës ju deshtë të shes pronën e tij nën çmimin e tregut. Shih UNMIK, "Zvogëlimi i xhunglës pronësore," *Revista Fokus*, 2 tetor 2002.

[99] Shembujt janë marrë nga një intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut më 22 korrik 2008; letra e Znj. Radmila Vulicevic dërguar Zyrës së Komisarit të Policisë më 11 shtator 2008 dhe nga intervista me një klerik të lartë të Manastirit Ortodoks Serb Visoki Decani më 17 korrik 2008.

kërcënojë familjen se do t'ia shkatërronin shtëpinë e tyre. Komuna kishte ofruar 10,000 euro si kompensim në një proces që nuk i respektonte procedurat e Ligjit për shpronësim.

Radmila Vulicevic, një serbe e zhvendosur e ka një banesë në zonën më të mirë të Prishtinës, e cila ishte uzurpuar nga ish ministri i transportit dhe telekomunikacionit; ajo ka pritur për vite të tëra që ta marrë pronën e vet. Në qytetin e Pejës, Kryqi i Kuq i Kosovës ishte duke e shfrytëzuar shtëpinë e një PZHBV-je serb. Në qytetin e Istogut, Agjencia e Postës dhe Telegrafit të Kosovës më në fund u dëbua nga një shtëpi e një PZHBV-je tjetër serb.

Në qytetin Deçanit, komuna në mënyrë të njëanshme ka ndërruar fletët poseduese në zyrën komunale të kadastrës për të hequr Manastirin Ortodoks Serb të Visoki Decanit si pronar të dy parcelave të tokës, të cilat qeveria serbe ja kishte kthyer manastirit (në mungesë të Ligjit për Kthimin e Tokës) përmes një Akti të Faljes më 1997. Më 17 maj 2008, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) – duke shfrytëzuar autoritetin e tij ekzekutiv sipas Rezolutës 1244 të KSKB-së – urdhërojë komunën që t'i kthejë listat poseduese në kadastër në gjendjen e tyre të mëparshme, në pritje të ndonjë vendimi për të drejtat pronësore, por komuna refuzojë që të respektojë ketë.[100]

Këto dhe shembuj të tjerë të shumtë duket se pasqyrojnë mungesën shqetësuese të respektimit të parimit të të drejtave pronësore në një segment të shoqërisë së Kosovës. Fakti se disa zyrtarë dhe udhëheqës të komunitetit në mënyrë të paligjshme kanë zënë prona të pakicave i komplikonte edhe më shumë përpjekjet e DÇBP-së për kthimin e të drejtave pronësore, minonte porosinë për rëndësinë që ka respektimi i sundimit të ligjit dhe nënvizonte të metat serioze të shoqërisë kosovare në ketë aspekt.

C. AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS (AKP)

Hendeku gjithnjë e më i madh në mes të marrjes së vendimit për kërkesat për prona banesore nga DÇBP/ KKBP dhe mungesa e ndonjë veprimi për pronën komerciale dhe bujqësore, u bë tepër të madh për tu injoruar. Ky problem u theksua në raportin e tetorit 2005 të Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën, Kai Eide.[101] Raporti kishte për qëllim të shërbente si vlerësim se a ishin krijuar kushtet për të filluar procesin politik të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Eide identifikoj shfrytëzimin e paligjshëm të pronës komerciale dhe bujqësore si një ndër faktorët kryesorë që pengonte kthimin e PZHBV-ve në Kosovë; prandaj kjo ishte një pengesë serioze për zhvillimin e ardhshëm ekonomik.[102]

---

[100] Shih Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut nr. 2008/21, "si Shtesë e Vendimit ekzekutiv nr. 2008/16 duke lënë anash përkohësisht çështjet që kanë të bëjnë me disa parcela të caktuara të tokës në kadastrën e Komunës së Deçanit," 17 maj 2008.

[101] Kai Eide, Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, "Shqyrtimi gjithëpërfshirës i gjendjes në Kosovë," Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, 7 tetor 2005.

[102] Ibid. Paragrafi 49 thotë: "Një numër i madh i pronave bujqësore dhe komerciale vazhdojnë të jenë të zëna në mënyrë të paligjshme. Kjo paraqet një pengesë serioze për kthimin dhe jetesën e qëndrueshme. Ndonëse për shumicën e kërkesave në lidhje me pronat banesore janë marrë vendimet, më pak se gjysma e atyre vendimeve janë

Pasojë një debat brenda bashkësisë ndërkombëtare se si të trajtohet në mënyrën më të mirë kjo sfidë. Në një mendim këshillëdhënës, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut (DiD) u shpreh kundër modifikimit të mandatit të DÇBP-së ose krijimit të një organi të ri ndërkombëtar[103] dhe loboi në favor të bartjes së juridiksionit te gjykatat lokale. DiD argumentojë se DÇBP-ja ka qenë një masë e jashtëzakonshme duke e marrë parasysh vakumin institucional dhe emergjencën humanitare të vitit 1999. Por tani kishte ardhur koha që gjykatat të marrin përgjegjësinë e plotë për rastet e të drejtave pronësore për shkak të nevojës për transparencë dhe proces të drejtë, standardit të ulët të kualifikimit të punonjësve të DÇBP-së, mungesës së mjeteve juridike pas vendimeve të KKBP-së dhe mundësive të kufizuara të DÇBP-së që të kryejë mandatin e vet.[104] Përkundër disa shqetësimeve të vlefshme rreth gjykatave lokale, DiD theksonte se përjashtimi i gjykatave nga ekuacioni dërgonte një mesazh të dobët rreth mundësisë së sistemit gjyqësor që të menaxhojë në mënyrë të drejtë rastet pronësore.[105]

Me 4 mars 2006, bashkësia ndërkombëtare e zëvendësojë DÇBP-në me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), si një agjenci të pavarur vendore të ngarkuar me zgjidhjen e të gjitha kontesteve të pazgjidhura të pronave të patundshme banesore, komerciale dhe bujqësore që kanë të bëjnë me konfliktin.[106]AKP-ja përbëhet nga një sekretariat ekzekutiv përgjegjës për menaxhimin e procesit të kërkesave, një bord mbikëqyrës që i ofron mbikëqyrje administrative dhe udhëzime politike sekretariatit ekzekutiv dhe në fund nga një Komision për Kërkesat Pronësore (KKP), një organ pothuaj gjyqësor që vendos për kërkesat që i referohen sekretariatit ekzekutiv.[107] KKP-ja, përmes Rregullores së punës dhe dëshmive ka një regjim të veçantë (sui generis) "të pajisjes së tij me mjetet e nevojshme për tu marrë me numrin voluminoz të rasteve në mënyrë efikase."[108]

Qeveria e Kosovës, përmes Kryeministrit, emëron dy prej anëtarëve të bordit mbikëqyrës; anëtari tjetër është zyrtar i bashkësisë ndërkombëtare. KKP-ja e ka autoritetin që të marrë vendime për pronat e kërkuara në lidhje me titullin mbi atë pronë, të drejtat e shfrytëzimit të pronës dhe të drejtat e posedimit të ligjit.[109] Për dallim nga sistemi i DÇBP/ KKBP-së, kundër vendimeve të

---

zbatuar. Gjykatat vendore kanë një numër të madh të rasteve të pazgjidhura në lidhje me pronat të cilat sillen deri në dhjetëra mijëra. Kjo gjendje nuk duhet të lejohet të vazhdojë. Qeveria dhe bashkësia ndërkombëtare duhet urgjentisht të trajtojnë ketë çështje dhe të gjejnë mënyra alternative për të zgjidhur rastet e pazgjidhura dhe për të zbatuar vendimet që janë marrë."

[103] Shih memorandumin këshillimor të brendshëm të DD-së, "A duhet ketë ta bëj DÇBP-ja në vend të gjykatave?" UNMIK – Departamenti i Drejtësisë, 2006.

[104] Ibid.

[105] Ibid. Shih në mënyrë të veçantë faqen 1: "Prona është çështja më e rëndësishme për shumicën e serbëve etnikë të cilët janë zhvendosur në Serbi. Një proces i drejtë dhe transparent do të ndihmonte gjykatat në krijimin e besimit të tyre në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe në institucionet e tjera."

[106] Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10, "për zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pasurinë e patundshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e cila është shfuqizuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50", 4 mars 2006.

[107] Shih Knut Rosandhaug, Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës, KPA 2007: Informacion i shkurtër" dhjetor 2007.

[108] Ibid.

[109] OSBE – Misioni në Kosovë, "Tetë vjet pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i shtëpive dhe pronave në Kosovë", Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, qershor 2007.

KKP-së mund të bëhet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, që është, një panel special prej tre gjyqtarësh (dy ndërkombëtarë dhe një vendor).[110] Çka është më me rëndësi, vendimet e KKP-së përbëjnë vendime për titullin dhe duhet tu mundësojnë njerëzve të cilët bëjnë kërkesat me sukses që të regjistrojnë pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit në Regjistrin e të drejtave në pasurinë e patundshme në Kosovë.[111]

AKP-ja mori përgjegjësitë e DÇBP/KKBP-së në administrimin e pronave banesore, veçanërisht pronave që konsiderohen të braktisura.[112] Sipas AKP-së, që nga prilli 2008 rreth 4,457 prona nën administrimin e saj dhe 3,848 prej tyre ishin dhënë me qira në emër të PZHBV-ve.[113] AKP-së iu deshtë po ashtu që të përfundojë 721 raste të KKBP-së që prisnin të zbatoheshin në bazë të kërkesave nga parashtruesit e suksesshëm të kërkesave për posedimin e serishëm të pronave të tyre.[114]

AKP-ja ka filluar punën në rrethana të vështira. Deri më 27 korrik 2007, ajo kishte mbledhur rreth 40,000 kërkesa dhe kishte marrë vendime për 11,168 kërkesa.[115] Megjithatë, për asnjërën nga këto 11,168 kërkesa në fakt nuk është marrë ndonjë veprim për shkak se ende nuk është krijuar paneli i Gjykatës Supreme i caktuar të dëgjojë ankesat.[116]

AKP-ja po ashtu kishte probleme buxhetore që pengonin aftësinë e saj për të kryer punën. Fondet e UNMIK-ut dhe të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (që janë deri 32 për qind e nevojave buxhetore të AKP-së) nuk ishin të mjaftueshme për të mbuluar operacionet dhe AKP-ja u përpoq të sigurojë fonde nga donatorët. Kjo mungesë e fondeve ndikojë seriozisht aftësinë e AKP-së që të mbajë punonjësit e kualifikuar. Mungesa e fondeve po ashtu nënkuptonte se kufizohej edhe mundësia e AKP-së që të kryejë dëbimet dhe aktivitetet e komunikimet me PZHBV-të. Kështu që në disa raste, AKP-ja nuk ishte në gjendje që tua dërgojë palëve asnjë nga vendimet që kishin marrë në lidhje me kërkesën.[117]

Problemet financiare dhe vështirësitë e tjera e kanë dëmtuar mundësinë e përgjithshme të AKP-së që të ushtrojë mandatin e saj dhe e vonuan procesin e marrjes së vendimit. Vonesat pastaj bënë që shumë njerëz që kishin kërkesa – kryesisht PZHBV-të – të humbin besimin në proces dhe të gjitha shpresat se për rastet e tyre do të ketë drejtësi.

[110] Ibid.
[111] Ibid.
[112] Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, Neni 1. E braktisur është "çdo pronë, të cilën pronari ose poseduesi i ligjshëm dhe anëtarët e familjes së tij/ saj, përgjithmonë ose përkohësisht, për arsye të tjera e jo mungesës së rastit, kanë pushuar së shfrytëzuari dhe e cila ose është e zbrazët ose e zënë në mënyrë të paligjshme."
[113] Shih Knut Rosandhaug, Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës KPA 2007: shkurtimisht" dhjetor 2007.
[114] Ibid.
[115] Ibid.
[116] OSBE – Misioni në Kosovë, "Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë", Raport për gjendjen e përgjithshme, 2008.
[117] Ibid.

AKP-ja po ashtu është ballafaquar edhe me sfida të tjera institucionale. Agjencia Kadastrale e Kosovës refuzon që t'i garantojë AKP-së qasje në të dhënat e hartave të tyre, të cilat do të përshpejtonin në masë të madhe procesin e verifikimit të kërkesave individuale.[118] Në gusht të vitit 2007, PSSP-ja pezullojë aktivitetet e zbatimit për shkak të mungesës së mbështetjes së Qeverisë së Kosovës për procesin e zbatimit.

Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin me të cilën u bartën autorizimet dhe përgjegjësitë e UNMIK-ut në lidhje me AKP-në tek Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar i Bashkimit Evropian (ICR).[119] Duke marrë parasysh politikën e deklaruar të qeverisë së Serbisë për mosnjohjen e ligjshmërisë së mandatit të ICR-së, ligji i ri ngriti shqetësime serioze për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet autoriteteve serbe dhe AKP-së. Qeveria e Serbisë ka deklaruar se është pezulluar puna në zyrat e AKP-së në Serbi, duke theksuar se agjencia nuk është marrë në mënyrë efikase me çështjen e mbrojtjes së të drejtës pronësore të serbëve, pronat e të cilëve janë të zëna në mënyrë të paligjshme në Kosovë.[120] Kjo e pamundësojë pothuajse plotësisht që AKP-ja të verifikojë dokumentet në Serbi, të kontaktojë me parashtruesit e kërkesave për informata të tjera, tua komunikojë palëve rezultatet e procesit të vendimit për kërkesën ose të marrin dëshmi konfirmuese. Përkundër pezullimit të punës së zyrave të AKP-së në Serbi, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 mbeti në fuqi dhe një drejtor ekzekutiv i AKP-së i emëruar nga UNMIK-u dhe një ekip menaxhues bashkekzistonin me ata të emëruar nga ICR-ja.

Më 23 dhjetor 2008, skadoi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50, duke përfunduar kështu përfshirjen e UNMIK-ut në AKP. Para kësaj, qeveria e Serbisë ishte duke negociuar me UNMIK-un për vazhdimin e kësaj rregulloreje si parakusht për rihapjen e zyrave të AKP-së. Negociatat u zhvilluan në kuadër të kornizës se Planit gjashtë pikësh të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për Kosovën të paraqitur në Këshillin e Sigurimit më 24 nëntor 2008.[121] Në kohën e shkrimit të këtij raporti, OKB-ja dhe Qeveria e Serbisë ishin duke negociuar çështjen e pronave në përpjekje për të gjetur mënyra për të anashkaluar pengesat që ekzistojnë, veçanërisht praninë e strukturës së Zyrës Civile Ndërkombëtare në AKP, të cilën as Serbia dhe as UNMIK-u nuk e njohin zyrtarisht. Një numër i organizatave të rëndësishme, sidomos Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e mbështesin vazhdimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e cila përveç konsideratave praktike të rihapjes së zyrave të AKP-së në Serbi, përmban edhe mekanizma ligjor që janë më të përshtatshëm për trajtimin e të drejtave pronësore individuale se sa legjislacioni i Kosovës i miratuar në qershor të vitit 2008.[122] Ekzistojnë disa shqetësime serioze se legjislacioni i Kosovës nuk e trajton në mënyrë adekuate

[118] Ibid.
[119] Ligji nr. 03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 "për zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pasurinë e patundshme private, përfshirë edhe pronën bujqësore dhe komerciale", 13 qershor 2008.
[120] OSBE – Misioni në Kosovë, "Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë", Raport për gjendjen e përgjithshme, 2008.
[121] Shih "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë," 24 nëntor 2008, 4.
[122] Intervistë me një zyrtar të lartë të OSBE-së, 26 janar 2009.

çështjen e dëbimit të shfrytëzuesve të paligjshëm dhe skemave të qiradhënies, e as nuk përmban gjuhë të qartë dhe të detyrueshme për të zbatuar ketë të fundit.[123]

Për momentin AKP-ja vazhdon të gjykojë rastet, veçanërisht në lidhje me 30,000 nga 41,000 rastet në të cilat nuk ekziston asnjë kërkesë tjetër kontestuese. Megjithatë zbatimi vazhdon të jetë relativisht i dobët. Të gjithë vëzhguesit pajtohen se mbyllja e zyrave të AKP-së në Serbi e ka ngadalësuar punën e agjencisë dhe tani të zhvendosurit që janë parashtrues të kërkesave, ballafaqohen me pengesa serioze në përmbushjen e të drejtës për proces të duhur.[124]

D. POLICIA

Siç u tha më lartë, policia luan një rol të rëndësishëm institucional në çështjen e të drejtave pronësore; DÇBP-ja dhe AKP-ja janë bazuar në ndihmën e policisë në kryerjen e dëbimeve dhe në parandalimin e zënies së mëtejshme dhe të paligjshme të pronave. Roli i tyre është shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe zbatimin e ligjit për të drejtat pronësore. Veprimet e policisë në këtë aspekt kanë qenë të përziera dhe e pasqyrojnë brishtësinë e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë.

Pas largimit të policisë serbe në qershor 1999, më nuk kishte polici në Kosovë. UNMIK-u menjëherë fillojë rekrutimin e policëve nga vendet e ndryshme për të themeluar një prani ndërkombëtare të policisë, "Policinë e UNMIK-ut". Rekrutimi, vendosja dhe strukturimi i policisë së UNMIK-ut u bë prej vitit 1999 deri më 2001. Policia e UNMIK-ut ishte e udhëhequr nga komisari ndërkombëtar i policisë dhe nga Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (Z/PSSP) për polici dhe drejtësi (e ashtuquajtura Shtylla I e UNMIK-ut që nga viti 2001). Ata kishin autoritetin e plotë dhe ekskluziv sipas Rezolutës 1244 të KSKB-së për të kryer të gjitha çështjet që kishin të bënin me policinë. Në të njëjtë kohë, UNMIK-u me shpejtësi përgatiti planet për rekrutimin, trajnimin dhe themelimin e Forcës vendore të Policisë së Kosovës (SHPK),[125] projekt që thjeshtë fillojë nga zeroja.

Shumica e shkatërrimeve dhe uzurpimeve të pronës ndodhën gjatë kësaj kohe. Policia e UNMIK-ut shpesh ishte e hutuar dhe e papërgatitur të merret me këtë problem. Ekzistonte edhe një konfuzion rreth ligjit të aplikueshëm për çështjet e uzurpimit dhe dëbimit. Policët e UNMIK-ut vinin nga vende të ndryshme dhe kishin nivel të ndryshëm të kompetencës dhe qasje të ndryshme ndaj punës policore. Kjo mungesë e unitetit të këtij institucioni ndikojë në aftësinë e kësaj force që të trajtojë sfidat në mënyrë koherente dhe të unifikuar. Për më tepër, kjo forcë vuante edhe nga ndërrimet e shpejta të policëve dhe komandantëve, sepse këta të fundit shërbenin këtu në baza të rregullta rotative nga kontingjentet e tyre kombëtare. Kjo nënkuptonte se kishte shumë pak kontinuitet në polici dhe në udhëheqjen e saj. Policët e ri humbnin kohën e çmuar duke u

[123] Ibid.
[124] Ibid.
[125] Pas shpalljes nga Kuvendi i Kosovës të Ligjit për Policinë, Nr. 03/L-035, më 15 qershor 2008**,** emri i kësaj force zyrtarisht u caktua të jetë "Policia e Kosovës (PK)". Megjithatë për hir të konsistencës në gjithë ketë tekst është përdorur shkurtesa SHPK.

njohur me detyrat dhe realitetin në Kosovë. Hetimet që zhvilloheshin shpesh merrnin fund kur një polic që kryente ato hetime largohej nga misioni.

Në këtë kontekst të hershëm, policët e UNMIK-ut vepruan në mënyrë *ad hoc* dhe të improvizuar kur merreshin me çështjet pronësore. Disa policë kishin një qasje më aktive dhe dëbuan shfrytëzuesit e paligjshëm me iniciativën e vet, duke bërë hetime dhe duke i larguar fizikisht njerëzit. Policët e tjerë refuzuan të përziheshin në çështjet pronësore dhe i drejtonin njerëzit në gjykatat lokale. Kur DÇBP-ja u bë plotësisht operacionale, disa policë të UNMIK-ut nuk u morën më fare më çështjet pronësore dhe ja lanë këtë punë në tërësi kësaj drejtorie.

Roli i policisë së UNMIK-ut në zbatimin e ligjit ishte i kufizuar në pengimin e hyrjeve në pronë dhe zënies së paligjshme, dhe eventualisht ndihmonte DÇBP-në rreth dëbimeve. Megjithatë, përmasa e problemit të zënies së paligjshme e kombinuar me disa të meta të policisë së UNMIK-ut të përshkruara më lartë, bëri që Policia e UNMIK-ut të mos jetë efektive në parandalimin e uzurpimit të pronave.

UNMIK-u e përcaktojë si prioritet krijimin e SHPK-së dhe në bashkëpunim më Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), UNMIK-u krijoj një program që u fokusua në rekrutimin e ish luftëtarëve të UÇK-së në SHPK. Policët në fazën e hershme rekrutoheshin kuturu, pasi që qëllimi kryesor ishte që të krijohej SHPK-ja sa më shpejt që të jetë e mundur. Trajnimi u zhvillua në Shkollën e Policisë së Kosovës në Vushtrri të cilën e themeloi Misioni i OSBE-së në vendin ku ka qenë përpara akademia policore. Trajnimi ishte shumë bazik, duke përfshirë një kurs gjashtë javor dhe trajnimin e më pastajmë me një mentor të policisë së UNMIK-ut. UNMIK-u bëri përpjekje të rekrutojë sa më shumë joshqiptarë që ishte e mundur. Policët e SHPK-së vepruan nën autoritetin e policisë së UNMIK-ut deri në vitin 2005 kur disa stacione dhe rajone të caktuara policore filluan t'i barteshin tërësisht SHPK-së.

SHPK-ja shpesh paraqitej si një nga historitë e rralla të suksesit të misionit ndërkombëtar në Kosovë. Në disa aspekte, kjo është e vërtetë. UNMIK-u dhe OSBE-ja krijuan një shërbim të ri policor dhe ofruan trajnim dhe politika duke u bazuar në standardet më moderne dhe më demokratike të policisë në rrethana shumë të vështira. Deri në shpalljen e njëanshme të pavarësisë kohëve të fundit, SHPK-ja ishte njëri ndër institucionet më shumetnike në Kosovë.[126] Megjithatë ende ekzistojnë disa sfida të caktuara strukturore që e kufizojnë aftësinë e SHPK-së që të jetë një forcë policore plotësisht funksionale dhe efektive, dhe këto ndikojnë edhe në qasjen që ka SHPK-ja në fushën e mbrojtjes së të drejtave pronësore.

Si institucion, SHPK-ja nuk ka qenë imune nga opinionet dhe pikëpamjet që mbizotërojnë në shoqërinë në të cilën ajo vepron; në fakt, nganjëherë ajo edhe i pasqyron ato. Fakti që shumë policë shqiptarë të SHPK-së janë ish guerilë të UÇK-së e forcon praninë e ideologjisë

[126] Pas deklarimit të njëanshëm të pavarësisë më 18 shkurt 2008, shumica e policëve serbë të SHPK-së, në shenjë proteste ndaj deklaratës dhe në përputhje me politikën e qeverisë së tyre, u tërhoqën nga SHPK-ja. SHPK-ja i pezullojë ata me pagesë, gjë që i ka acaruar edhe më shumë tensionet. UNMIK-u është duke ndërmjetësuar negociatat për kthimin e këtyre policëve serbë në SHPK.

nacionaliste të UÇK-së dhe opinionit negativ për pakicat që e kanë shumë veta brenda kësaj force. Rrjetet e UÇK-së vazhdojnë të ekzistojnë paralelisht me institucionet zyrtare dhe këto rrjete ndikojnë në qëndrimet dhe lojalitetin e ish pjesëtarëve, duke përfshirë edhe ata që janë në SHPK. Policia e UNMIK-ut shpesh bëjnë shaka për realitetin e zinxhirit komandues të policisë duke e krahasuar atë më zinxhirin ushqimor në shoqërinë kosovare, duke ju referuar qendrave të fuqisë dhe pasurisë të cilat askush në Kosovë nuk duhet t'i injorojë. Realiteti i burimeve paralele të fuqisë që janë të lidhura ose me lojalitetin ndaj klanit ose ndaj ish rrjeteve të UÇK-së, i vështirëson gjërat edhe më shumë për policët e SHPK-së që duan të kryejnë detyrat e tyre si duhet në qytete dhe komunitete të vogla. Në ketë të fundit nuk ka anonimitet, çdokush e njeh çdokënd dhe lidhjet familjare janë shumë të fuqishme, duke bërë që disa policë të SHPK-së t'i ikin çfarëdo aktiviteti që do të mund t'i vinte ata ndesh me pjesëtarë të caktuar dhe të fuqishëm të komunitetit ose që do të rrezikonte ata dhe anëtarët e familjeve së tyre.

Kjo forcë po ashtu nuk ka kuadro të kualifikuara dhe kjo shpesh nënkupton udhëheqje të dobët dhe mungesë e iniciativës dhe qasjes aktive ndaj punës së policisë. Këto vështirësi strukturore ishin më së evidente gjatë trazirave të marsit 2004. Me përjashtim të disa policëve që treguan guxim të madh dhe dedikim, SHPK-ja, bashkë me policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in dështuan që të mbronin njerëzit dhe pronat e tyre. Që prej atëherë, pakicat nuk mendojnë se kjo forcë është e besueshme ose kredibile.[127] Për dallim nga kjo, shumica e shqiptarëve në Kosovë kanë mendime relativisht pozitive për forcën e policisë të cilën ata e shohin si të tyre.

Në çështjet e të drejtave pronësore, SHPK-ja nënshkroi një memorandum të mirëkuptimit me AKP-në ku përcaktohej protokolli i bashkëpunimit për dëbimin e shfrytëzuesve të paligjshëm të pronave. SHPK-ja hartoj Procedurat Standarde të Operacionit (PSO) – një dokument i brendshëm që udhëzonte policët se si duhet të silleshin gjatë dëbimeve) duke u bazuar në MiM.[128] Në përgjithësi, SHPK-ja ka bërë punë të kënaqshme në bashkëpunimin me AKP-në gjatë dëbimeve. Kjo ka qenë detyrë e vështirë për disa policë shqiptarë, duke pasur parasysh të menduarit e trashëguar nga konflikti dhe faktin se shumica e shfrytëzuesve të paligjshëm ishin shqiptarë.[129]

Megjithatë SHPK-ja nuk është kujdesur për dëbimet e serishme. Pronat shpesh janë zënë sërish pas dëbimit të parë, duke ua pamundësuar pronarëve të ligjshëm që të marrin pronën e tyre. Në shumë raste, SHPK-ja nuk i ka zbatuar dispozitat e vlefshme të kodit penal kundër atyre që

[127] Një OJQ lokale ka bërë kohëve të fundit një anketim për qëndrimet e serbëve të Kosovës në enklavën e Graçanicës për SHPK-në pas tërheqjes së serbëve nga SHPK-ja. Rezultatet japin një vështrim interesant në perceptimin që kanë disa serbë të Kosovës për policinë në ketë periudhë. Shumica e perceptimit për SHPK-në mbetet negative. Shih Qendra për paqe dhe tolerancë, "Konferenca për sigurinë dhe lirinë e lëvizjes së komunitetit serb në Kosovë dhe Metohi: Ndryshimi i përbërjes etnike në stacionin policor në Graçanicë dhe pasojat e tij," 13 qershor 2008.

[128] "Procedurat Standarde të Operacionit: Uzurpimet, dëbimet dhe uzurpimet e serishme të pronave", Shtabi Qendror i Policisë, Departamenti i Rendit Publik, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, 22 gusht 2006.

[129] Shih Dan Bilefsky, "Derisa Kosova rindërtohet, OKB-ja ngutet të kthejë pronat", *New York Times,* 16 shkurt 2008, për qëndrimet e disa policëve shqiptarë për dëbimet nga pronat.

kishin hyrë në mënyrë të paligjshme në pronën private dhe kishin marrë në mënyrë të paligjshme ato prona, duke mos i akuzuar ata asnjëherë.

Në disa raste policia nuk ndërmerrte kurrfarë veprimi kundër njerëzve të cilët edhe pas dëbimit, ktheheshin në atë pronë dhe ndërronin drynin. SHPK-ja në të kaluarën ka refuzuar të ndërmarrë ndonjë veprim për të siguruar që njerëzit të kenë qasje në pronat e tyre dhe të largojnë shfrytëzuesin e paligjshëm. Në raste të tjera, shfrytëzuesi i paligjshëm kthehej në pronë me gjësendet e tij dhe i linte ato aty. Sërish, kjo bëhej pengesë për pronarët e pakicave që kanë të drejtë të marrin pronën e tyre në posedim sepse shumica prej tyre kishin frikë ose nuk kishin mundësi të heqin ato gjësende. DD-ja ka hartuar udhëzimet operacionale për policinë dhe prokurorët, duke u siguruar atyre udhëzime për aplikimin e dispozitave të ndryshme të kodit penal për skenarë të caktuar për zënien e paligjshme të pronës dhe për pacenueshmërinë e banesave dhe ato ia ka dërguar kryeprokurorit publik të Kosovës Hilmi Zhitisë, më 27 prill 2006.[130] Ai ia ka shpërndarë këto rekomandime policisë dhe prokurorëve, por problemet qëndronin me ata që zinin sërish pronën dhe me atmosferën e mosndëshkimit të tyre për këto veprime të tyre.[131]

Përkundër ndryshimit në Procedurat Standarde të Operacionit të SHPK-së në lidhje me dëbimet e sërishme dhe një numri të takimeve të brendshme për këtë çështje, problemet vazhdonin në atë se si policia përpiqej të parandalonte uzurpimin. Kjo e detyroi DD-në, me nxitjen nga AKP-ja dhe Zyra e Komisarit të Policisë, që të hartojë një udhëzim administrativ për PSSP-në për sqarimin e roleve të AKP-së dhe SHPK-së kur bëhet largimi i shfrytëzuesve të paligjshëm dhe gjësendeve të tyre nga pronat nga të cilat AKP-jë e kishte bërë njëherë dëbimin. Fatkeqësisht, meqë PSSP-ja kurrë nuk e nënshkroi ketë dokument, problemi i ri-uzurpimeve vazhdojë tu mohojë PZHBV-ve të drejtën për të pasur qasje të lirë dhe të papenguar në pronat e tyre.

E. GJYKATAT VENDORE

Sistemi gjyqësor në çdo shoqëri luan një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Edhe pse themelimi i DÇBP-së dhe AKP-së në njëfarë mënyre i ka margjinalizuar gjykatat vendore të Kosovës në ketë proces, ato ende kanë një juridiksion të rëndësishëm në përcaktimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore. Megjithatë, ekziston një konsensus në mesin e

[130] Shih letrën e Albert Moskovitz, drejtor i Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi dërguar Hilmi Zhitisë, prokuror publik i Kosovës më 27 prill 2006, ku i referohet "Udhëzimeve operacionale për policinë dhe prokurorët për hetimin e rasteve të shfrytëzimit të paligjshëm të pasurisë së patundshme dhe shkeljes së pacenueshmërisë së banesave."

[131] Një rast interesant nga Klina është i bazuar në një interviste me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut më 22 korrik 2008. Vladimir Radosavljevic, 70 vjeçar, dhe gruaja e tij janë serbë të kthyer në Klinë. Një biznesmen lokal i fuqishëm shqiptar, Bujar Morina, e ka marrë pronën e tyre dhe e ka shndërruar në restorant. Radosavljeviqët ishin viktima të një tentimvrasjeje në vitin 2005, për të cilën Policia e UNMIK-ut beson të jetë e lidhur me përpjekjen e tyre për të marrë pronën e vet në posedim. AKP-ja më në fund e dëboi Morinën pas shumë kërcënimeve, por ai shumë shpejt e zuri atë sërish dhe i la gjësendet e veta brenda. Morina në mënyrë të hapur e kërcënoi qiftin duke argumentuar se prona ishte e tij dhe rrjedhimisht ai e ndërroj drynin. Çështja u zvarrit për ca kohë derisa policia më në fund e detyroi Morinën të largohet, por disa gjësende të tij mbetën në objekt, dhe policia kurrë nuk e akuzoi atë. Radosavljeviqet janë futur në një pjesë të shtëpisë, por ende jetojnë me frikë.

shumicës së vëzhguesve ekspertë, prej Raportit të Kai Eides më 2005 e deri te raporti i kohëve të fundit i OSBE-së,[132] se sistemi gjyqësor në Kosovë është një ndër institucionet më të dobëta dhe më të korruptuara në shoqëri. Dobësia e sistemit gjyqësor ka ndikim te të gjitha komunitetet në Kosovë dhe paraqet një kërcënim serioz për stabilitetin e tij në të ardhshëm. Mosbesimi dhe mungesa e besueshmërisë në ketë sistem jo vetëm që dëmton kauzën e drejtësisë por edhe i detyron njerëzit që të zgjidhin kontestet jashtë kornizës së sistemit gjyqësor. Është ndoshta e tepërt të thuhet se mungesa e një sistemi efektiv të gjykatave është pengesë edhe për investimet dhe zhvillimin ekonomik.

Dobësia e sistemit gjyqësor në procedurat civile është veçanërisht evidente në rastet që kanë të bëjnë me kërkesat pronësore. Ka arsye të shumta për këto dobësi, siç janë resurset njerëzore, financiare dhe fizike të gjykatave. Shumë gjyqtarëve dhe avokatëve u mungon trajnimi dhe përvoja adekuate gjë që qon në problemet e jokompetencës dhe aftësive të dobëta për menaxhimin e rasteve. Pagat janë të ulëta dhe kushtet e punës janë të vështira duke krijuar mundësi për korrupsion dhe ndikime nga jashtë. Gjyqtarët dhe avokatët po ashtu i nënshtrohen presioneve dhe frikësimit nga pjesëtarët e klaneve për të treguar "solidarizim" në qasjen e tyre ndaj rasteve të caktuara. Dhe në fund, edhe trashëgimia e të kaluarës qëndron mbi çështjen pronësore në Kosovë. Siç u pa në pjesën e mëhershme, Kosova gjithmonë ka pasur kulturë dhe praktika të brishta në lidhje me transaksionet pronësore, e cila jo gjithmonë i ka respektuar kushtet ligjore.[133] Inercia e këtij realiteti ka depërtuar në sistemin gjyqësor dhe ka ndikuar në qasjen e tij në gjykimin e lëndëve.

Problemet specifike në procedurat civile që merren me transaksionet pronësore janë të shumta. Një prej tyre është numri i madh i rasteve të pazgjidhura në gjykata. Vetëm në vitin 2008, ka pasur 49,100 lëndë civile të pazgjidhura, më shumë se 85 për qind e të cilave kishin të bënin me pronën.[134] Gjyqtarët vazhdimisht janë treguar menaxhues të dobët të lëndëve civile duke shkaktuar kështu vonesa të panevojshme në zgjidhjen e tyre. Vonesat u bënë serioze, në disa raste duke zgjatur me vite të tëra dhe duke shkelur kështu kushtet e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) për afatet e arsyeshme kohore për marrjen e vendimeve gjyqësore. Një raport i OSBE-së për sistemin e drejtësisë civile ka paraqitur hollësisht një seri të praktikave problematike në gjykata: shqyrtimi i dobët preliminar i deklarimeve në kërkesë, mosdërgimi i atyre kërkesave palës kundërshtare para mbajtjes së gjykimit, mos parashtrimi i dëshmive para seancës dëgjimore kryesore, problemet në dërgimin e

[132] OSBE – Misioni në Kosovë, "Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë", 2008. Shih po ashtu edhe Kai Eide, "Shqyrtimi gjithëpërfshirës i gjendjes në Kosovë," Këshilli i Sigurimit i OKB-së, 7 tetor 2005, 3: "Sistemi i drejtësisë civile është një brengë e veçantë, numri gjithnjë në rritje i rasteve të pazgjidhura tash ka arritur në disa dhjetëra mijëra. Luftimi i krimeve të rënda, përfshirë edhe krimin e organizuar dhe korrupsionin, është dëshmuar të jetë i vështirë për SHPK-në dhe sistemin e drejtësisë. Ai pengohet nga solidariteti familjar dhe klanor dhe nga frikësimi i dëshmitarëve dhe i zyrtarëve për zbatimin ligjit dhe atyre të drejtësisë".
[133] OSBE – Misioni në Kosovë, "Kosovë: Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006, 30.
[134] Shih Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti i tremujorit të tretë, 2008.

ftesave për gjykatë, dështimi në përcaktimin e afateve kohore, mungesa e dispozitave që rregullojnë çështjen e shtyrjeve dhe numri i madh i seancave dëgjimore dhe i shtyrjeve.[135]

Ligji i aplikueshëm përcakton një kornizë të qartë ligjore e cila rregullon kushtet e transaksioneve pronësore. Ligji thekson se, "[një] kontratë me të cilën bartet e drejta e shfrytëzimit të pasurisë së patundshme ose pronësia duhet të bëhet në formë të shkruar dhe nënshkrimet e kontraktuesve duhet të verifikohen në gjykatë."[136] Kur një palë në transaksionin pronësor nuk është nënshkruese e kontratës, pala nënshkruese duhet të posedojë autorizimin me shkrim të vërtetuar nga gjykata për të përfaqësuar palën në nënshkrimin dhe vërtetimin e kontratës. Kur shitësi i një prone përfaqësohet nga një person i tretë, shitësi duhet t'ia paraqes gjykatës një dëshmi të vërtetuar se personi i tretë është ligjërisht i autorizuar që të përfaqësojë atë.[137] Kur të ketë mbaruar kjo procedurë, gjykata duhet të dërgojë kontratën në zyrën e kadastrës për ta regjistruar.

Përkundër këtyre procedurave të hollësishme për mbrojtjen e integritetit dhe autenticitetit të transaksioneve pronësore, gjykatat në Kosovë në shumë raste nuk i kanë respektuar rregullat.[138] Kjo ka ndodhur veçanërisht në rastet e kërkesave që kishin të bënin me pronën e serbëve të zhvendosur dhe pakicave të tjera, në të cilat njerëzit përpiqeshin të bënin të vlefshme një shitje të rrejshme duke përdorur letërnjoftime të falsifikuara (në disa raste edhe të personave të vdekur) ose tituj të rrejshëm pronësor. Në të vërtetë, gjykatat shpesh kanë hasur në raste në të cilat njerëzit në Kosovë kanë përdorur letërnjoftime të falsifikuara për të marrë autorizime në Serbi dhe Mal të Zi që të mund të shesin pronën e serbëve të Kosovës të zhvendosur në Serbi.[139] Për të autorizuar shitjen e pronave të PZHBV-ve, disa njerëz kanë marrë autorizime të rrejshme për përfaqësim të regjistruara dhe të bëra të vlefshme (vërtetuara) në një gjykatë në Mal të Zi. Qytete të caktuara malazeze si Bari dhe Rozhaja kanë qenë qendra për të gjitha llojet e transaksioneve të korruptuara ku përfshiheshin shqiptarët dhe serbët.[140] Në të vërtetë, shitja e pronave të pakicave nuk përfshinë vetëm shqiptarët e Kosovës por edhe serbët që veprojnë si ndërmjetësues të rrejshëm.[141] Në raste të tjera, janë përdorur dokumente të rrejshme kadastrale për të dëshmuar titullin dhe gjykatat rregullisht e kanë pranuar vlefshmërinë e tyre. Në shumë raste ato pranojnë

[135] OSBE – Misioni në Kosovë, "Kosovë: Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006. Kapitulli 1.
[136] Neni 4(2) i Ligjit për bartjen e pasurisë së patundshme (LBPP), i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, Nr. 43/81, më 1 gusht 1981.
[137] Neni 9 i Ligjit për miratimin e nënshkrimeve dhe duplikateve."
[138] OSBE – Misioni në Kosovë, "Kosovë: Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006, 21.
[139] Ibid., 22.
[140] Shih Krenar Gashi, "Ish policët udhëheqin mashtrimin me pasaporta në Kosovë", Lajmet e B92, 7 dhjetor 2006. Gjykata në Bar përdoret për të vërtetuar autorizimet e falsifikuara të cilat pastaj përdoren për të vërtetuar transaksionet e blerjes së pronave në Kosovë, të cilat shpesh u përkasin PZHBV-ve serbë. Mali i Zi është po ashtu një vend ku serbët dhe shqiptarët e Kosovës mund të blinin të gjitha llojet e dokumenteve zyrtare, duke përfshirë edhe certifikatat jugosllave të lindjes, kartelat shëndetësore dhe pasaportat.
[141] Dëshmi të arrestimit të kohëve të fundit në Serbi të një grupi të organizuar që i shiste në mënyrë të paligjshme pronat e serbëve në Kosovë. Shih "Grupi dhjetë anëtarësh u arrestua për shitjen e paligjshme të pronave serbe në Kosovë", *Tanjug,* 26 shtator 2008.

të bëjnë të vlefshme edhe dokumentet e dyshimta dhe nuk respektojnë procedurat e duhura për verifikimin e autenticitetit të dokumenteve në organin që e ka lëshuar atë dokument.[142]

Gjykatat kanë problemet më të mëdha me kërkesat e parashtruara kundër njerëzve që nuk janë më në Kosovë, zakonisht pjesëtarë të pakicave të zhvendosura. Gjykatat shpesh nuk kanë mundësi të gjejnë palën e zhvendosur që është e pandehur dhe pas një varg shtyrjesh ata e caktojnë një përfaqësues të përkohshëm për të mbrojtur interesat e tij/ të saj. OSBE ka vërejtur një model të përhapur të rasteve në Kosovë në të cilat gjykatat dështojnë që tu përmbahen rregullave të procedurës në emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm.[143] Gjykatat shpesh nuk bëjnë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të pandehurin.[144] Ata nuk ia dalin të demonstrojnë se vendimi për emërimin e një përfaqësuesi të përkohshëm është i nevojshëm sipas ligjit ose dështojnë të shpallin publikisht emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në mënyrë të duhur.[145] Pasi që shumica e PZHBV-ve janë në Serbi, shpalljet duhet të bëhen në gazetat e Serbisë, por kjo nuk bëhet gjithmonë.

Një aspekt edhe më shqetësues i këtij problemi është se përfaqësuesit e përkohshëm janë shqiptarë të cilët nganjëherë paguhen nga parashtruesi i kërkesës. Këta përfaqësues shpesh janë shumë pasivë në seancat dëgjimore ose edhe e mbështesin parashtruesin e kërkesës dhe nuk e bëjnë punën e tyre për të treguar kujdesin e duhur në përfaqësimin e interesave të të pandehurit).[146] Ky fenomen ngrit shqetësimin e vazhdueshëm për anshmërinë dhe marrëveshjet e fshehta në sistem.

Një fenomen tjetër i ngjashëm ka të bëj më vendimet gjyqësore për të bërë të vlefshme transaksionet pronësore pa ndonjë dokument të shkruar zyrtar, siç e parasheh ligji. Trashëgimia nga e kaluara sigurisht se përvijohet në rastet në të cilat njerëzit i bazojnë kërkesat e tyre në kontrata verbale ose në kontrata të shkruara jozyrtare të cilat nuk janë vërtetuar kurrë në gjykatë dhe as nuk janë regjistruar në kadastër. Gjykatat në Kosovë, shpesh në mungesë të të pandehurit që është i zhvendosur (zakonisht serb i Kosovës i përfaqësuar nga një përfaqësues i përkohshëm), i miratojnë kërkesat pronësore vetëm në bazë të dëshmisë që bën një dëshmitar në të mirë të parashtruesit të kërkesës, pa dëshmi të shkruara për të vërtetuar pohimet, siç parasheh ligji. Gjykatat kanë vendosur se kontratat gojore dhe/ose kontratat jozyrtare janë të vlefshme nëse dëshmitarët mund të konfirmojnë se është bërë ajo marrëveshje dhe se palët i kanë përmbushur obligimet e tyre.[147] Duke u mbështetur vetëm në këto dëshmi dhe duke njohur

[142] Ibid., 24.
[143] OSBE – Misioni në Kosovë, "Kosovë: Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006, 29.
[144] Shih nenin 148 të Ligjit për procedurën kontestimore".
[145] Shih nenet 84 dhe 86 të Ligjit për procedurën kontestimore".
[146] OSBE – Misioni në Kosovë, "Kosovë: Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, qershor 2006.
[147] Ibid., 32.

kontratat gojore si mënyrë të vlefshme për transferin e pronës, disa gjykata në Kosovë kanë shkelur ligjin dhe mund të kenë kontribuar në shpronësimin e pronave të njerëzve.[148]

Një problem tjetër serioz që ngatërron gjykatat civile në Kosovë buron nga ndikimi i tepruar që kanë faktorët e jashtëm në vendime. Në uzurpimin e pronave shpesh janë të përfshirë njerëz të fuqishëm, dhe ata përpiqen që nëpërmes sistemit gjyqësor të legjitimojnë pronat e marra në mënyrë të paligjshme. Në disa raste janë shënuar kërcënime dhe frikësime të gjyqtarëve. Në një numër rastesh, komunat janë përzier në procedurat gjyqësore, qoftë duke penguar ato ose duke bërë presion mbi gjyqtarët që mbikëqyrin kontestet në të cilat ato ishin palë.[149] Komunat e kanë shfrytëzuar autoritetin e tyre që të ndikojnë në palët e treta sikurse janë inspektorët komunalë, për të penguar gjykatat në ushtrimin e autoritetit të tyre. Mbahen dëshmitë ose pamundësohet inspektimi i lokacioneve në komunë. Disa zyrtarë të caktuar komunalë kanë interes personal në rezultatin e rasteve pronësore dhe janë të njohur për përzierje të drejtpërdrejtë në punën e gjykatave.[150] Realiteti i sistemit nuk kalon pa u vërejtur nga qytetarët. Kështu që perceptimi se sistemi gjyqësor është i korruptuar ushqen një frustrim gjithnjë e më të madh kur përmes gjykatave kërkohet drejtësi dhe korrigjim i padrejtësive.[151]

Numri gjithnjë në rritje i rasteve të pazgjidhura në sistemin e gjykatave civile është drejtpërdrejtë i lidhur me historinë e dobësisë institucionale, ndikimin e kulturës lokale dhe praktikat e trashëguara nga e kaluara e fundit. Rrëmuja e viteve 90-ta vazhdon të ndikojë në sistem për shkak se shumë raste pronësore të filluara gjatë atij dhjetëvjeçari tani po trajtohen në një kontekst gjyqësor krejt ndryshe. Shumë nga këto prona janë shkatërruar gjatë konfliktit, dhe dokumentet dhe shënimet siç janë regjistrat civilë dhe shënimet kadastrale ose janë larguar ose mungojnë. Në disa raste, ka vdekur njëra nga palët dhe në të tjerat njëra nga palët është zhvendosur. Të gjithë këta faktorë kombinohen me historinë e gjatë të procedurave dhe disa nga dëshmitë e vjetra ua bëjnë të vështirë gjykatave që të merren me kontestet e vjetra pronësore në kontekstin e tanishëm.[152] Rastet e pazgjidhura pronësore në sistemin e gjykatave civile janë bërë edhe më akute për shkak të ekzistimit, që nga muaji dhjetor 2006, të 18,132 kërkesave për kompensimin e dëmeve në pronat private (gjatë dhe pas vitit 1999) të cilat i kanë parashtruar serbët e Kosovës kundër komunave të Kosovës, UNMIK-ut dhe KFOR-it.[153] Përveç kësaj, shqiptarët kanë parashtruar mbi 2,939 kërkesa për kompensimin e dëmeve të pronave gjatë konfliktit kundër serbëve të caktuar dhe kundër Republikës së Serbisë.[154]

---

[148] Ibid., 32.
[149] Ibid., 38.
[150] Ibid., 38.
[151] Sipas raportit të USAID rreth korrupsionit në Kosovë të përgatitur në korrik 2003, avokatët janë grupi i tretë më i korruptuar i profesionistëve në Kosovë, të pasuar menjëherë nga gjyqtarët. Përfundimi bazohej në pyetësorin në të cilin njerëzit ishin pyetur se cilët profesionistë u kanë kërkuar atyre jozyrtarisht para, dhurata ose favore për tua zgjidhur problemet.
[152] Ibid., 33.
[153] OSBE – Misioni në Kosovë, "Tetë vjet pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i pronës dhe banesave në Kosovë", Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, qershor 2007, 32.
[154] Ibid., 33.

Në gusht 2004, DD i UNMIK-ut pezulloi shqyrtimin e kërkesave serbe, duke udhëzuar të gjithë kryetarët e gjykatave të Kosovës të mos i procedojnë rastet deri sa të gjendet një zgjedhje adekuate. DD-ja u frikësua se numri i këtyre kërkesave do të vërshojë sistemin, i cili edhe ashtu kishte shumë raste të pazgjidhura. Kërkesat e shqiptarëve të Kosovës, edhe pse nuk ishin subjekt i udhëzimit të DD-së u pezulluan, duke pasur parasysh paaftësinë e gjykatave të merren me kërkesat për kompensim kundër serbëve të Kosovës që janë zhvendosur dhe të cilët nuk dihet se ku janë, si dhe mungesën e juridiksionit të gjykatave të Kosovës për të gjykuar rastet kundër Serbisë.[155] Edhe pse DD-ja dhe Ministria e Drejtësisë në Kosovë hartuan një strategji të përgjithshme, në bashkëpunim me OSBE-në dhe Ekipin Planifikues të Bashkimit Evropian për Kosovën (EUPT) për trajtimin e rasteve të pazgjidhura, është bërë shumë pak dhe është arritur pak progres në zvogëlimin e numrit të rasteve të pazgjidhura.[156] Mungesa e vazhdueshme e zgjidhjes së rasteve të pazgjidhura pronësore, veçanërisht në trajtimin e kërkesave për kompensim minon të drejtën për gjykim të drejtë siç përshkruhet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Para së gjithash, ajo shkel të drejtën e personave të zhvendosur që të rimarrin ndonjë banesë ose pronë nga e cila ata janë privuar në mënyrë arbitrare, ose të kompensohen për humbjen e tyre nëse ajo humbje është e pakthyeshme.[157]

F. AGJENCIA KOSOVARE E MIRËBESIMIT DHE PRIVATIZIMIT

Asnjë hulumtim për masat që kanë marrë institucionet lokale dhe ndërkombëtare në Kosovë për të zgjidhur çështjet e të drejtave pronësore nuk do ishte i plotë pa e prekur çështjen e privatizimit. Privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe NSH-ve është proces i ndërlikuar dhe i ngarkuar politikisht në Kosovë. Ai ndikon në një numër të madh të njerëzve në të gjitha komunitetet dhe ngrit çështje thelbësore për padrejtësitë e të kaluarës dhe të tashmes që kanë të bëjnë me valët e nacionalizimeve, shpronësimeve dhe uzurpimeve të pronës. Përveç ndikimit potencial afatgjatë në zhvillimin ekonomik, mënyra si është zhvilluar privatizimi në Kosovë ka dëshmuar të jetë kundërthënëse. Kjo ngrit shqetësime rreth abuzimit të pushtetit nga agjencitë e përfshira dhe legjislacioni problematik i cili mund të shpie në diskriminimin.[158]

Bashkësia ndërkombëtare, me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 (më vonë e ndryshuar me Rregulloren 2005/18), themeloi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit si organ përgjegjës për ri-shpërndarjen e pasurisë së NSH-ve individëve ose ndërmarrjeve.[159] Këto rregullore bashkë me legjislacionin tjetër përkatës, i japin AKM-së autoritet shumë të gjerë për të administruar ndërmarrjet publike dhe NSH-të e regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988, dhe pronën

[155] Ibid., 32.
[156] Shih DD, Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian për Kosovën (EUPT), IPVQ, OSBE, "Strategjia dhe plani i veprimit për zvogëlimin e rasteve të pazgjidhura pronësore," 16 mars 2007.
[157] Ibid., 32.
[158] OSBE – Misioni në Kosovë, "Privatizimi në Kosovë: Rishqyrtimi gjyqësor i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës," Departamenti i Monitorimit/Divizioni i Sundimit të Ligjit, maj 2008.
[159] Ibid., 8.

shoqërore që gjendet në Kosovë të regjistruar që nga 22 marsi 1989.[160] Shkurt, qëllimi parësor i AKM-së ka qenë të bëj privatizimin e pasurisë publike dhe shoqërore.

NSH-të ishin të bazuara në një koncept unik të pronësisë shoqërore të paraqitur për herë të parë në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974. Në esencë ky koncept diktonte se prona nuk është në pronësi të individëve por është trashëgimi e përbashkët e tërë shoqërisë. Kështu që ky koncept mund të përmblidhet me thënien se prona është në pronësi "të askujt dhe çdokujt."[161] Të drejtat pronësore i janë dhënë shoqërisë, ndërsa individët dhe subjektet juridike posedojnë vetëm të drejtat e shfrytëzimit. Ky koncept u bart te ndërmarrjet në të cilat punëtorët, drejtuesit dhe shoqëria si tërësi teorikisht përfitonin nga të drejtat e shfrytëzimit por nuk ishin pronarë të ndërmarrjes në fjalë.

Në vitin 2002, bashkësia ndërkombëtare themelojë Odën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.[162] Kjo përbëhej nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë, njëri prej të cilëve ishte kryesues i dhomës dhe dy gjyqtarë vendorë; që të tre emëroheshin nga PSSP-ja në konsultim me kryetarin Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.[163]. Oda e Posaçme ka juridiksionin kryesor që të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve apo veprimeve të AKM-së, të shqyrtojë kërkesat kundër AKM-së për humbjet financiare të shkaktuara për shkak të vendimeve të ndërmarra nga AKM-ja si administratore e një NSH-je, të shqyrtojë kërkesat kundër NSH-ve kur këto të fundit janë nën administrimin e AKM-së, dhe në fund të shqyrtojë të gjitha kërkesat e tjera të paraqitura hollësisht në nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13. Dhoma po ashtu mund të heq nga gjykatat kërkesat që janë nën juridiksionin e saj, të marrë vendime për ankesat rreth listave të punëtorëve të NSH-ve në procesin e privatizimit dhe të shqyrtojë rastet e ankesave për vendimet e marra në gjykatat e rregullta për çështjet që janë nën juridiksionin e kësaj dhome.[164]

Përveç shqetësimeve që kanë të bëjnë me ndërlikimet dhe natyrën e legjislacionit përkatës në procesin e privatizimit në Kosovë, veçanërisht në lidhje me çështjet e mungesës së qartësisë dhe detajeve,[165] dallohen dy shqetësime për të drejtat e njeriut. Disa dispozita të caktuara të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 krijojnë mundësinë për diskriminim në mënyrën në të cilën hartohen listat e punëtorëve që kanë të drejtë mbi aksionet dhe disa dispozita të caktuara të

[160] Ibid., 8.
[161] David Stanfield, et al., "Një vlerësim për të drejtat pronësore në Kosovë: Raporti përfundimtar", USAID, 2004, 29.
[162]Shih Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13, "për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit", 13 qershor 2002.
[163] Rregullorja e UNMK-ut nr. 2005/18, 6 shtator 2005, Neni 30.1.
[164] OSBE – Misioni në Kosovë, "Privatizimi në Kosovë: Rishqyrtimi gjyqësor i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës," maj 2008, 32.
[165] Shih diskutimin për ketë çështje të kompleksitetit dhe mungesës së legjislacionit të hollësishëm në raportin e OSBE-së për privatizimin, "Privatizimi në Kosovë: Shqyrtimi Gjyqësor i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës", maj 2008, 17–22.

Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18 janë barazi me shpronësimin e paligjshëm të pronës kur ato aplikohen në procesin e privatizimit.[166]

Në rastin e parë, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 përcakton se punëtorët mund të marrin pjesë në 20 për qind të të ardhurave nga shitja e NSH-së së privatizuar nëse ata kanë qenë të regjistruar si punëtorë të NSH-së kur ajo është privatizuar[167] dhe nëse kanë qenë në listën e pagave të NSH-së për jo më pak se tre vite (s'ka rëndësi kur). Në praktikë, një organ përfaqësues i punëtorëve të një NSH-je dhe Federata e Sindikatave të Pavarura të Kosovës do të hartojnë listat e punëtorëve që kanë ketë të drejtë dhe ja paraqesin ato AKM-së. Megjithatë federata e sindikatave rrallë ka shqyrtuar listat para publikimit të tyre. Emrat e pjesëtarëve të pakicave (mes tjerash) vazhdimisht mbetnin jashtë listave me arsyetimin se shumica e tyre nuk janë paraqitur në punë që nga qershori 1999, prandaj sipas ligjit nuk kualifikoheshin për tu përfshirë. Barra për të dëshmuar se dikush nuk është regjistruar si i punësuar në kohën e privatizimit për shkak të diskriminimit të pretenduar i mbetej krejtësisht parashtruesit të kërkesës.[168]

Numri i madh i ankesave të paraqitura kundër AKM-së dhe listat e punëtorëve të publikuara nga ajo merrnin shumicën e kohës së Dhomës së Posaçme. Më 9 qershor 2004,[169] Dhoma për herë të parë vendosi se kushtet e sigurisë në Kosovë pas vitit 1999 ishin të atilla sa që me arsye nuk është pritur që ndonjë anëtar i komuniteteve pakicë të paraqitej në punë dhe se këto ishin pothuajse diskriminim. Si pasojë, kërkesat e ankuesve në ketë rast pranoheshin pasi që "ata do të shënoheshin në regjistrin e punëtorëve të ndërmarrjes në kohën e privatizimit më 2003, po të mos ishin të diskriminuar."[170] Vendimi krijoj precedentin se ka pasur diskriminim kundër disa kategorive të caktuara të punëtorëve dhe përfundimisht e detyroi AKM-në të rishikojë vet listat e punëtorëve. Dhoma e Posaçme po ashtu e hodhi poshtë kushtin që njerëzit që pretendonin se kanë qenë të diskriminuar duhej të paraqisnin dëshmi për të dokumentuar ketë.[171]

Në rastin e dytë, ligji në fuqi[172] i jepte AKM-së autoritetin të privatizojë ose likuidojë një NSH, pavarësisht vlefshmërisë së "transformimit" të mëhershëm të subjektit nga prona private në pasuri shoqërore dhe se a ishte bërë ky transformim në mënyrë jodiskriminuese apo jo, kështu që

[166] Ibid., 25-27.
[167] Sipas Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2005/12, 26 korrik 2005, neni 4.3, "koha e privatizimit" është data dhe koha e përfundimit të një marrëveshjeje për shitjen e aksioneve në kompaninë vartëse.
[168] Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13, 9 maj 2003, Neni 10.4, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/45, 19 nëntor 2004, Nenet 1.B dhe 10.6. Ky kthim i barrës për të dëshmuar për çështjet diskriminuese nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.
[169] Shih Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në rastin *Vahdet Kollari et al. kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit* në çështjen e privatizimit të NSH-së "Termosistemi", 9 qershor 2004.
[170] Ibid.
[171] Shih Nenin 10.6(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, 9 maj 2003. Dhoma e Posaçme argumentojë se ky kusht e shkel nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
[172] Shih Nenet 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18, 6 shtator 2005.

pala e tretë mund të njihet si pronar i subjektit.[173] AKM-ja mund të verifikojë transformimin shoqëror të një pasurie ose subjekti vetëm pasi ajo të jetë privatizuar ose likuiduar. Në ketë kuadër, një subjekt i privatizuar ose pasuritë e tij nuk mund t'i kthehen pronarit (pronarëve) legjitimë. Pronarët kanë të drejtë ligjore të marrin një pjesë të të ardhurave nga shitja, por vetëm pasi të jenë zbritur shpenzimet administrative dhe pagesat e 20 përqindëshit për punëtorët që janë në listën e punëtorëve.

Aspekti shqetësues i këtij legjislacioni është se ai i jep AKM-së autorizimet e plota të shesë pasuritë (asetet) pa e përcaktuar se kush është pronar i tyre, dhe ajo mbron blerësit që blejnë këto prona nga AKM-ja, gjë që ka mundësi të qoj në shkeljen e të drejtave pronësore duke i shndërruar kështu disa privatizime në shpronësime të paligjshme të pasurive që janë në pronësi të palëve të treta.[174]

Në vendimin e rëndësishëm të 20 nëntorit 2007,[175] në lidhje me një kërkesë të bërë nga dy serbë për një pronë që ishte privatizuar nga AKM-ja gjoja se ajo i përkiste një NSH-je, Dhoma e Posaçme vendosi kundër AKM-së dhe konfirmojë të drejtat pronësore të parashtrueseve të kërkesës. Pas shqyrtimit të së drejtës së aplikueshme ndërkombëtare, gjyqtarët argumentuan se disa dispozita të caktuara të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18 "duket se i lejojnë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të bëjë një shpronësim të fshehtë, nën shprehjen 'shitje e aseteve (pasurisë)."[176] Dhoma e Posaçme përfundojë se këto dispozita të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18[177] i mundësojnë AKM-së të marrë pronën nën përkufizimin e shitjes së aseteve "pa vënë ndonjë kusht të saktë për një privim të tillë dhe të bërë në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së."[178]

Dhoma e Posaçme vazhdoi të shqyrtojë disa dispozita të caktuara të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13[179] të cilat ndalojnë shfuqizimin ose anulimin e çdo transaksioni që bën AKM-ja; ata gjykuan se këto dispozita ishin në kundërshtim me të drejtën e gjykatës për të bërë një shqyrtim të plotë gjyqësor të transaksioneve dhe për të ofruar mjetin juridik. Në të dy rastet, Dhoma e Posaçme vendosi që dispozitat e KEDNJ-së shfuqizojnë dispozitat e Rregulloreve përkatëse të UNMIK-ut.

---

[173] OSBE – Misioni në Kosovë, "Privatizimi në Kosovë: Rishqyrtimi gjyqësor i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës", Departamenti i Monitorimit/Divizioni i Sundimit të Ligjit, maj 2008, 25.
[174] Ibid., 26.
[175] Shih rastin *Alexander Hadzijevic dhe Vera Frtunic kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Hotelet e NSH Trepça*, SCC-06-0010, 20 nëntor 2007.
[176] Ibid., 7.
[177] Shih nenet 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. Nr. 2005/18, "për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", 6 shtator 2005.
[178] Shih rastin *Alexander Hadzijevic dhe Vera Frtunic kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Hotelet e NSH Trepça*, SCC-06-0010, 20 nëntor 2007, 7.
[179] Shih Nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, "për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit", 13 qershor 2002.

AKM-ja është shpërbërë, duke pritur themelimin nga qeveria e Kosovës të një agjencie të re të privatizimit. Derisa është duke u bërë kjo, Dhoma e Posaçme është joaktive deri sa Misioni i EULEX-it të zëvendësojë gjyqtarët ndërkombëtarë. Që nga nëntori 2007, AKM-ja ka privatizuar 32 NSH (për të cilat janë krijuar 550 subjekte vartëse) dhe ka likuiduar 110 NSH.[180] Privatizimi i NSH-ve ka sjellë fitim neto prej afër 500 milionë eurosh që mbahen në mirëbesim në një bankë të huaj.[181] Një valë e re e privatizimit duhet të fillojë sapo të krijohet dhe fillojë punën agjencia e re.

Ekziston shqetësimi se sistemi është i hapur për një numër hedhjesh në gjyq nga ndërmarrjet e tjera publike dhe nga qeveritë që kanë interes në asetet e privatizuara të Kosovës, gjë që ka mundësi të bllokoj zhvillimin ekonomik të Kosovës në vitet që vijnë. Është edhe më shqetësuese trashëgimia e kuadrit legjislativ të përgatitur për t'i mundësuar AKM-së të privatizojë dhe likuidojë ndërmarrjet publike dhe NSH-të në Kosovë në mënyrë jotransparente, me liri pothuaj të plotë të veprimit arbitrar dhe pa asnjë kontroll efikas gjyqësor, sistem që disa e kanë përshkruar si abuzim të ligjit.[182] Ligji i ri i Kuvendit të Kosovës për privatizimin në përgjithësi ka ruajtur dispozitat diskriminuese të rregulloreve të mëhershme të UNMIK-ut.[183]

[180] OSBE – Misioni në Kosovë, "Privatizimi në Kosovë: Rishqyrtimi gjyqësor i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës", Departamenti i Monitorimit/Divizioni i Sundimit të Ligjit maj 2008, 52.
[181] Ende nuk është marrë kurrfarë vendimi se si të përdoren fondet e akumuluara dhe fondet shtesë që duhet të mblidhen nga valët e ardhshme të privatizimeve.
[182] Intervistë me Gjyqtarin Tudor Pantiru, kryetar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, 27 korrik 2008.
[183] Ibid.

Pravda drzi zemlju i gradove, a nepravda rusi obadvoje.

Drejtësia mban qytete dhe fshatra, ndërsa padrejtësia rrënon të dyja – proverb serb.

IV. DREJTËSIA TRANZICIONALE DHE PASOJAT E KONFLIKTIT PRONËSOR NË KOSOVË

A. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Marek Nowicki, avokati i popullit i fundit ndërkombëtar i Kosovës përmblodhi sfidat kryesore të shoqërisë kosovare në një intervistë para se të largohej në shtator të vitit 2006. "Këtu bëhet fjalë për dy lloje të problemeve. Njëri përfshinë problemet e secilit person që jeton në Kosovë, e të tjerat janë probleme specifike të popullsisë joshqiptare."[184] Ai vazhdoi të identifikojë sistemin jofunksional të drejtësisë si problem që prek të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe duke theksuar problemet specifike të komunitetit serb dhe rom të Kosovës, siç janë liria e lëvizjes, siguria dhe çdo gjë që buron nga këto çështje.[185]

Kosova që nga ajo kohë e ka shpallur në mënyrë të njëanshme pavarësinë. Por burimet kryesore të konfliktit vazhdojnë të jenë të pranishme dhe përmbledhja që i bën Nowicki sfidave kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare, ndonëse në formë pak më të modifikuar, vazhdon të jetë e vërtetë. Gjyqësori mbetet i dobët, i korruptuar dhe i rënduar nga numri tepër i madh i rasteve të pazgjidhura civile, shumë prej të cilave kanë të bëjnë me pronat. Deri në shkrimin e këtij raporti ekzistojnë 50,000 deri në 60,000 kërkesa të pazgjidhura për pronat e dëmtuara, shkatërruara ose të uzurpuara në mënyrë të paligjshme dhe shumica e tyre u përkasin serbëve.[186] Shoqëria vazhdon të jetë e ndarë sipas komuniteteve. Komuniteti i mbetur serb kryesisht jeton në enklava të izoluara rurale, ku shërbimet bazë, si shëndetësia dhe arsimi, sigurohen nga institucionet përkatëse të Republikës së Serbisë. Pjesa e mbetur e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi dhe pasiguria dhe jetojnë në margjina të shoqërisë. Popullsia gorane e cila nga 28,000 banorë sa ka pasur në vitin 1999 tani ka rënë në 8,000, jeton në izolim dhe ka vështirësi në vijimin e shkollave ku mësohet serbisht.[187] Në veri të

[184] Marek Nowicki, "Korrupsioni dhe aranzhimet e improvizuara", intervistë në *Revistën Vreme,* 14 shtator 2006.

[185] Ibid. "Problemi i parë është mosfunksionimi i sistemit gjyqësor, të cilin ne mund ta quajmë kaos ligjor sepse ende nuk ka sistem të drejtësisë, askush nuk e di se cilat ligje janë të aplikueshme, dhe ju nuk keni kënd ta pyesni se çfarë ligji duhet të zbatohet në ndonjë situatë konkrete"

[186] Shih OSBE – Misioni në Kosovë, "Rregullimi aq shumë i pritur: Kthimi i pronave përmes Agjencisë Kosovare të Pronës", Departamenti i Monitorimit, shtator 2008, 4.

[187] Që nga qershori i vitit 1999, komuniteti goran ka pësuar 57 sulme me bomba dhe 11 vrasje. Asnjë kryerës i këtyre veprave nuk është sjell para drejtësisë. UNMIK-u në vitin 1999 e hoqi Komunën e Gores dhe e futi atë në Komunën e re të Dragashit në të cilin shqiptarët e përbënin shumicën e popullsisë. Sulmet dhe heqja e komunës së tyre, bashkë me kushtet e vështira ekonomike, bëri që shumë goranë të shkojnë në Serbi dhe në vendet e tjera. Të gjithë fëmijët serbë, goranë (dhe disa fëmijë romë) vijojnë mësimet në shkollat e organizuara nga Ministria Serbe e Arsimit. Autoritetet kosovare dhe UNMIK-u i konsiderojnë këto shkolla "institucione paralele", por nuk është zhvilluar asnjë alternativë për të zëvendësuar këto shkolla, e as nuk ka ndonjë strategji që do të ketë mbështetjen e shumë prindërve. Qeveria e Kosovës kohëve të fundit e mori përgjegjësinë për shkollat e goranëve dhe e imponojë planprogramin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës në gjuhën boshnjake. Prindërit goranë e kundërshtojnë këtë politikë, duke argumentuar se fëmijët e tyre nuk do të jenë në gjendje të ndjekin shkollimin e lartë në Serbi. Shumë

lumit Ibër, institucionet e Kosovës pothuajse nuk ekzistojnë fare. Komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës Veriore funksionojnë të pavarura dhe i marrin buxhetet e tyre nga qeveria e Serbisë. Ndarjet në shoqëri, pavarësisht sa janë reale apo me mundësi për destabilizim, shpesh mbesin në hije të kushteve të rënda socio-ekonomike të cilat ndikojnë në të gjitha komunitetet. Kosova vazhdon të ketë shkallën më të lartë të papunësisë në rajon si dhe shkallën më të ulët të produktivitetit dhe eksportit.

Demografia e Kosovës ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga përfundimi i konfliktit të armatosur. Numri masiv i shqiptarëve që migruan nga zonat rurale në qendrat urbane dhe largimi dhe dëbimi pothuaj në të njëjtën kohë i serbëve, romëve dhe të tjerëve, e kanë ndryshuar peizazhin. Me përjashtim të qytetit të ndarë të Mitrovicës, Kosova më nuk ka ndonjë komunitet substancial serb dhe romë në zonat urbane.[188] Në disa zona të caktuara, siç është rajoni i Pejës, rajoni i Gjilanit dhe disa pjesë të Kosovës qendrore kanë pasur rënie drastike të numrit të popullsisë serbe dhe rome. Zhvillimet politike që nga përfundimi i konfliktit kanë synuar të konsolidojnë ketë ndryshim demografik dhe e bën edhe më të përhershëm. Kur ish ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Tim Guldimann, i tha kohëve të fundit reporterëve në një konferencë për shtyp se Kosova nuk është shoqëri shumetnike, ai ndoshta ju është referuar ndryshimeve të vazhdueshme demografike si dhe mungesës së integrimit dhe ndarjes së komuniteteve.

Ky realitet thekson rëndësinë e drejtësisë tranzicionale në një shoqëri e cila në shumë aspekte vazhdon të jetojë me pasojat e konfliktit të vitit 1999 derisa ballafaqohet me të ardhmen e ndarë si asnjëherë më parë në çështjet e legjitimitetit dhe identitetit. Bashkësia ndërkombëtare ka investuar më shumë ndihmë civile për kokë banori në Kosovë se në cilëndo zonë pas konflikti në botë dhe është e vendosur të vazhdojë të bëj ketë gjë.[189] Në një periudhë të tranzicionit nga UNMIK-u në misionin e ri të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit (EULEX), është me rëndësi që zyrtarët ndërkombëtarë të analizojnë rrugën që tashmë është kaluar para se të përpiqen të fokusohen në objektiva të reja kur është fjala për kthimin e pronave, kthimin e njerëzve, sundimin e ligjit dhe se si të krahasohet përvoja e Kosovës me skenarët e tjerë të pas konfliktit.

Avokati i Popullit Nowicki e karakterizoi UNMIK-un si një eksperiment që ka mundur të arrijë rezultate më të mira. Megjithatë ai shtoi, "Pyetja e vërtetë është se a ka pasur në vitin 1999 vizion të qartë se çka dëshironin të bënin, dhe unë nuk jam i sigurt se ka pasur."[190] Bashkësia ndërkombëtare duhet të ketë vizion të qartë, realist dhe të bashkërenduar për drejtimin që duhet ta marrë në lidhje me të drejtën për kthimin e pronës, nëse dëshirohet të arrihet ndonjë progres në

---

fëmijë goranë nuk shkojnë më në shkollë dhe në vend të kësaj atyre u mbahet mësim në shtëpi private nga mësuesit e Ministrisë Serbe të Arsimit. Ky informacion u dha nga një udhëheqës i komunitetit goran më 19 korrik 2008, emri i të cilit nuk tregohet për arsye sigurie.

[188] Një numër shumë i vogël i serbëve dhe romëve ende jetojnë në Prizren, Prishtinë, në qytetin e Lipjanit dhe Gjilan, por shumica janë njerëz të moshuar. Këta banorë janë përfaqësuesit e fundit të asaj që para vitit 1999 ishte popullsi pakicë substanciale urbane.

[189] OSBE – Misioni në Kosovë, "Raport për gjendjen e përgjithshme: Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë," 2008, 1.

[190] Marek Nowicki, "Korrupsioni dhe aranzhimet e improvizuara," intervistë në *Revistën Vreme,* 14 shtator 2006.

përmirësimin e disa prej gabimeve nga e kaluara dhe për të sjellë shoqërinë më afër ndonjë forme të pajtimit. Shprehja pajtim kuptohet në këtë raport si një proces me shumë aspekte dhe afatgjatë i rindërtimit të besimit civil ndërmjet qytetarëve dhe shtetit dhe ndërmjet vet qytetarëve pas periudhës së konfliktit. Shprehja nuk përfshinë edhe nocionin e faljes apo të harresës.

B. DREJTËSIA TRANZICIONALE NË KOSOVË NË PERSPEKTIVËN KRAHASUESE

i. Informata të përgjithshme

Fundi i konfliktit të armatosur në Kosovë më 10 qershor 1999 dhe ardhja e një administrate civile ndërkombëtare (UNMIK) dhe një force paqësore ushtarake (KFOR) nuk shënoi fundin e pastrimit etnik ose dhunës; në fakt ky ishte vetëm fillimi i kësaj për një segment të popullsisë. Në shumë zona të pas konfliktit, pas përfundimit të armiqësive të armatosura, vazhdonte inercia e dhunës së shkallës së ulët dhe e diskriminimit kundër popullsive të padëshiruara. Megjithatë, në rastin e Kosovës vënia në shënjestër e komuniteteve pakicë, edhe pse kishte qenë evident gjatë konfliktit të armatosur, filloj edhe më me vrull pas largimit të Armatës Jugosllave dhe policisë serbe. Largimi masiv i serbëve, romëve dhe të tjerëve dhe uzurpimi i pronës së tyre e solli çështjen e kthimit të pronave në qendër të agjendës së bashkësisë ndërkombëtare, pa e ndryshuar prioritetin që kishte kthimi i njerëzve. Ndonëse u mbajt si proces i ndarë, ishte e qartë se kthimi i të drejtave pronësore të personave të zhvendosur ishte njëra ndër parakushtet e domosdoshme për ndonjë shpresë për kthimin e pakicave.

Kthimi i të drejtave pronësore në Kosovë kishte për qëllim të merrej në mënyrë efikase më një numër të madh të rasteve të ndërlikuara, sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këtë aspekt planifikuesit ndërkombëtarë e kuptuan qartë rëndësinë e themelimit të "një programi efektiv administrativ me rregulla të zbutura për dëshmitë" për trajtimin e shkeljeve të shumta dhe sistematike të të drejtave pronësore.[191] Duke themeluar Drejtorinë për Çështje Banesore dhe Pronësore (e pasuar më vonë nga Agjencia Kosovare e Pronës), bashkësia ndërkombëtare e pranoi se ishte e nevojshme që të gjendet një zgjidhje ligjore jashtë sistemit ekzistues jofunksional gjyqësor për të gjitha viktimat që kishin humbur pronat. Procesi i kthimit të të drejtave pronësore nën një sistem pothuaj gjyqësor të krijuar nga autoritetet ndërkombëtare ishte dhe është pjesë e rëndësishme e strategjisë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për problemet e personave të zhvendosur në Kosovë. Duke ofruar mundësinë për vënien e pronës së PZHBV-ve nën administrim të qeverisë, duke dhënë me qira pronat e PZHBV-ve dhe duke konfirmuar të drejtat e posedimit për tu mundësuar PZHBV-ve të shesin pronat e tyre nëse ata nuk janë në gjendje ose nuk duan të kthehen në shtëpitë e tyre, ky proces i DÇBP/AKP-së përmbush rekomandimin që Rhodri C. Williams e ka dhënë në dokumentin e tij për të drejtën bashkëkohore në kthimin e pronës në kontekstin e drejtësisë tranzicionale: për të mos e kushtëzuar kthimin e

[191] Rhodri C. Williams, "E drejta bashkëkohore për kthimin e pronës në kontekstin e drejtësisë tranzicionale", Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT), Seria e dokumenteve të rasteve, maj 2007, 50.

pronës me kthimin e njerëzve dhe për të shfrytëzuar kthimin e pronës si mjet për tu ofruar PZHBV-ve zgjidhje të qëndrueshme në vendin ku janë zhvendosur.[192]

Sistemi pothuajse gjyqësor i DÇBP/AKP-së ofron zgjidhje ligjore për problemin e marrjes së pronave që kanë PZHBV-të dhe të tjerët, por vazhdon të ballafaqohet me sfida serioze kur analizohet nga pikëpamja e rivendosjes së drejtësisë dhe korrigjimit. Ajo vuan nga mungesa e bashkërendimit më institucionet e tjera përkatëse në shoqëri. Që nga fillimi, procesi i kthimit të pronave dhe kthimit të njerëzve në Kosovë ka qenë i hendikepuar nga shumësia e aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët shpesh vepronin të ndarë dhe garonin me njëri tjetrin.[193] Konteksti është shumë i rëndësishëm, veçanërisht kur kthimi i pronës përpiqet të bëhet në një situatë në të cilën mbizotëron konflikti për të ardhmen e Kosovës, dhe kur ballafaqohet me forca brenda shoqërisë kosovare të cilat janë të interesuara që sistemi të dështojë, në mënyrë që të mbajnë pronën e uzurpuar në mënyrë të paligjshme dhe që të pengojnë kthimin e shumë PZHBV-ve. PZHBV-të e Kosovës janë të detyruar të punojnë në një sistem të jashtëzakonshëm administrativ me shpresë se do tu kthehet prona në një shoqëri e cila në punën e institucioneve të saj shpesh dërgon porosi kundërthënëse në lidhje me të drejtat e pakicave. Williams rekomandon që kur kthimi është pjesë e programimit tranzicional, ai duhet të konceptohet në atë mënyrë që të mbështesë edhe përpjekjet e tjera për të siguruar rregullime më të gjëra dhe të shmang konfliktet e ardhshme.[194] Sfida e Kosovës qëndron pikërisht në faktin se procesi i kthimit të pronës është bërë pjesë e një qasjeje jo të bashkërenduar për reformimin e institucioneve dhe të shprehive që minojnë mandatin specifik të sistemit të DÇBP/AKP-së në kthimin e të drejtave pronësore të atyre që u janë marrë këto të drejta.

Duke marrë parasysh se qëllimi përfundimtar i drejtësisë tranzicionale është që të shpie shoqërinë drejt paqes, demokracisë, sundimit të ligjit dhe respektit për të drejtat individuale dhe kolektive, një çështje që ngrihet ka të bëj me trashëgiminë e ndërtimit të institucioneve në Kosovë. Ekspertët pajtohen se tranzicioni në paqe dhe demokraci nuk mund të bëhet pa u konfrontuar me trashëgiminë e dhimbshme të së kaluarës, për të arritur një ndjenjë të përgjithshme të drejtësisë për të gjithë qytetarët.[195] Ky aspekt i konsolidimit në ndërtimin e paqes dhe demokracisë mbetet me të metat më të mëdha në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare në masë të madhe nuk e ka përfill çështjen e adresimit të trashëgimisë së abuzimit dhe promovimin e

[192] Ibid., 51.
[193] "Problemi nuk qëndron në atë se PZHBV-të nuk janë në gjendje të ngritin shqetësimet e tyre. Problemi qëndron në faktin se institucionet që janë përgjegjëse për të përcjellë këto mesazhe e komplikojnë çështjen... shqetësimet e PZHBV-ve merren në konsideratë vetëm nëse ato në radhë të parë të tërheqin ndonjë interes. Rrallë ndodh që të ketë simfoni të interesave, dhe atëherë edhe UNDP edhe UNHCR e veçanërisht OJQ-të i shfrytëzojnë në maksimum këto mesazhe qoftë përmes ekzagjerimit ose zvarritjes. Si rezultat, ajo që dëgjohet nuk është zë njerëzor, por produkt i institucioni. Në fund përsëritja e atyre shpresave të rrejshme dhe premtimeve të pambajtura vetëm sa i fusin PZHBV-të në mjerim dhe depresion edhe më të thellë." Intervistë me Dusan Radosavljeviq, zyrtar terreni i projektit, OJQ "UNIJA M", 19 dhjetor 2008.
[194] Ibid. 51
[195] Paul Van Zyl, "Promovimi i drejtësisë tranzicionale në shoqëritë pas konfliktit," Botues apo Agjenci? 2005, 209.

dialogut të sinqertë ndëretnik, me qëllim të ndërtimit të aparatit të shoqërisë demokratike (zgjedhjet, parlamenti, policia, gjyqësori i reformuar dhe mediat).

Ndarjet politike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë rreth legjitimitetit të institucioneve të Kosovës përkojnë dhe hyjnë në domenin e tregimit të historisë dhe dhimbjes. Të dy komunitetet e kanë zhvilluar vizionin e viktimizimit të tyre nga komuniteti tjetër; kjo vepron si pengesë e frikshme për pajtim. Tregimi dominues dhe zyrtar për konfliktin e Kosovës të fundit të viteve 90-ta, veçanërisht për shqiptarët e Kosovës, është triumfues dhe jo-shfajësues.[196]

Krijimi i agjencive të përkohshme nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, siç është DÇBP/AKP-ja, për kthimin e pronave është pasojë e konfliktit. Ende vetëm pak institucione të përhershme të Kosovës janë sensibilizuar për dhimbjet dhe vuajtjet që pjesëtarët e komuniteteve pakicë i kanë përjetuar për shkak të zhvendosjes së tyre dhe humbjes së pronës. Në shumë shoqëri të pas konfliktit, grupet e shoqërisë civile shpesh veprojnë si urë lidhëse mbi ndarjen etnike për të filluar përpjekjet për kërkimin e të vërtetës dhe për pajtimin e grupeve. Kjo ende ka mbetur për tu bërë në mënyrë serioze në Kosovë, sepse sektori i shoqërisë civile është i dobët dhe i mungon ndonjë përbërje e fortë.[197] Strukturat patron-klient dhe ato klanore janë të fuqishme në shoqërinë e shqiptarëve në Kosovë, ndërsa serbët janë tërhequr nën mbrojtjen institucionale të qeverisë së Serbisë përmes të ashtuquajturave institucione paralele (shkolla, shëndetësi, pensione, regjistra civilë). Përkundër përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për ndërtimin e institucioneve, Kosova vazhdon të mbetet larg nga të qenit shoqëri e integruar, vazhdon të jetë e udhëhequr nga krimi dhe traumat e viteve të konfliktit dhe frikësimit, me një sektor civil të fragmentuar dhe të polarizuar i cili mund të mobilizohet fare lehtë nga udhëheqësit ekstremist.[198] Realiteti i ndërlikuar i ndarjes në Kosovë vazhdon të paraqes sfidë serioze për pajtimin.

ii. Bosnja dhe Hercegovina

Sa për krahasim, edhe pse zbatimi i kthimit të drejtave pronësore në Bosnje dhe Hercegovinë (BeH) ka qenë një çështje e komplikuar, e cila ka kërkuar shumë kohë dhe është shoqëruar me armiqësi të mëdha nga nacionalistët e të dy entiteteve territoriale të krijuara me Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit (MPD),[199] bashkësia ndërkombëtare ka qenë në gjendje të tejkalojë një pjesë të kësaj rezistence. Deri në vitin 2004, të dy entitetet kryesisht kanë përfunduar procesin e kthimit

[196] Dëshmi për ketë është konferenca për shtyp që e ka mbajtur Kryeministri Hashim Thaçi në një enklavë serbe. I pyetur se kur do të jetë i gatshëm të kërkojë falje për viktimat e krimeve të UÇK-së, ai tha: "Duhet të shikojmë kah e ardhmja e jo kah e kaluara…Çdokush e di se kush duhet të kërkojë falje." "Thaçi refuzon të kërkojë falje për krimet e UÇK-së", Lajmet e B92, 19 janar 2008.

[197] "Shumica e tyre janë të vendosura në Prishtinë dhe janë të orientuara në shërbime dhe të organizuara në projekte afatshkurtra të financuara nga donatorët." Jessica Johnson, "Ndihma ndërkombëtare për demokratizimin dhe pajtimin në Kosovë," Departamenti i Hulumtimeve të Paqes dhe Konflikteve, Universiteti Uppsala, nëntor 2004, 53.

[198] Ibid., 56.

[199] Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (me shumicë boshnjake dhe kroate) dhe Republika Serbe (me shumicë serbe).

të pronës.[200] MPD-ja ka krijuar tri institucione në BeH që kanë luajtur role të rëndësishme në procesin e kthimit të drejtave pronësore: Komisionin për Kërkesat për Pasuri të Patundshme të Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur (KKPP), një organ pothuajse ndërkombëtar i ngarkuar me përgjegjësi për marrjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me pretendimet për të drejtat pronësore; Dhoma për të Drejtat e Njeriut, e themeluar si Gjykatë e Lartë për të monitoruar respektimin e obligimeve për të drejtat e njeriut nga ana e BeH-së, veçanërisht nën Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (GJEDNJ); dhe Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (ZPL), e mandatuar për të mbikëqyrë zbatimin e aspekteve civile të MPD-së në BeH.[201]

Ngjashëm me Rezolutën e KS të OKB-së 1244 për Kosovën, MPD-ja në Aneksin 7 ka theksuar se mundësimi i kushteve për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur është "objektiv i rëndësishëm i zgjidhjes së konfliktit në Bosnje". Sidoqoftë, përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të kthyer prapa gjendjen e krijuar nga spastrimi etnik duke inkurajuar kuota *ad-hoc* të kthimeve ka dështuar. Dy entitetet territoriale në Bosnje (Federata Boshnjako-Kroate dhe Republika Serbe) vazhduan të favorizojnë bashkëkombësit e tyre me rastin e rindarjes së pronës dhe kështu ka vazhduar spastrimi etnik në mënyrë të heshtur.[202] Insistimet e bashkësisë ndërkombëtare për kthimin e refugjatëve dhe PZHBV-ve në vendin ku ata kanë banuar më parë është treguar të jetë pengesë për kthimin efikas të pronës. Kështu, duke filluar nga viti 2001, ZPL-ja ka bërë disa ndryshime të cilat kanë anuluar kushtin që PZHBV-të duhet të kthehen në BeH si parakusht për të riposeduar pronën e tyre.[203]

Bashkësia ndërkombëtare ka ndryshuar perceptimin e saj për kthimin e pronës nga konsiderimi i saj si mjet për promovimin e kthimit tek kërkimi i zgjidhjeve afatgjata për PZHBV-të. Duke iu përgjigjur presionit ndërkombëtar në vitin 1998, ZPL-ja ka shfuqizuar ligjet problematike për çështje pronësore në nivel të entitetit dhe ka krijuar një proces vendor për parashtrimin e kërkesave për kthim të pronës, i cili ka ndihmuar në kthimin e pronave të kontestuara pronarëve legjitim të paraluftës.[204] Për më tepër, ZPL-ja ka përdorë kompetencat e veta të plota sipas MPD-së për të larguar 22 zyrtarë lokal nga postet e tyre për shkak se janë akuzuar për pengimin e aplikimit të ligjeve për pronën; shkarkimi i këtyre zyrtarëve ka quar deri tek aplikimi më i harmonishëm dhe më efektiv i ligjeve në të dy entitetet.[205]

Rezultati përfundimtar i përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare ka qenë se prona u është kthyer pothuaj një milion personave në BeH deri në vitin 2004. Pas kësaj, ZPL-ja ka transferuar tërë përgjegjësinë për çështjet e kthimit te autoritetet vendore.[206] Rhodri C. Williams kualifikon BeH-në si "shembullin e parë të zbatimit të suksesshëm të kthimit të pronës pas një konflikti të

[200] Rhodri C. Williams, "E drejta bashkëkohore për kthimin e pronës në kontekstin e drejtësisë tranzicionale", Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT), Seria e dokumenteve të rastit, maj 2007, 40.
[201] Ibid., 36.
[202] Ibid., 37.
[203] Ibid., 39.
[204] Ibid., 37.
[205] Ibid., 37.
[206] Ibid., 41.

madh."[207] Sidoqoftë ky sukses është kualifikuar nga fakti se relativisht shumë pak PZHBV të cilët me sukses kanë riposeduar pronat e tyre në fakt edhe janë kthyer. Sipas Williams, një mësim i rëndësishëm nga kthimi i pronës në Bosnje, është nevoja për të ndihmuar zgjedhjet individuale për zgjidhje afatgjate të zhvendosjes, në vend se të paragjykohet rezultati duke theksuar kthimin. Sidoqoftë, ai përfundoj analizat e tij duke vënë në pyetje nëse është bëtë mjaft përtej kthimit të pronës për të siguruar se vendimet e marra për zgjidhje afatgjatë kanë qenë më të vërtet të qëndrueshme dhe se ato janë marrë në mënyrë vullnetare.[208]

Veprimet e vendosura të ZPL-së në BeH kundër zyrtarëve lokal të akuzuar për pengimin e procesit të kthimit të pronës e vënë në pah dallimin që ajo ka me punën e dobët të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Pavarësisht nga pushteti i madh dhe superior i PSSP-së dhe UNMIK-ut në përgjithësi në Kosovë, në kontekstin në të cilin me qindra krime janë shkaktuar kundër popullsisë dhe pronës, duke shkelur kështu mandatin e OKB-së, asnjë zyrtar kosovar nuk është shkarkuar apo sanksionuar në mënyrë publike.[209] Pavarësisht përpjekjeve që janë për tu lavdëruar dhe programeve intensive për të reformuar sistemet e policisë dhe drejtësisë, paaftësia e bashkësisë ndërkombëtare për t'u ballafaquar vendosmërisht me çështjen e mosndëshkimit për krimet ka lënë peng të ardhmen e sundimit të ligjit në Kosovë.

Disa në bashkësinë ndërkombëtare gjatë raportimit të politikave vetëm sa kanë kaluar nëpër problemet serioze strukturore në Kosovë, nganjëherë duke paraqitur vlerësime të dëshirueshme dhe shumë optimiste për trendët në zhvillim e sipër. Ata duket se e kanë marrë shumë afër zemrës thënien e Hobsit se vetëm "vetëm e vërteta që nuk është kundër përfitimit ose kënaqësisë është e mirëseardhur për të gjithë." Raportet e tilla janë përpiluar për t'iu përshtatur një agjende të caktuar, përfundimisht duke dëmtuar përpjekjet për të kuptuar thellësinë dhe kompleksitetin e problemeve dhe atëherë për të trajtuar ato përmes reformave të guximshme dhe të matura.

Ekzistojnë ngjashmëri në mes të Kosovës dhe BeH-së sa i përket rezultateve relativisht të dobëta në kthimin e refugjatëve dhe PZHBV-ve. Në të dy rastet, realitetet e pasluftës në konsolidimin e hegjemonisë etnike nën elitat nacionaliste kanë kontribuar në parandalimin e kthimit të një numri të konsiderueshëm të popullsisë për të jetuar në shtëpitë që kanë pasur para konflikteve.

Pavarësisht zotimeve ligjore për kthim, rezultatet në Kosovë vazhdojnë të jenë të pakta. Bashkësia ndërkombëtare dhe autoritetet lokale kanë krijuar një proces të madh dhe kompleks për të mbikëqyrë kthimin, proces ky i ndarë nga mekanizmi i krijuar për të siguruar kthimin e pronës.[210] Pjesa më e rëndësishme e strategjisë për kthim është themelimi i Ministrisë për

[207] Ibid., 33.
[208] Ibid., 41.
[209] Në dy raste, PSSP-të e shfrytëzuan autoritetin e tyre të veçantë ekzekutiv për të urdhëruar zyrat komunale të kadastrës që t'ia kthejnë të drejtat pronësore Cedomir Prlinceviqit (udhëheqës i një komunitetit të vogël hebre në Prishtinë) dhe Manastirit Ortodoks Serb Visoki Decani në shënimet kadastrale.
[210] OSBE – Misioni në Kosovë, "Tetë vjet pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i pronës dhe banesave në Kosovë", Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, qershor 2007, 16-17.

Komunitete dhe Kthim (MKK)[211] dhe i Grupeve punuese komunale (GPK), organe këto që i bashkon autoritetet vendore komunale, OJQ-të, UNMIK-un, UNHCR-në, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe shoqatat e PZHBV-ve. Këto organe koordinojnë hapat e ndryshëm të një kthimi të organizuar të PZHBV-ve në nivel lokal sipas procedurës së përcaktuar në "Doracakun për kthim të qëndrueshëm"."[212] UNMIK-u, qeveria e Serbisë dhe Institucionet e atëhershme Vetëqeverisëse të Kosovës kanë nënshkruar Protokollin për kthim vullnetar dhe të qëndrueshëm, i cili përcakton ofrimin e ndihmës në rindërtim për të kthyerit në baza vullnetare, brenda 60 ditësh pasi që ata të kenë deklaruar qëllimet e tyre për t'u kthyer.[213] Sidoqoftë, ky mekanizëm ka mbetur ende për t'u zbatuar.

iii. Turqia

Qasja e Turqisë ndaj kthimit të pronës dhe të personave të zhvendosur ofron edhe një shembull tjetër krahasues për Kosovën. Konflikti në Turqinë juglindore (1984–1999) në mes të kryengritësve të Partisë Kurde të Punës (PKK) dhe forcave Turke të sigurisë ka lënë më shumë se 30,000 të vdekur, kryesisht civilë, dhe ka quar në zhvendosjen e qindra mijëra të tjerëve, kryesisht kurdë.[214] Strategjia e Qeverisë Turke ka pasur për qëllim që kthimi i pronës dhe vetë kthimi i njerëzve të mbështeten në dy programe: Projekti i kthimit në fshat dhe rehabilitimit (PKFR), i nisur në mars të vitit 1999, dhe Ligji për Kompensimin nr. 5233, i nxjerrë më 17 korrik 2004.[215]

PKFR-ja ka qenë programi i parë i nisur në Turqi për t'u ndihmuar PZHBV-ve të kthehen në shtëpitë e tyre apo të vendosen në fshatra të reja. I mbikëqyrur nga Ministria e Punëve të

[211] MKK-ja është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/50 më 2 dhjetor 2004. Fillimisht ajo u vu nën mbikëqyrjen e rreptë të Zyrës së UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete (ZKK) dhe veprojë në bazë të "Doracakut të parë për Kthim të Qëndrueshëm", që e hartoi UNMIK-u në konsultim me UNHCR-në dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile. MKK-ja gradualisht mori më shumë përgjegjësi në pajtim me politikën e UNMIK-ut për bartjen e përgjegjësive te homologët kosovarë me zhvillimin e kapaciteteve të tyre. MKK-ja kaloi tërësisht në përgjegjësinë e autoriteteve vendore më 12 dhjetor 2007. Ajo ishte e hendikepuar që në fillim nga drejtimi i dobët dhe personeli, nga mungesa e strategjisë së qartë, dhe nga akuzat e rënda për mashtrim dhe korrupsion. Sipas marrëveshjes, ministri i MKK-së gjithmonë duhet të jetë serb. Megjithatë, duke pasur parasysh se shumica e serbëve të Kosovës nuk janë të integruar plotësisht në institucionet e Kosovës, ishte gjithmonë e vështirë të gjendet një kandidat i përshtatshëm serb, me kualifikimet e nevojshme dhe me legjitimitet në komunitetin e tyre. Tre nga katër personat që morën këtë pozitë ishin të detyruar të japin dorëheqje për shkak të akuzave për mashtrim, udhëheqje të dobët dhe korrupsion.

[212] Shih UNMIK dhe IPVQ, "Doracaku i Korrigjuar për Kthim të Qëndrueshëm', korrik 2006.

[213] OSBE – Misioni në Kosovë, "Tetë vjet pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i banesave dhe pronës në Kosovë," Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, qershor 2007, 16.

[214] Disa organizata thonë se forcat qeveritare kanë larguar ose deportuar me dhunë ndërmjet tre dhe katër milionë njerëz nga zona e konfliktit. Statistikat e Ministrisë Turke të Punëve të Brendshme flasin për një numër prej 350,000 deri në 400,000 PZHBV. Shih Komitetin e Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit për të Drejtat e Njeriut, "Statusi i kurdëve të zhvendosur brenda vendit në Turqi: Kthimi dhe të drejtat e kompensimit – Informacion i azhurnuar," dhjetor 2006, dhe Dilek Kurban et al., "Tejkalimi i trashëgimisë së mosbesimit: Drejt pajtimit në mes të shtetit dhe të zhvendosurve," Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Shoqërore (TESEV), maj 2006. Në vitin 2004, dhuna shpërtheu sërish kur PPK-ja shkeli armëpushimin që ishte në fuqi pasi që udhëheqësi i grupit, Abdullah Oçalan, u zu në vitin 1999.

[215] Dilek Kurban et al., "Tejkalimi i trashëgimisë së mosbesimit: Drejt pajtimit në mes të shtetit dhe të zhvendosurve," Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Shoqërore (TESEV), maj 2006, 33.

Brendshme, programi ka për qëllim të bëj një studim sistematik të problemeve dhe nevojave të personave të zhvendosur, të identifikojë familjet që dëshirojnë të kthehen, të rehabilitojë infrastrukturën brenda fshatrave të braktisura dhe të shkatërruara, të përfundoj objektet shoqërore siç janë shkollat, klinikat dhe të promovojë ndërtimin e shtëpive dhe përpiqet që të mbështet aktivitetet siç janë bujqësia, ekonomia bujqësore dhe bletaria për të ndihmuar familjet të mbajnë veten.[216] PKFR-ja zbatohet përmes udhëheqjes së guvernatorit ose nën-guvernatorit në provincat përkatëse juglindore. Që nga viti 2006, Komisioni Turk për të Drejtat e Njeriut ka llogaritur se janë kthyer 95,451 njerëz të mbështetur nga këto programe.[217]

Sidoqoftë, zyrtarët ndërkombëtar dhe organizatat për të drejtat e njeriut, si dhe OJQ-të lokale e kanë kritikuar PKFR-në. Ato citojnë mungesën e transparencës nga ana e autoriteteve sa i përket zbatimit të programit, mungesën e financimit adekuat, mungesën e objektivave të qarta të politikave të paraqitura dhe fushëveprimin e burimeve dhe fondeve të nevojshme për arritjen e tyre, mungesën e konsultimit me OJQ-të dhe vetë PZHBV-të dhe paaftësinë apo mungesën e gatishmërisë së autoriteteve për t'iu qasur pengesave të vazhdueshme ndaj kthimit në Turqinë juglindore.[218] Vëzhguesit insistojnë se programi ka bërë shumë pak për të rigjallëruar gjendjen socio-ekonomike në zonat e prekura nga konflikti dhe se pa një qasje të tillë, çfarëdo bisedash për kthim të qëndrueshëm janë të nxituara.[219] PZHBV-të ballafaqohen me pengesat e mëposhtme:

a) Sigurinë e dobët, veçanërisht që nga viti 2004. Edhe pse forcat e sigurisë nuk pengojnë PZHBV-të për t'u kthyer, përsëritja e luftimeve i brengos shumë PZHBV-vë se do të gjejnë veten në mes të luftës apo se do të shndërrohen në viktimë të forcave të sigurisë apo guerilëve.[220]

b) Mungesën e transparencës në ndihmën që autoritetet u ofrojnë atyre përmes PKFR-së. Shumë PZHBV janë ankuar se kanë marrë shumë pak apo nuk kanë marrë fare ndihmë nga autoritetet, se materialet për ndërtimin e shtëpive që ata kanë marrë janë të pamjaftueshme dhe se është ndërtuar shumë pak nga infrastruktura e premtuar publike.[221]

c) Tentimin nga ana e autoriteteve për të rivendosur PZHBV-të në "vendbanime të centralizuara" e jo në fshatrat e tyre.[222]

d) Prania e vazhdueshme e minave.

[216] Komiteti i Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit për të Drejtat e Njeriut, "Statusi i kurdëve të zhvendosur brenda vendit në Turqi: Kthimi dhe të drejtat e kompensimit – Informacion i azhurnuar," dhjetor 2006, 21.
[217] Ibid., 23.
[218] Dilek Kurban et al., "Tejkalimi i trashëgimisë së mosbesimit: Drejt pajtimit në mes të shtetit dhe të zhvendosurve," Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Shoqërore (TESEV), maj 2006, 30.
[219] Ibid., 30.
[220] Ibid., 31.
[221] Ibid., 31.
[222] Ibid., 31.

Walter Kaelin, përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit (PSP), në vlerësimin e tij në vitin 2002 ka kritikuar mungesën e përparimit të PKFR-së. Ai ka bërë thirrje për kompensim të drejtë dhe të shpejtë të atyre që kanë pësuar humbje për shkak të konfliktit.[223] Qeveria Turke ka reaguar në kërkesat për ndryshime—si dhe për shkak të presionit nga numri i madh i rasteve të dërguara GJEDNJ-së—duke miratuar Ligjin për Kompensimin nr. 5233 në vitin 2004, akt ky që analistët e konsiderojnë "padyshim si hapin më të rëndësishëm deri më tani për të adresuar problemin e zhvendosjes së brendshme në Turqi."[224] Ligji ka për qëllim të kompensojë njerëzit për dëmet materiale të shkaktuara që nga viti 1987, kur edhe është shpallur gjendja e jashtëzakonshme në provincat përkatëse. Ky ligj mundëson kompensimin e çdokujt që ka pësuar humbje për shkak të terrorizmit apo aktiviteteve antiterroriste, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar në) PZHBV-të, anëtarët e forcave të armatosura, policinë dhe rojat e fshatit.[225] Ligji mundëson kompensimin për tri lloje të humbjeve: dëmtimin e pronës së luajtshme apo paluajtshme, dëmtimin e jetës apo trupit të një personi dhe dëmin e shkaktuar nga pamundësia për të pasur qasje në pronë.[226]

Edhe pse procesi i kompensimit në Turqi është i ngjashëm me atë të Kosovës, sa i përket asaj se funksionon sipas një sistemi të përkohshëm ligjor në formë të komisioneve për vlerësimin e dëmeve, dallon për atë se këto organe pothuajse plotësisht janë të përbëra nga punëtorët publik (gjashtë nga të shtatë anëtarët, ku i shtati është anëtar i Odës Lokale të Avokatëve) dhe mund të themelohet sipas kërkesës në cilëndo provincë, nën udhëheqjen e zëvendës guvernatorit siç përcaktohet nga guvernatori i provincës.[227]

Pas pranimit të kërkesës nga ana e aplikuesit, bëhet vlerësimi i dëmeve dhe komisionet përgatisin deklaratën e marrëveshjes e cila përcakton kompensimin që duhet të paguhet në para të gatshme apo të kompensohet me mjete tjera.[228] Nuk ka ndonjë mekanizëm për t'u ankuar kundër vendimeve të komisionit (në Kosovë janë paraparë dispozita të tilla kundër vendimeve të AKP-së). Sidoqoftë qytetarët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë individuale për kompensim në gjykatën

[223] Komiteti i Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit për të Drejtat e Njeriut, "Statusi i kurdëve të zhvendosur brenda vendit në Turqi: Kthimi dhe të drejtat e kompensimit – Informacion i azhurnuar," dhjetor 2006, 22.
[224] Dilek Kurban et al., "Tejkalimi i trashëgimisë së mosbesimit: Drejt pajtimit ndërmjet shtetit dhe të zhvendosurve," Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Shoqërore (TESEV), maj 2006, 33.
[225] Ibid., 33. "Rojet e fshatit" kur kurdët lokalë të cilët autoritetet filluan t'i armatosin më 26 mars 1985 për të ndihmuar forcat e sigurisë në luftimin e PPK-së. Një numër i organizatave për të drejtat e njeriut i kanë akuzuar këta roje për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për pjesëmarrje në aktivitete kriminale. Ata po ashtu shërbejnë si pengesë e mundshme për kthim në disa zona. Shih Komitetin e Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit për të Drejtat e Njeriut, "Statusi i kurdëve të zhvendosur brenda vendit në Turqi: Kthimi dhe të drejtat e kompensimit – Informacion i azhurnuar," dhjetor 2006, 24.
[226] Dilek Kurban et al., "Tejkalimi i trashëgimisë së mosbesimit: Drejt pajtimit në mes të shtetit dhe të zhvendosurve," Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Shoqërore (TESEV), maj 2006, 33.
[227] Ibid., 33.
[228] Ibid., 33.

lokale.[229] Që nga 31 janari 2006, pothuajse 180,000 aplikacione u janë parashtruar komisioneve ndërsa nga këto janë zgjidhur rreth 16,000 – më pak se 10 për qind.[230]

Përderisa Ligji për Kompensimin është përshëndetur si hap i konsiderueshëm përpara, veçanërisht në krahasim me PKFR-në, grupet e të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile kritikojnë mënyrën se si është aplikuar procesi. Ata thonë se ligji përjashton një numër të madh të PZHBV-ve të cilët kanë ikur nga zonat e konfliktit, për shkak se specifikon se vetëm ata që janë "dëbuar me forcë" mbulohen nga kompensimi. Mungesa e shpërndarjes adekuate dhe e informimit të PZHBV-ve dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile ka qenë një pikë tjetër e mosmarrëveshjes. Këto kritika përkojnë pjesërisht me disa nga problemet me të cilat ballafaqohen PZHBV-të në Kosovë në marrëdhëniet e tyre me institucionet përkatëse në Kosovë.

Kritikët deklarojnë se komisionet e përbëra nga punëtorët publik mund të shpijnë në marrjen e vendimeve arbitrare, mungesën e drejtësisë dhe vlerësimet joefektive.[231] Në Kosovë ky problem është shmangur duke krijuar organe pothuaj gjyqësore, të cilat përbëhen nga profesionistë (DÇBP, AKP dhe AKM), por kjo nuk ka parandaluar qytetarët nga akuzimi i komisioneve për mungesë të transparencës në marrjen e vendimeve.

Ligjit për Kompensimin nr. 5233 i mungojnë udhëzimet e qarta dhe të detyrueshme për zbatimin e tij dhe kjo ka quar në zgjidhje të ndryshme për rastet e njëjta, varësisht nga ajo se cili komision ka vendosur dhe ku.[232] Për shkak të varfërisë dhe edukimit të dobët, PZHBV-të në Turqi janë ballafaquar me shumë telashe për të pasur qasje në proces dhe në përgjithësi në sistemin gjyqësor. Kritikët theksojnë se nuk është bërë mjaft për të ndihmuar këta njerëz për të pasur qasje në të drejtat e tyre dhe i bëjnë thirrje qeverisë për të ofruar ndihmë ligjore.[233]

Kjo ka qenë problem edhe në Kosovë, por atje i janë shtuar edhe siguria dhe distanca dhe meqë pjesa më e madhe e PZHBV-ve kanë qenë në Serbi apo Mal të Zi, ata nuk kanë mundur të kenë qasje në sistemin në Kosovë. Kohëve të fundit Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) ka themeluar "Programin e ndihmës juridike për Institucionet e Qeverisë së Serbisë në trajtimin e refugjatëve dhe PZHBV-ve" nën programin e financuar nga BE-ja për t'u ofruar PZHBV-ve ndihmë juridike falas dhe përfaqësim në institucionet ligjore të Kosovës.[234]

Dispozitat e Ligjit Turk për Kompensimin e dëmeve nga konflikti e bëjnë atë më shumë sesa ligj i cili trajton kthimin e pronës së humbur. Kjo është një ambicie përtej fushëveprimit të çdo rregulloreje të miratuar në Kosovë. Në fjalën e tij të mbajtur në një konferencë për PZHBV-të në Ankara në vitin 2006, Rhodri C. Williams ka theksuar se duke synuar të ofrojë zgjidhje për

[229] Ibid., 33.
[230] Ibid., 34.
[231] Ibid., 40.
[232] Ibid., 40.
[233] Ibid., 40.
[234] Shih Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), "Programi i ndihmës juridike për Institucionet e Qeverisë së Serbisë në trajtimin e refugjatëve dhe PZHBV-ve", Raporti fillestar, Beograd 30 gusht 2008.

pasojat të cilat kanë rezultuar nga dëmtimet si "lëndimi, paaftësia fizike dhe vdekja dhe shpenzimet për trajtim mjekësor dhe varrim," (Neni 7b i ligjit), Ligji nr. 5233 "përmban disa elemente të programeve të reparacioneve."[235] Sidoqoftë në përpjekjen e ligjit për të kërkuar zgjidhje afatgjatë për zhvendosje dhe për të proceduar një numër të madh kërkesash brenda një kohe të shkurtër përmes dispozitave të veçanta të sistemit ligjor, ai përngjan me skemat tjera për kthimin e pronës, siç janë ato të krijuara në Kosovë dhe BeH.[236]

Një gjë që Kosova dhe Turqia e kanë të përbashkët është mungesa e çfarëdo përparimi të bërë drejt adresimit të pajtimit, pavarësisht ekzistimit të programeve për kthimin e personave dhe kthimin e pronës. Preambula e Ligjit për Kompensimin nr. 5233 i bën aluzion nevojës për pajtim dhe thekson se një nga qëllimet e tij është "inkurajimi i besimit për shtetin, rivendosja e marrëdhënieve në mes të shtetit dhe qytetarëve të tij dhe kontributi ndaj paqes sociale."[237] Sidoqoftë, ligji ofron vetëm kompensime në formë materiale dhe nuk adreson drejtpërdrejtë çështjet e traumave që lidhen me keqtrajtimet në të kaluarën.[238] Për më tepër, as qeveria turke e as PKK-ja nuk kanë ndërmarrë hapa për të pranuar përgjegjësinë për gabimet dhe fajet e bëra në të kaluarën. "Pranimi publik nga ana e shtetit," ka rekomanduar një raport, "të përgjegjësisë për dëbimet nga fshatrat, kompensimin për dhimbjen dhe vuajtjen dhe deklarimin e vullnetit për të identifikuar dhe ndjekur – aty ku është mundshme – ata që kanë shkelur të drejtat e njeriut… mund të jenë në mesin e atyre masave. Sidoqoftë, po ashtu është e rëndësishme… se pajtimi do të kërkonte nga PKK-ja të demonstrojë vullnet të ngjashëm për të marrë përgjegjësinë e saj për shkeljet e të drejtave të njeriut që ajo ka bërë."[239]

Kjo gjendje vërehet edhe në Kosovë, ku bashkësitë serbe dhe shqiptare kanë pikëpamje të ndryshme për të ardhmen e Kosovës, dhe janë bërë shumë pak, nëse është bërë ndonjë hap për të adresuar traumat dhe keqtrajtimet në të kaluarën dhe për të përcaktuar përgjegjësinë.

C. PENGESAT DHE SFIDAT

Walter Kaelin, (PSP) ka theksuar se sa e rëndësishme është që qeveritë të krijojnë politika efektive përmes konsultimit të ngushtë me PZHBV-të.[240] "Politikat dhe programet të cilat u përgjigjen nevojave kryesore të të zhvendosurve janë mjeti më i mirë për krijimin e konsensusit kombëtar rreth çështjes së vendosjes së themeleve për paqe dhe stabilitet," argumenton ai. "Shumë shpesh qeveritë dhe organizatat zhvillojnë politika dhe programe për PZHBV-të pa i konsultuar ata në mënyrë adekuate. Si rezultat i kësaj dalin politika dhe programe të cilat nuk i përgjigjen aq sa duhet nevojave të tyre."

[235] Rhodri C. Williams, "Kompensimi i pronës: Vështrime në Ligjin Turk për Kompensimin nr. 5233 në kontekstin ndërkombëtar", Konferenca për Personat e zhvendosur brenda vendit, Ankara, Turqi, 23 shkurt 2006.
[236] Ibid.
[237] Dilek Kurban et al., "Tejkalimi i trashëgimisë së mosbesimit: Drejt pajtimit në mes të shtetit dhe të zhvendosurve," Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Shoqërore (TESEV), maj 2006, 43.
[238] Ibid., 44.
[239] Ibid., 44.
[240] Walter Kaelin, "Zëri i shoqërisë civile dhe i personave të zhvendosur brenda vendit," Konferenca për Personat e Zhvendosur Brenda Vendit, Ankara, Turqi, 23 shkurt 2006.

Komentet e PSP-së mund të shërbejnë si temë kryesore për disa nga problemet të cilat kanë hendikepuar reagimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj gjendjes së vështirë të PZHBV-ve në Kosovë. Shumë shpesh, planifikuesit ndërkombëtar kanë pasur një qasje nga lartë – poshtë, për shkak se ato gjëra shtyhen nga imperativët thelbësor politikë dhe nga afatet e ndërlidhura me zgjidhjen e statusit përfundimtar. OJQ-të i janë përshtatur këtij konteksti dhe është dashur të veprojnë në përputhje me kufizimet e vendosura në mënyrë që të konkurrojnë për zgjatjen e programeve të tyre dhe për fonde nga donatorët. Puna e tyre pasuese në informimin publik dhe kthim është kufizuar dhe ndarë në mikro projekte të cilat kanë pasur shumë pak ndikim tek pjesa më e madhe e PZHBV-e.

DÇBP-ja dhe pasuesja e AKP-ja, kanë pasur qasje inovative ndaj kthimit të pronës. Inovacioni qëndron në natyrën e këtyre organeve, si organe pothuaj gjyqësore të cilat punojnë në një sistem të veçantë ligjor me rregulla fleksibile të dëshmive, vendimet e të cilave janë përfundimtare dhe nuk i nënshtrohen mbikëqyrjes nga gjykatat lokale dhe të cilat kanë kompetenca për të bërë dëbime. Ligjet sipas të cilave janë themeluar përcaktojnë se për nga natyra ato janë të përkohshme dhe të përcaktuara për të trajtuar një vëllim të madh të kërkesave për të drejtat pronësore, të cilat dalin nga konfliktet e armatosura. Sidoqoftë, efikasiteti në kthimin e pronës duke ndjekur këtë qasje po ashtu ndikohet nga konteksti politik në Kosovë, i cili ka prioritizuar zgjidhjen e tyre mbi të gjitha çështjet tjera. Aspekti i drejtësisë për rivendosjen e mandatit të AKP-së është dobësuar apo dëmtuar sa herë kanë dalë mosmarrëveshje në mes të ndjekjes aktive të qëllimeve të agjencisë dhe praktikave të disa institucioneve tjera kosovare, relevante për këto çështje. Kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë sfidon aftësinë e procesit të kthimit të pronës për të mbështetur përpjekjet tjera për "rregullimin më të gjerë dhe pamundësimin e konflikteve në të ardhmen."[241]

Kjo mosmarrëveshje manifestohet me dobësi serioze në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe në praktikat e caktuara policore sa i përket çështjeve pronësore. AKP-ja ballafaqohet me numrin gjithnjë në rritje të personave të cilët përsëri uzurpojnë pronën banesore e cila është nën administrimin e saj. Mosndëshkimi ka përcjell uzurpimin e pronës banesore që nga fillimi misionit ndërkombëtar. Ky fenomen është tregues i qartë i dobësive në zbatimin e sundimit të ligjit në Kosovë, ku ka raste që disa njerëz janë kthyer në pronën e njëjtë edhe deri në tri herë pas dëbimit të tyre.[242] Policia e Kosovës dhe prokurorët publikë kanë treguar ngurrim për të arrestuar apo ndjekur uzurpuesit e paligjshëm, edhe pse ata janë të autorizuar për ta bërë këtë.[243]

[241] Rhodri C. Williams, "E drejta bashkëkohore për kthimin e pronës në kontekstin e drejtësisë tranzicionale," Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT), Seria e dokumenteve të rastit, maj 2007.

[242] "Në disa raste ata na thanë haptas neve (AKP-së) dhe policisë se dëbimi i tyre nuk ka rëndësi pasi që ata kanë për qëllim të kthehen në pronën e tyre, duke ditur se nuk do të kenë kurrfarë pasojash për të bërë një gjë të tillë." Intervistë me një zyrtar të lartë të AKP-së, 25 shtator 2008.

[243] Prokurorët ndërkombëtar të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) identifikuan dhe hetuan 40 raste të mashtrimeve në lidhje me pronat e PZHBV-ve, por vetëm një numër i vogël i tyre janë ndjekur penalisht në gjykatat lokale. Deri në fund të vitit 2006, DD-ja ua delegojë këto raste prokurorëve vendorë. Përkundër faktit se 27 raste

Kthimi efektiv i pronës më tej vështirësohet nga fakti se PZHBV-të të cilët kanë marrë vendime pozitive nga KKP-ja kanë vështirësi të madhe në regjistrimin e atyre pronave në kadastrat lokale në komuna. Vendimet e KKP-së kanë fuqinë e titullit për palën që e ka fituar atë, por PZHBV-të janë refuzuar shpesh në përpjekjet e tyre për të regjistruar këto prona për shkak se disa nga zyrat nuk i njohin vendimet e KKP-së, apo kërkojnë vendim gjyqësor para se ta bëjnë këtë. Në rastet tjera, banorët lokalë të cilët kanë interes për atë pronë sfidojnë pronësinë mbi ato prona në gjykatat lokale, veprim ky i cili shtyn zyrat kadastrale në komuna të refuzojnë regjistrimin e pronës së PZHBV-së derisa të mos vendos gjykata. PZHBV-të e tjerë nuk mund të shkojnë deri në zyrat komunale kadastrale,[244] dhe kjo bllokon tentimet e tyre për të shitur pronën e tyre.

Pengesat në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe mosefikasiteti i dukshëm i gjykatave për të marrë vendime për numrin e madh të rasteve të grumbulluara në mënyrë të drejtë dhe me kohë duket se ka mundësi të rrezikoj stabilitetin e shoqërisë. Pjesa më e madhe e vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar pajtohen se gjendja e vështirë ekonomike në Kosovë paraqet kërcënim të rrezikshëm ndaj stabilitetit. Nëse nuk adresohet në mënyrë adekuate, kjo mund të shpie drejt trazirave dhe shqetësimeve sociale.[245]

Në përmbledhjen e publikuar në fund të vitit të kaluar, Banka Botërore e thekson papunësinë e lartë dhe varfërinë e përhapur në Kosovë – atdheun ku jeton popullsia më e re dhe me shkallën më të lartë të shtimit në Evropë. Për të trajtuar sfidat që paraqesin këto probleme, përmbledhja e autorit e ka inkurajuar qeverinë e Kosovës për të dalë me burime të reja të të ardhurave duke përmirësuar ekonominë e saj dhe duke promovuar strategjinë për rritje ekonomike.[246] Kosova ka shumë nevojë për investime të huaja për krijimin e vendeve të reja të punës, por problemet rreth zgjidhjeve të kontesteve pronësore, veçanërisht në sektorin komercial dhe bujqësor, ka mundësi të pengojnë investitorët të cilët kërkojnë të sigurojnë mjedis ligjor për investimet e tyre.[247]

---

ishin nga rajoni i Pejës, policia kurrë nuk zhvilloi ndonjë hetim sistematik për të përcaktuar se a fshiheshin grupe të organizuara pas kësaj mënyre të mashtrimit.

[244] Për të trajtuar çështjen e mungesës së lirisë së lëvizjes për pakicat në Kosovë, UNMIK-u themelojë nëntë Zyre Ndërlidhëse të Gjykatave (ZNGJ). Me personel zyrtar nga radhët e pakicave, ZNGJ-të duhej t'u ofronin pakicave qasje në drejtësi duke transportuar parashtruesit e kërkesave ose të akuzuarit deri në gjykata në zonat shqiptare, duke u ndihmuar parashtruesve të kërkesave të paraqesin në gjykatë dokumentet e nevojshme dhe duke dërguar në gjykatë dhe duke marrë nga gjykata çdo dokument të rëndësishëm zyrtar në të mirë të klientëve të tyre. Ndonëse kjo iniciativë kishte deri diku sukses, ajo ishte kundërthënëse. Disa thonë se ZNGJ-të vetëm kanë izoluar edhe më shumë pakicat dhe nuk mundësojnë që sistemi i drejtësisë të jetë i hapur, i drejtë dhe ku mund të kenë qasje të gjithë.

[245] Besa Beqiri, "Shumë qytetarë të Kosovës të zymtë për vitin 2009," *Southeast European Times,* 6 janar 2009.

[246] Banka Botërore, "Informacion i shkurtër për Kosovën," dhjetor 2008. Ky informacion i shkurtër thekson se rreth 32 për qind e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare dhe se 45 për qind e popullsisë jeton në varfëri (1.42 euro në ditë).

[247] Një rast interesant që ilustron disa nga problemet e krijuara ka të bëj me JYSK-un, kompani për shitjen e pajisjeve për banjë dhe dhomë të fjetjes. Qeveria Norvegjeze i ndihmoi një shqiptari të Kosovës të kthehet dhe të hap një qendër shitjeje të JYSK-ut në Kosovë. Ai nënshkroi kontratën e qiramarrjes për tokën me Komunën e Fushë Kosovës dhe ndërtimi i qendrës së shitjes filloj mjaft mirë. Por më vonë dy banorë vendorë u takuan me investitorin dhe e informuan atë se ishte duke ndërtuar në tokën e tyre dhe kërkuan kompensim ose shkatërrimin e objektit. Investitori kërkoi sqarim dhe ndihmë nga komuna, por kjo nuk i ndihmoi. Ai u ankua në AKP, e cila zhvilloi hetimet dhe verifikojë shënimet kadastrale që janë dërguar në Serbi. AKP-ja zbuloi se ekzistonin disa parregullsi në lidhje

Paaftësia për të zgjidhur kontestet pronësore, procesi kundërthënës i privatizimit dhe në përgjithësi sektori i dobët gjyqësor paraqesin një pasqyrë të keqe për investitorët e huaj, kështu duke dëmtuar zhvillimin e ardhshëm ekonomik.[248]

Në janar të vitit 2009, ICR-ja Pieter Feith ka emëruar Lars Lage Olofsson të Suedisë si Auditor të Përgjithshëm të Kosovës, i cili në mesin e detyrave tjera, do të luaj rol të rëndësishëm në sigurimin e ndihmës ekonomike ndërkombëtare.[249]

Duke pasur parasysh vëllimin e rasteve me konteste pronësore, perceptimi i mungesës së mjeteve efektive ligjore në gjykata ka shtyrë disa njerëz të kërkojnë zgjidhje alternative për kontestet e tyre pronësore.[250] Ky fenomen thekson rëndësinë e faktorëve kulturor sa i përket brishtësisë së sistemit të drejtësisë. Knut Rosandhaug, ish drejtor i DÇBP-së dhe i AKP-së për një kohë të gjatë, ka përmendur se në disa raste të kontesteve pronësore në Kosovë, qytetarët nuk kanë përdorë atë që korniza ligjore u ka ofruar për t'u ankuar dhe për të zgjidhur kërkesat e tyre, por në vend të kësaj ata shpesh kanë zgjedhur rrugë joformale dhe mjete tjera.[251]

Nuk mund të ketë përparim në aplikimin e potencialit të plotë të institucioneve të cilat janë krijuar për të trajtuar problemet e të zhvendosurve pa adresuar çështjet e mosndëshkimit dhe frikës e cila frenon zbatimin e plotë të ligjit. Bashkësia ndërkombëtare i ka kontribuar kësaj gjendje përmes paaftësisë së saj që të merret në mënyrë efektive me kryesit e krimeve të rënda dhe gjendjen e dobët të sundimit të ligjit. Kryerja e kësaj në mënyrë efektive do të nënkuptohet si sfidë e drejtpërdrejtë për elitën e Kosovës, e cila qëndron në qendrat e pushtetit me të cilat disa segmente të bashkësisë ndërkombëtare kanë bashkëpunuar hapur gjatë konfliktit kundër Serbisë dhe pas kësaj. Kontradikta e mosndjekjes së drejtpërdrejtë të disa elitave kriminale përderisa shtyhet përpara agjenda ambicioze e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit bëhet vetëshpjeguese kur shikojmë gjendjen e të drejtave pronësore, kthimin e pronës dhe kthimin e PZHBV-ve. Detyra për themelimin e institucioneve të cilat funksionojnë në të gjitha nivelet e shoqërisë për të aplikuar ligjin në mënyrë të drejtë dhe për t'u mundësuar qytetarëve, pavarësisht përkatësisë së tyre nacionale, të kërkojnë zgjidhje, dobësohet nga sistemi i cili favorizon ata që

---

me pronësinë mbi tokën në fjalë. Investitori pastaj u detyrua të zgjidh ketë çështje me këta dy njerëz duke paguar një shumë të hollash. Burimi: Intervista me Knut Rosandhaug, ish drejtor ekzekutiv i AKP-së, janar 2007.

[248] Një shembull i mirë në lidhje me ketë problem ka të bëj me ndërmarrjen e minierave Trepça. Ajo është një konglomerat i disa ndërmarrjeve të ndryshme të cilat gjithmonë kanë qenë motori ekonomik i Kosovës. Megjithatë, ende nuk është paraqitur asnjë investitor i huaj për shkak të përzierjes së politikës lokale duke ja pamundësuar Trepçës që të emërojë një administrator që do të mund të mbikëqyr riorganizimin e këtij konglomerati. Kjo vazhdon të dëmtojë ekonominë e Kosovës. Burimi: intervistë me gjykatës Tudor Pantiru, ish kryetar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, 24 janar 2009.

[249] Përmbledhja e raporteve të medieve, UNMIK, 23 janar 2009.

[250] Një shembull dramatik thekson ketë pikë. Dy persona u vranë në qytetin e Shtimes, përfshirë edhe zëvendës kryetarin e komunës, dhe tetë të tjerë u plagosën në një shkëmbim të shtënash ndërmjet dy grupeve të armatosura të shqiptarëve të Kosovës më 22 prill 2006. Kontesti kishte të bënte me një ish pronë të një serbi të cilën e pretendonin zëvendës kryetari dhe një grup tjetër. Kanë ndodhur edhe raste të tjera të ngjashme për kontestet e pazgjidhura pronësore. Shih Krenar Gashi, "Masa e kërkesave pronësore kontradiktore pasi që lufta i bën shumë kosovarë të përpiqen të zgjidhin kontestet e tyre me armë," Balkan Insight, 26 prill 2006.

[251] Ibid.

qëndrojnë në pozita të larta. Për shkak se këta njerëz ose kanë lidhje të fuqishme klanore ose pasuri, ata zënë çfarëdo vakumi të autoritetit dhe si rezultat i kësaj shndërrohen në arbitra dhe shpërndarës të pashmangshëm "të drejtësisë". Në këtë kuptim, shumë aspekte të shoqërisë kosovare i përngjajnë strukturës patron-klient.[252]

[252] Ka shumë shembuj të patronëve të fuqishëm që nuk i përkasin asnjë institucioni qeveritar që zgjidhin kontestet. Në një rast të kohëve të fundit, dy gra serbe të Kosovës që u kthyen në Deçan kërkuan nga ish komandanti i UÇK-së Ramush Haradinaj zgjidhjen e kontestit me komunën pasi që ajo refuzonte të përmbush obligimin për punësimin e njërës prej tyre në rast se ato kthehen. Edhe pse ai nuk ka ndonjë pozitë zyrtare në Komunë, dihet botërisht se ai ka shumë ndikim në Deçan. Haradinaj ia doli që të bind komunën të punësojë njërën prej këtyre grave. Shih UNMIK, Departamenti i Administratës Civile (DAK), Raporti ditor i zyrës në Pejë, 7 korrik 2008.

V. I. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

A. PËRFUNDIM

Kthimi i njerëzve, kthimi i pronës dhe reparacioni nuk janë vetvetiu të mjaftueshme për të sjellë një rehabilitim të plotë social pas konfliktit dhe zhvendosjes; gjë që kërkon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj trashëgimisë nga e kaluara. Një qasje e tillë, mbetet e pakapshme në Kosovë. Edhe pse disa njerëz nga të dyja anët e ndara arrijnë deri te vlerësimet e tyre, ekzistojnë pengesa serioze të cilat e parandalojnë një llogaritje të plotë të këqijave të kaluara dhe një lëvizje drejt të ardhmes paqësore, respektimit dhe dinjitetit të ndërsjellë.

Ky raport ka trajtuar një nga këto pengesa, trashëgiminë e konflikteve pronësore dhe sundimin e ligjit. Por mbesin pengesa të tjera që janë të dhimbshme për nga natyra; çështja e vazhdueshme e personave të pagjetur; ndjekja dhe dënimi i personave nga të dyja anët për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit; krijimi i një tregimi të përbashkët për integrim; pranimi publik i përgjegjësisë dhe dhimbjeve të shkaktuara, vuajtjeve dhe humbjeve në viktima nga të dyja anët e përfshira në konflikt; dhe ndërtimi i përmendoreve publike për ata që kanë vuajtur dhe viktimat më tepër sesa të bëhet glorifikimi i njërës palë.

Në raportin e Kai Eides për Kosovën të vitit 2005, i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit Përgjithshëm ka rezervuar një kapitull të veçantë për sfidën e pajtimit. Ai ka bërë thirrje që menjëherë të niset me pajtimin. "Barra kryesore," ka thënë ai, "do të bie mbi supet e udhëheqësve të popullsisë shumicë. Ata të cilët janë duan të njihen, që duan integrim dhe investime, duhet që po ashtu të tregojnë edhe zemërgjerësi."[253] Sidoqoftë, ai i ka bërë thirrje po ashtu edhe udhëheqësve serbë të Kosovës dhe qeverisë së Serbisë që të merr pjesë aktivisht dhe me mirëbesim në përpjekjet për pajtim dhe të lëvizin ngadalë drejt integrimit të serbëve në institucionet e Kosovës.[254] "Të gjitha komunitetet," ka thënë Eide, "duhet të bëjnë përpjekje për të ndërtuar të ardhmen e tyre në bazat e përfshirjes, modernizimit dhe demokracisë, e jo të ndarjes etnike."[255]

Prej se është bërë ajo thirrje, është arritur progres shumë i vogël drejt adresimit të pengesave të mbetura drejt pajtimit. Është pikërisht ndarja etnike ajo e cila mbetet shtylla kryesore e identitetit dhe mburojë e mbrojtjes për komunitetet. Në një kontekst të polarizuar mbi të ardhmen e Kosovës dhe ku shumë nga ata të cilët kanë marrë pjesë në konfliktin e armatosur mbajnë poste politike, është e vështirë që të përfytyrohet një strategji e bashkërenduar e drejtësisë tranzicionale në këtë moment.

Autoritetet ndërkombëtare dhe ato kosovare duhet të vazhdojnë të adresojnë të metat specifike në sistemin e drejtësisë kosovare me shpresën që eventualisht ta korrigjojnë të kaluarën. Kthimi i të drejtave pronësore është shumë i rëndësishëm në këtë aspekt, pasi që në mungesë të një kthimi

[253] Shih Kai Eide, "Shqyrtim gjithëpërfshirës i gjendjes në Kosovë," Këshilli i Sigurimit i OKB-së, 7 tetor 2005, 20.
[254] Ibid., 20.
[255] Ibid., 20.

përmbajtjesor të personave të zhvendosur, kjo do tu jepte viktimave një ndjenjë të drejtësisë, dinjitetit dhe kthimit në gjendjen e mëparshme dhe po ashtu do t'u ndihmonte atyre për të marrë vendime të qarta rreth të ardhmes së tyre. Është po ashtu e rëndësishme që kjo çështje të zgjidhet para se autoritetet kosovare të nisen drejt një rruge të diskutueshme të kthimit të pronave të cilat autoritetet komuniste i kanë nacionalizuar pas vitit 1945. Tash për tash nuk ekziston një politikë e tillë, por nuk duhet të injorohen skenarët në të cilët dy trashëgimitë e mbetura nga e kaluara përplasen në një sistem të brishtë të drejtësisë, duke hapur mundësinë e provokimit të më shumë tensioneve.

Pajtimi është një proces i gjatë dhe i vështirë i cili mund të merr forma të ndryshme. Në Afrikën e Jugut, profesori John De Gruchy dhe Dr. Pumla Gobodo-Madikizela, pjesëmarrës në të Vërtetën jug-afrikane dhe Komisionin për Pajtim, janë nisur nga përvojat e tyre për të përfunduar se pajtimi është gjithmonë dhe në të gjitha kohët një udhëtim i vështirë.[256] "Udhëtimi i vështirë dhe i kushtueshëm" i Kosovës ende pritet të filloj me sinqeritet.

Kai Eide ka argumentuar fuqishëm në raportin e tij se "Kosova nuk do të bëhet në një të ardhme të parashikueshme një vend ku shqiptarët dhe serbët e Kosovës janë të integruar. Ndoshta ata edhe nuk kanë qenë asnjëherë. Megjithatë, procesi i pajtimit duhet të nisë. Ai duhet të vijë nga brenda e Kosovës dhe të përqafohet nga të gjitha komunitetet."[257] Ky është një vlerësim real i situatës, i cili duhet të inkurajoj të gjitha palët ndërkombëtare që të ballafaqohen me sfidën e promovimit të paqes dhe drejtësisë në Kosovë para çdo konsiderate tjetër politike. Realizmi i vështirë nuk përjashton optimizmin për tentimin e adresimit të sfidave për pajtim në Kosovë, por nuk mund të ketë progres pa qasje aktive, të balancuar dhe të drejtë të komunitetit ndërkombëtar dhe të zërave inkurajues të komunitetit të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

B. REKOMANDIMET

Duke marrë parasysh ato që u thanë më lartë, ky raport nxjerr rekomandimet e mëposhtme se si të përmirësohet procesi i kthimit të pronës në Kosovë dhe t'u ofrohet personave të zhvendosur e drejta e tyre për të kërkuar zgjidhje afatgjate për brengat e tyre:

1. Mandati i AKP-së duhet të vazhdohet sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Duhet të shqyrtohen të gjitha mundësitë për të arritur një konsensus në mes të atyre që janë të përfshirë në punët e agjencisë lidhur me këtë kornizë legjislative. Më saktësisht, ata që janë të përfshirë duhet të marrin parasysh si KKP-ja mund të bie nën mbikëqyrjen e EULEX-it brenda kornizës së Rezolutës 1244 të KSKB-së, në rast se UNMIK-u do të luajë një rol të drejtpërdrejtë dhe efektiv. Kjo do të hapte mundësinë e vazhdimit të zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Nga pikëpamja humanitare, rregullorja ofron mekanizma ligjor që janë më të përshtatshëm për të adresuar nevojat individuale për të drejtën e pronës dhe mund të shpie drejt rihapjes së zyrave rajonale, tashmë të

[256] Donald W. Shriver, "Pasojat e të keqes: Kostoja e pajtimit," *Christian Century,* 27 janar 2004.
[257] Kai Eide, ""Shqyrtim gjithëpërfshirës i gjendjes në Kosovë," Këshilli i Sigurimit i OKB-së, 7 tetor 2005.

mbyllura, në Serbi. Mbajtja e këtyre zyrave të mbyllura mund të qoj drejt shkeljes së të drejtave të njeriut në lidhje me mbrojtjen e të drejtave pronësore.

2. Zyra e Kryeministrit së voni ka hapur një Zyre Këshillëdhënëse për Çështje të Komuniteteve. Kjo do të përpilojë dhe udhëheq një strategji të koordinuar për të kompensuar PZHBV-të për pronat e tyre. Zyra po ashtu ka autoritet të punojë me të gjitha ministritë për të adresuar dështimet, mangësitë, dhe problemet e pazgjidhura në sistem. Momentalisht, zyra ka një këshilltar të lartë për çështjet që preokupojnë komunitetin serb[258]. Sa i përket përpilimit të një strategjie për kthimin e pronës, qeveria e Kosovës duhet të marrë parasysh emërimin e një këshilltari në bordin ekzekutiv të AKP-së.

3. OSBE-ja, në aktivitetet e saj monitoruese, duhet të informojë në mënyre sistematike Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës për procedurat paralele dhe vendimet kontradiktore në gjykatat lokale, për rastet që rreptësishtë kërkojnë përfshirjen e AKP-së. Rastet e monitoruara duhet të përcillen në mënyrë që të sigurohet se gjykatat, para se të procedojnë çfarëdo rasti që ka të bëjë me pronën, të verifikojnë me AKP-në dhe të sigurojë që AKP-ja nuk është duke e shqyrtuar të njëjtën kërkesë. Gjykatat lokale duhet të respektojnë juridiksionin e AKP-së të përcaktuar në ligj.

4. Duhet të ketë masa më të rrepta nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për të siguruar që komunat të zbatojnë në tërësi procedurat e shpronësimit dhe të parandalojnë rrënimin e pronave të njerëzve të zhvendosur dhe ndërtimin e strukturave ilegale në pronat e tyre. Këto masa duhet të përfshijnë edhe një inspektim më efektiv dhe dënime financiare si për shembull ndarje e buxhetit më të ulët për komunat të cilat nuk i përmbahen ligjit në tërësi. Kjo çështje është drejtpërsëdrejti e lidhur me nevojën që UNMIK-u, EULEX-i dhe autoritetet Kosovare të thyejnë bindjet e ngulitura për mosndëshkim dhe korrupsionin që ka të bëj me personat e zhvendosur, pronat, etj.

5. Në të kaluarën, Policia e Kosovës nuk ka reaguar shpejtë ndaj krimeve kundër pronës. Ata po ashtu kanë hezituar të zhvillojnë hetime kriminale ndaj krimeve kundër pronës. EULEX-i, në raportet e rregullta që i dërgon Këshillit të Sigurimit dhe Brukselit duhet të përfshijë një pjesë për atë se çfarë janë duke bërë policia për të parandaluar krimin kundër pronave të PZHBV-ve dhe si e aplikojnë Kodin Penal të Kosovës kundër shkelësve të ligjit. Qëllimi, në bashkëpunim më Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, duhet të jetë shtytja dhe inkurajimi i Policisë së Kosovës që të jetë më aktive në zbatimin e tërësishëm të Kodit Penal të Kosovës kundër uzurpatorëve dhe personave që rivendosen në pronat e PZHBV-ve dhe në hetimin e pretendimeve për mashtrime me të drejtat pronësore.

[258] Intervistë me një këshilltar të lartë për çështje të komunitetit serb në Zyrën për Çështje të Komuniteteve, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, 17 dhjetor 2008.

6. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të miratojnë një politikë që përkohësisht t'i përjashtojë PZHBV-të nga pagesa e taksave të gjykatave, kadastrës dhe atyre administrative.

7. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Kosovës duhet të përpilojë një plan me rekomandime të detyrueshme për komunat për atë se si të integrohen vendbanimet joformale, përfshirë edhe ato që janë dëmtuar gjatë konfliktit, në planet zhvillimore hapësinore dhe urbane. E drejta individuale e PZHBV-ve për t'u kthyer në shtëpi duhet të qëndroj mbi të gjitha pengesat teknike sa i përket vendbanimeve joformale dhe qëndrimit të pa dokumentuar, në mënyrë që të inkurajohen romët, ashkalitë dhe egjiptianët të kthehen në Kosovë.

8. Një prej sfidave më të mëdha ka qenë pamundësia e disa PZHBV-ve të marrin informata rreth procesit të kthimit të pronës dhe që të kenë kontakt me institucionet përkatëse. Vetëm tash së voni, Këshilli Danez për Refugjatë ka krijuar një program për të ofruar ndihmë ligjore për PZHBV-të dhe grupet tjera rrezikuara nga Kosova për të mbrojtur të drejtat e tyre pronësore[259]. Programi po ashtu ka për qëllim të zhvillojë fushata informuese për PZHBV-të dhe grupet e tjera të rrezikuara për të drejtat pronësore dhe të ngrit kapacitetin e institucioneve serbe që të ndihmojnë PZHBV-të në mbrojtjen e pronave të tyre. Ministria Serbe për Kosovë dhe Metohi dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të kenë kontakt në kuadër të një grupi punues për të siguruar që PZHBV-të të marrin informata përkatëse shpejt, duke përfshirë edhe ato për ndryshimet në Regjistrin Kosovar për të Drejtën e Pronës së Paluajtshme.

9. Agjencia e re e Kosovare e Privatizimit, e themeluar nga Kuvendi i Kosovës me Ligjin nr. 03/L-067, duke u bazuar në strategjinë e mësimeve të nxjerra nga ish-Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, duhet të krijojë një njësi për informim publik në mënyrë që të përmirësojë qasjen e PZHBV-ve. Shpesh është vështirë për të arritur deri tek PZHBV-të dhe atyre u mungojnë edhe resurset. Njësia për informim publik duhet të krijojë një linjë të rregullt dhe zyrtare të komunikimit me pjesëtarët e shoqërisë civile të cilët përfaqësojnë interesat e PZHBV-ve. Ata duhet të krijojnë një strategji sistematike për të informuar PZHBV-të rreth aktiviteteve të agjencisë, disa prej të cilave mund të bëhen nga mediat serbe.

[259] Shih DRC, "Programi i ndihmës juridike për institucionet e Qeverisë së Serbisë në trajtimin e Refugjatëve dhe PZHBV-ve," Raporti fillestar, Beograd, 30 gusht 2008.



international center for
TRANSITIONAL
JUSTICE

5 Hanover Square
24th floor
New York, NY 10004
TEL 917.637.3800
FAX 917.637.3900

www.ictj.org | info@ictj.org